Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (91). NËNTOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

PROTESTA: PROJEKTI I HIDROCENTRALIT TË LUKOVËS ËSHTË ME PASOJA SHKATËRRUESE PËR DIBRËN

Ndal devijimit të rrjedhjes së lumit **Radika**!



Ndryshimi i rrjedhjes natyrore të lumit të Radikës do të shkaktojë një katastrofë ekologjike për Grykën e Radikës. Ndërmarrja publike e Maqedonisë është e angazhuar për ndërtimin e hidrocentralit të Llukovës, ndërkohë që protestuesit presin edhe reagimin zyrtar të qeverisë së Shqipërisë. Qytetarët dhe pushtetarët lokalë në Dibër të Madhe janë kundër: Mos na e thani ardhmërinë!

Retrospektivë e ngjarjeve dhe veprimtarive lidhur me problemin ekologjik të vjedhjes së ujërave të lumit Radika nga Qeveria e Maqedonisë përmes ndërmarrjes publike për prodhim të energjisë elektrike "ELEM"

SPECIALE NË FAQET 6-7

rreth e rrotull-a

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Muaji filloi mbarë për Dibrën. Një dibran u takua me kryeministrin maqedonas dhe i kërkoi falje, sepse në Tiranë ia kishte bërë pis kostumin me vezë të prishur. Pas këtij takimi, vizita e kryeministrit shqiptar në Shkup shkoi fjollë. Thuaj pastaj se ne dibranët nuk ia thekim për diplomaci... Media e Tiranës njoftoi se dibrani ishte arrestuar nga policia, por një gjë nuk u kuptua, kur e takoi kryeministrin maqedonas, para apo pas arrestimit?!

Policia e Bulqizës nisi një aksion kundër kamionëve me krom. Ngaqë nuk mundet dot ta ndalojë krimin që ndodh në miniera, janë nën tokë të galeritë, policia ndalon kamionët, sepse nuk kanë fatura tatimore që të tregojë çmimin dhe peshën. Ndërkohë, ministri i energjetikës dhe minierave urdhëroi bllokimin lejeve për shoqëritë që shfrytëzojnë minierat e Bulqizës, sepse nuk kanë respektuar investimet dhe kushtet e sigurisë në punë. "Ky është shteti", dukej se thoshin lajmet e para nga terreni, por vetëm pak ditë më vonë, disa punëtorë deshën të vetëdigjeshin: Po vuajmë për bukën e gojës, na lini të punojmë... si skllevër! Kur minatorët humbin jetën në galeri, e gjithë shoqëria kërkon dorën e ngrohtë të qeverisë, kur shteti ofron dorën e ngrohtë, punëtorët kërkojnë dorën e ftohtë të skllavërisë...

Për armët kimike, që desh helmuan Shqipërinë, u protestua edhe ne Peshkopi. Bulevardi si rrallëherë në këto 20 vite u mbush me fëmijë me parulla në dorë: Mbroni fëmijët tanë!... Veç në Peshkopi gjen fëmijë me fëmijë! Të rriturit i ndoqën me sy nga trotuaret dhe kafet, duke bërë shaka dhe duke pirë raki...

(Vijon në faqen 10)

Roli dhe rëndësia ekonomike e Rrugës së Arbrit



Nga **ENVER HALILI - FAQE 3**

Prof.dr. Artan Fuga, mbështetje të fuqishme për Rrugën e Arbrit

Profesori i njohur, u bën thirrje miqve të tij në Facebook të firmosin peticionin për Rrugën e Arbrit. "Unë jam një grimcë rëre përpara këtij projekti që zhvillon Dibrën, Veriun, gjithë Shqipërinë. Unë kam bindje se qeveria do ta vlerësojë maksimalisht", shkruan ai.

Iniciatorët e peticionit për Rrugën e Arbrit janë duke negociuar me institucionet qeveritare për të bërë të mundur dorëzimin formal të tij. Peticioni, i nisur që më 18 mars 2013, deri më tani ka mbledhur një numër të konsiderueshëm firmash. Atë e kanë firmosur personalitete të ndryshme të kulturës, shkencës e artit, të cilët janë janë bërë të njohura për publikun në numrat e kaluar. Kohët e fundit, atë e kanë firmosur edhe artistët e humorit Agron Llakaj e Behar Mera si dhe këngëtari Dritan Jashari. Por ajo që ka spikatur këtë muaj, janë komentet në faqen personale të Facebook-ut të Prof. Dr., Artan Fugës, Anëtar i Akademisë së Shkencave.

"Unë vetë jam me origjinë jugore, por si shqiptar, ndjek me shumë interes ecurinë e fatit të Rrugës së Arbrit, shkruan ai një status në faqen e tij personale. Falenderoj të gjithë ata miq të kësaj faqeje që po e nënshkruajnë me dhjetra peticionin dashamirës në mbështetje të saj.

Menjëherë në faqen e tij ka pasur reagime pozitive për mbështetjen, të cilën Fuga detyrohet më vonë edhe ta sqarojë. "Dibranët e meritojnë të afrohen me Tiranën, se familjet e tyre e kanë mbajtur gjallë kulturën tiranase duke qenë banorë të hershëm të saj.Çfarë populli, çfarë familjesh, çfarë miqsh. Pa zë, plot mençuri, të thjeshtë, besnikë, pastërtorë, familjarë të mirë, solidarë, besimtarë në vlera. Nuk thoshin kot "Ke dibranët!" Eh, histori e gjatë...

Dikush i shpreh falënderimet profesorit, dhe ai përgjigjet me modesti: "Unë jam një grimcë rëre përpara këtij projekti që zhvillon Dibrën, Veriun, gjithë Shqipërinë. Unë kam bindje se qeveria do ta vlerësojë maksimalisht". Më pas, dikush i kujton se "është pa mbyllur akoma aksi i Jugut", dhe profesori ia kthen krejt miqësisht dhe me humor: "Aleks i nderuar, për të shkuar në Sarandë, bjeri shkurt nga Dibra or mik! Peticioni nuk thotë askërkund se ndaloni punimet në aksin e Jugut. Pa merak. Firmose edhe ti, të lutem!" Këmbënguljes së Aleksit se edhe aksi Memaliaj - Tepelenëështë keq, Fuga nuk përton sërish t'i përgjigjet: "E di, ke shumë të drejtë, i nderuar Aleks!Por zemra e njeriut nis kur nuk mendon vetëm për të keqen e vet, por edhe për të keqen e tjetrit. Bashkë do t'a bëjmë Shqipërinë."

(Vijon në faqen 18)

cyan magenta yellow black 1


Peticioni për Rrugën e Arbërit është në mënyrë strikte jo-politik.
Çdo aktivist i përfshirë nuk bën pjesë në asnjë parti politike
dhe as nuk ka aspirata të tilla

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11 (91). 1 - 30 Nëntor 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: Selman Mëziu, Haki Përnezha, Destan Rama, Dali Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Enver HALILI
Rexhep TORTE
Bardhyl MARKU
Ida NURÇE
Erisa SARAÇI
Hysen LIKDISHA
Mustafa TOLA
Gafur ZOTO
Spiro XHAVARRA
Ilmi DERVISHI
Genc MELONASHI
Mevlud BUCI
Sakip CAMI
Ramiz GJINI
Atli DEMA
Petrit FETAHU
Shemsi MANJANI
Qazim PREJSI
Zabit LLESHI
Hajredin TOCA
Faik XHANI
Xhelal ROÇI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Kthejani **buzëqeshjen Dibrës** duke ndërtuar **Rrugën e Arbrit**!



Nga **IDA NURÇE**



Rruga e Arbrit në Bulqizë. Foto © B.Karoshi

Keni dëgjuar për Dibrën? Është një rreth që ndodhet në lindje të Shqipërisë. Është një nga vendet me pasuritë më të shumta natyrore. Ndërshekuj me radhë ka qenë dhe do mbetet një nga vendet më të bukura. Por ka nevojë për investime. Ashtu si gratë, që bëjnë makijazh për t'u dukur të bukura, ashtu edhe Dibra ka nevojë për investime. Ka nevoje për dorën e njeriut.

Po ju drejtohem Ju, të lartëve të vendit. Nuk dua t'ia di nëse jeni të majtë apo të djathtë. Kemi nevoje të marrim frymë. Rruga e Arbrit po ju pret plot endje. Ajo nuk është një rrugë e veshur as me blu e as me rozë, por një rrugë e veshur kuq e zi... Edhe këtu ka jetë. Madje, kaq të jetueshme! Ka frymë të thellë, si era e malit. Ka zemra që rrahin fort si daulle. Ka gjak që vlon në çdo stinë, jo vetëm në pranverë. Na lini të dalim nga ky "burg". Të shohim ç'bëhet përtej "mureve" të tij të lartë vetull-vrenjtur. Të ecim me lirinë e një fëmije, që ecën nëpër fushat e hershme të pranverës. Jemi banorë të një toke, jo të një ishulli. Ku mund të gjeni një vend kaq madhështor sa Dibra? Gjithmonë ka pasqyruar në mënyrë të kthjellët, bukurinë e saj, ball-lartë dhe krenare. Ka ditur të ruaj traditat dhe zakonet kohë pas kohe. Ka lindur shumë burrnesha e trima, që i kanë bërë ballë çdo lufte. Kanë qëndruar të fortë, si vetë mali që kanë karshi, Korabi.

Dibranët shquhen për mikriptjen. Madje-madje, dera e tyre hapet për këdo që ngre dorën dhe troket. Miku pritet me gjithë të mirat e mundshme. Në këtë sofër të madhe është ulur këmbëkryq mendja...

Por... Një "por" e vrazhdë më errëson sytë. Më bën, që koka të anojë përpara nga mendimet. Kemi kaq shumë nevojë për përkrahje, për një shtysë që të ecim përpara. Të tregojmë vlerat tona. Ta zhvillojmë këtë vend të lënë në harresë. Zërin do ta çojmë lart. Do ulërasim. Vullkani dibran sapo ka shpërthyer. Ka nxjerrë në shesh Dibrën. E keni të servirur në tabaka. Bëni të mundur, të zhdukni makthin e çdo qytetari Dibran. Na e riktheni buzëqeshjen. Na ndërtoni rrugën tonë, Rrugën e Arbrit.

Ç'dua të them? Ku ka makth më të madh, sesa makthi që ka një dibran duke menduar: "Të nesërmen kam rrugë drejt Tiranës"? Ku ka vuajtje më të tmerrshme, sesa të ecësh për 4-5 orë në një rrugë që të duket sikur është e shtruar me gropa, barriera, hendeqe, gurë, ku të përplaset koka në tavanin e makinës, njësoj sikur luan mbi një sustë. Në fund të mbetet vetëm të thuash: "Shpresoj ti kem të gjitha organet në vend". Ndihesh gjysmë njeri nga kjo rrugë gjarpëruese e pakuptimtë. Ke frikë të kesh ndonjë punë në kryeqytet, se iluzione pafund të pushtojnë sferën e mendimeve në të qindat e sekondit: "A thua do më zërë makina? Si do na shkojë rruga? Shpresoj ta kalojmë Qafën e Buallit pa bërë ndonjë aksident?" (Qafë Bulli është një nga zonat ku është shënuar numri më i madh i aksidenteve në rrethin e Dibrës). Epo, ç'doni më shumë se kaq? Dini ju të ketë problem më të madh për një vend, sesa mungesa e një rruge?

E kemi një shpëtim! Po, po, një shpëtim. Të shumëpërfolurën e lënë në harresë, atë, Rrugën e Arbrit, që për ne është si Ura e Bosforit. Ktheni sytë nga ne! Këtej është ana tjetër e medaljes suaj! Jemi diku këtu! Na jepni mundësinë të lëvizim të qetë, pa makthe, pa rraskapitje shëndetësore e mendore! Na lejoni të udhëtojmë plot mendime dhe ëndrra që krijohen nga peizazhi që na shoqëron! Na lejoni t'i tregojmë Shqipërisë bukuritë e mahnitshme të Dibrës! Të kontribuojmë me mendjen e rritur te ne! Të promovojmë vlerat dhe pasuritë e saj. Shekspirin e ka munduar shume dilema "Të rrosh apo të mos rrosh!". Unë them, që është bukur të rrosh, por me një Dibër që rritet në gji të Shqipërisë, jo të lënë mënjanë, si një jetime të ngratë. Puna do punë. Andaj punoni ... Kjo është Dibra jonë. Dibra e gjithë shqiptarëve. E gjithë Shqipërisë. Mos e shikoni me bisht të syrit, por shikojeni me sy.

Rruga po ju pret në mëshirë të fatit. Mos e lini të vdesë në harrese. Kthehuni!

Autorja është nga Kërçishti i Poshtëm i Maqellarës. Ka mbaruar shkollën e mesme profesionale, pedagogjike "Nazmi Rushiti" në Peshkopi. Ka ndjekur studimet e larta për Gazetari dhe Komunikim.

"Rruga e Arbërit, mediat e politizuara dhe politikanët Kardashian-ë"

Nga **ERISA SARAÇI***

Që më 18 mars të këtij viti një grup intelektualësh dibranë nisën një peticion online që kërkon përfundimin sa më shpejt e brenda standardeve të Rrugës së Arbërit. Kjo është rruga shekullore Tiranë-Dibër, më kryesorja pas Egnatias, e përdorur nga Skënderbeu në shtetin e parë shqiptar, Principatën Arbërore, nga ku merr edhe emrin.

Aktualisht udhëtimi Tiranë-Dibër – si brenda apo jashtë kufijve shtetëror – bëhet nëpërmjet një rruge të gjatë dredharake dhe aspak efiçente. Të udhëtosh në këtërrugë nacionale,që është më qesharakja në vend, është njëlloj sikur të kapësh veshin e majtë me dorën të djathtë.

Peticioni për Rrugën e Arbërit është në mënyrë strikte jo-politik. Çdo aktivist i përfshirë nuk bën pjesë në asnjë parti politike dhe as nuk ka aspirata të tilla – ky ka qenë kushti i angazhimit që në fillim! E megjithkëtë, peticioni është akuzuar në fillim nga simpatizantë të djathtë se ishte politik. Pas zgjedhjeve, kur pushteti u rrotullua, simpatizantët e të majtës filluan të bënin naze ndërkohë që të djathtët u bënë më të zellshëm. Në gjithë këtë vorbull, qëllimi i peticionit dhe forca e thirrjes së tij kanë mbetur qëndrueshmërisht të njëjtë.

Pas shumë muajve thirrje të vazhdueshme, ky peticion, që pretendon të promovjë zhvillimin e një prej zonave statistikisht më të varfra të Shqipërisë, rishpërndarjen e popullsisë, decentralizimin e investimeve, sjelljen më pranë të shqipëtarëve të Maqedonisë dhe përmirësimin e infrastrukturës së Ballkanit, mezi ka mbledhur 4000 firma.

Arsyet janë kryesisht skepticizmi i njerëzve në forcën e tyre dhe mos-njohja e çështjes nga personat jashtë Dibrës. Arsyeja për këtë të fundit është se për Dibrën flitet vetëm kur atje ndodh një krim, kur vdesin minatorët e kromit, apo kur ka përfunduar 'kositja'e pyjeve të Lurës, kësaj 'perle të Ballkanit',sipas Edith Durham dikur, por që tani duket sikur ka përjetuar shpërthimet e Hiroshimës dhe Nagasakit.

Peticionin e shoqërisë civile për Rrugën e Arbërit, mediat e mëdha në Tiranë, kryesisht ata të politizuara, me sa duket nuk e konsiderojnë aq të rëndësishëm për ta përcjellë në lajmet e tyre, që janë jo vetëm mbi axhendën zyrtare të politikanëve, por edhe mbi faktin se ku e pinë kafen, ç'kanë veshur, me kë u martuan e u ndanë... A thua se jane zgjedhur kryesisht për të mbushur faqet e shtypit roze,të cilin edhe mediat më 'serioze' po e imitojnë gjithmonë e më shume.Në Shqipëri, media i trajton politikanët si Kim Kardashian. Të isha si ta, do ofendohesha tejet!

Duke parë reagimin e popullit për rrezikun e sjelljes së armëve kimike në Shqipëri dhe rezultatin shpresëdhënës të këtij reagimi, shpresojmë që njerëzit të kenë fituar besim në forcën e tyre dhe që ky besim t'i shtyjë të reagojnë edhe për çështje të cilat i shqetësojnë çdo ditë: plehrat, mungesa e riciklimit të tyre, tymi i duhanit të tjetrit bonus me kafen, uji e korrenti me orar (se si do menaxhoheshin kimkatet toksike pa uje e korrent!!), etj. Po kështu, mbetemi me shpresë që rrugë si kjo e tanishmja Tiranë-Peshkopi të mos egzistojnë më në Shqipëri. Problemi është se populli ynë duket sikur ndonjëherë eksitohet më shumë nga VIP-at dhe VIP-eshat pa vlerë të politikës shqiptare se sa nga rrugët e mundimshme që bëjnë çdo ditë.

Ju lutemi të firmosni peticionin për Rrugën e Arbërit:

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtonisa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit

**Erisa Saraçi është duke kryer studimet e doktoraturës në fushën e Katalizës Heterogjene (Inxhinieri Kimike) pranë Universitetit të Leipzig, Gjermani.*

analizë

Jam shumë i sigurt se kostoja e rrugës do të mbulohet për një afat shumë të shkurtër. Të ardhurat dhe përfitimet e tjera që do të rrjedhin prej saj do të jenë të shumëfishta dhe ekonomikisht të pakontestueshme.

Roli dhe rëndësia ekonomike e Rrugës së Arbrit



Autori është PhD- Kandidat në financë. Ai është pedagog në Universiteti Teknologjik të Swinburnit, Melburn, Australi. Aktualisht jeton në Melburn. Ai është një lexues i rregullt i gazetës dhe prej kohësh kish shprehur gatishmërinë për të dhënë kontributin e tij modest nga larg për Rrugën e Arbrit. Artikulli i mësipërm është shkruar posaçërisht për gazetën "Rruga e Arbërit".

Nga **ENVER HALILI**

Rruga e Arbrit është e një rëndësie të veçantë jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për popujt e rajonit në përgjithësi. Kjo rëndësi shtrihet jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në atë kulturore dhe humanitare. Aktivizimi i resurseve të shumta të tri rajoneve: rajonit bregdetar, malor dhe atij kontinental paraqet një mundësi të jashtëzakonshme për ndërmarrjen dhe zhvillimin e një kompleksi të tërë të bizneseve dhe aktiviteteve ekonomike dhe joekonomike. Ndërlidhjet tregtare ndërmjet tri rajoneve me përparësi të ndryshme ekonomike, eliminojnë informatat asimetrike dhe ndikojnë pozitivisht në shtimin e vlerës së re, rrisin të hyrat buxhetore dhe përparojë mirëqenien e njerëzve.

Rëndësia ekonomike e Rrugës së Arbrit duhet të shikohet në aspektin dhe rolin shumëdimensional të saj. Ajo është një prej rrugëve më të rëndësishme, e cila lidh ekonomitë e tri rajoneve me përparësi të ndryshme natyrore dhe ekonomike: rajonit bregdetar, rajonit malor (Bulqiza, Klosi, Dibra dhe viset e Sharrit) dhe rajonit kontinental (Kërçova, Gostivari, Tetova dhe Shkupi). Por, mbi të gjitha, shkurton distancën kilometrike në mes të dy metropoleve më të njohura të Ballkanit, Tiranës dhe Shkupit, dhe ndërlidh pjesën malore dhe kontinentale me portin detar të Durrësit. Përfundimi i këtij korridori rrugor ul shpenzimet transportuese për të cilat çdo vit njerëzit dhe bizneset e këtyre rajoneve humbasin qindra miliona euro, për shkak se duhet të ndjekin linjat alternative rrugore shumë më të gjata dhe me kosto shumë më të larta. Pra, kjo rrugë mundëson dhe shton vëllimin dhe efikasitetin e qarkullimit të mallrave dhe kapitalit në mes të këtyre rajoneve me tregjet e tjera europiane dhe aziatike.

Por mbi të gjitha shfrytëzimi racional i pasurive të shumta nëntokësore (minerale) dhe mrekullive natyrore të këtij rajoni të lartë malor, do të jetë një faktor i rëndësishëm i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik-shoqëror dhe do të ndikoj pozitivisht në rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB - Gross Domestic Product (GDP)). Veçanërisht rajonet e Bulqizës, Klosit, Peshkopisë dhe Dibrës ofrojnë një fushë të gjerë për të investuar në sektorë të ndryshëm të biznesit dhe ekonomisë, siç janë:

1. Industria e minierave- nxjerrjen dhe përpunimin e metaleve (kromit, hekurit-nikelit, bakrit, aluminit, platinit, oreollave të arit, etj) dhe jometaleve (mermerët, kuarcitet, granitet, argjilat, squfurin, bojërat e dheut, gjipset, gëlqerorët, etj) dhe burime te tjera natyrore (Hoxha, et al. 2007; Shenjatari 2007)

2. Ekonomia e turizmit:

• malor (veror dhe dimëror) - duke shfrytëzuar burimet e rralla natyrore të këtij rajoni, si natyra Malit të Korabit, Parku Kombëtar i Lurës dhe lugina e Drinit të Zi nga turistë të vendeve të ndryshme. Njerëzit e zonave urbane kanë shumë nevojë për qetësim dhe prehje fizike dhe shpirtërore (sidomos njerëzit e zonave industriale nga vendet e Ballkanit dhe të Europës Perëndimore) dhe

• historiko-arkeologjik - pasi kjo zonë ka një histori të lashtë dhe të lavdishme dhe aty janë prezente gjurmët ilire dhe ato të Gjergj Kastriotit (Lleshi 2006). Këto monumente historike zgjojnë interesimin dhe kureshtjen e shumë studiuesve dhe turistëve të vendit dhe të huaj për ta vizituar këto zona.



Foto © B.Karoshi

Rëndësia ekonomike e Rrugës së Arbrit duhet të shikohet në aspektin dhe rolin shumëdimensional të saj. Ajo është një prej rrugëve më të rëndësishme, e cila lidh ekonomitë e tri rajoneve me përparësi të ndryshme natyrore dhe ekonomike: rajonit bregdetar, rajonit malor (Bulqiza, Klosi, Dibra dhe viset e Sharrit) dhe rajonit kontinental (Kërçova, Gostivari, Tetova dhe Shkupi).

Ndërtimi i Rrugës së Arbrit krijon mundësi për një angazhim të madh të kapitalit financiar dhe njerëzor. Pa dyshim, rolin kryesor do ta ketë kapitali intelektual, i cili në mënyrë profesionale do të funksionalizojë një gamë të gjerë të aktiviteteve ekonomike dhe joekonomike.

3. Ekonomia bujqësore:

• bimët mjekësore, drithërat, pemëtaria dhe blegtoria.

4. Ekonomia e ujit:

• ujit të pijshëm - zonat në fjalë janë shumë të pasura me burime uji të pijshëm, rezervat e të cilit po pakësohen gjithmonë e më tepër në rang planeti dhe çmimi i tij do rritet ndjeshëm në një periudhë të afërt kohore (Molden 2007). P.sh: 1/2 litër ujë në Melburn shitet për 2 dollarë deri në 3.5 dollarë, ndërsa 1 litër petrol kushton vetëm 1.50 dollarë.

• ujërat termale- burime të pasura të të cilave ndodhen në dy Dibrat dhe mbartin vlera të rëndëshime ekonomiko-shëndetësore (Eftimi 2012).

5. Industrinë e barërave (farmaceutike):

• shfrytëzimin dhe përpunimi efektiv të bimëve të shumta mjekësore që posedon ky rajon i pasur malor.

6. Industria ushqimore:

• përpunimi i lëndëve të para blegtorale (produktet e qumështit dhe të mishit)

• përpunimi dhe prodhimi i produkteve të pemëve, perimeve dhe drithërave.

Zhvillimi i industrisë ushqimore është shumë i rëndësishëm, veçanërisht tani kur bota po ballafaqohet me rritjen e kostos së ushqimit. P.sh: 1 kg mish lope në Melburn shitet për 15.00-20.00 dollarë; apo 1/2 kg domate të konservuara shiten për 6.00-8.00 dollarë.

7. Industria e përpunimit të leshit (tjerrit) dhe lëkurës:

• bazuar në lëndët e para vendore, të cilat mundësojnë zhvillimin e industrisë së tekstilit, këpucëve dhe produkteve të tjera.

8. Ekonomisë shëndetësore:

• si rezultat i mjedisit, ajrit dhe ujit të pastër, atje mund të ndërtohen spitale dhe qendra shëndetësore rehabilituese, sidomos ato të cilat kërkojnë prehje shpirtërore dhe psikike. Këto bukuri natyrore jo vetëm ta kënaqin syrin, por shpirtin dhe mendjen ta shërojnë.

9. Ekonomia e prodhimit të energjisë elektrike:

• Energjia ujore - duke shfrytëzuar rezervat e mëdha të ujit dhe rrjetin hidrik të larmishëm (Hoxha 2006).

• Energjia e erës - e favorizuar nga pozita gjeografike dhe erërat e shumta të cilat janë prezente gjatë tërë vitit kalendarik. Energjia e erës është një burim energjik i pastër ekologjik dhe i pashtershëm (Fthenakis e Kim 2009).

Prandaj ndërtimi i Rrugës së Arbrit krijon mundësi për një angazhim të madh të kapitalit financiar dhe njerëzor. Pa dyshim, rolin kryesor do ta ketë kapitali intelektual, i cili në mënyrë profesionale do të funksionalizojë një gamë të gjerë të aktiviteteve ekonomike dhe joekonomike. Gjithashtu, një fushë atraktive për investimet do jetë sektori i shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e ndryshme administrative (publike), shërbimet financiare (dhe bankare), shërbimet shëndetësore, shërbimet ndërlidhëse (transportuese, telefonike dhe interneti), shërbimet hoteliere, shërbimet mirëmbajtëse dhe shërbimet e tjera zejtare, të cilat ndikojnë pozitivisht në ngritjen e nivelit të punësimit dhe në rritjen ekonomike të tri rajoneve në përgjithësi. Rruga e Arbërit pra do të ketë një ndikim multisektorial në hapjen e vendeve të reja të punës dhe të krijimit të vlerës së re, rritjes së të hyrave buxhetore, shtimin e kontributeve humanitare dhe përmirësimin e mirëqenies së njerëzve.

Dihet gjithashtu, se infrastruktura rrugore është faktor kryesori i zhvillimit ekonomik të një vendi apo rajoni. Komunikacioni rrugor është kusht elementar për zhvillimin e biznesit sepse, u mundëson prodhueseve/tregtareve t'i shkëmbejnë mallrat e tyre në tregje të njëri-tjetrit. Ndërlidhja rrugore në mes të tregjeve eliminon informatat asimetrike në mes tyre. Prania e informatave asimetrike shkakton selektimin irracional (të padëshirueshëm) dhe pamundëson integrimin e palëve në realizimin e transaksioneve ekonomiko-financiare dhe e ul performancën financiare të firmave (Alchian e Demsetz 1972; Leland e Pyle 1977). Bashkëpunimi ekonomik është një çështje vendimtare për realizimin investimeve të suksesshme. Aksionerët dhe kreditorët (huadhënësit) kërkojnë informacione reale dhe të besueshme (kredibile), të cilat tregojnë cilësinë e sipërmarrësit apo kompanisë. Investitorët dëshirojnë të dinë se cilat projekte garantojnë të ardhura më të larta për kapitalin e tyre (Halili 2013). Prandaj, ndërtimi i Rrugës së Arbrit do ndriçojë në treg, do t'i eliminojë informatat asimetrike në lidhje me ekonomitë e këtyre rajoneve. Rruga e Arbrit do të këtë ndikim pozitiv në shtimin e volumit të investimeve nga bizneset e brendshme dhe të jashtme.

Hapja e kësaj rruge mundëson që ekonomia kombëtare të zhvillohet më shpejt si rezultat i shfrytëzimit efektiv të përparësive natyrore që ofron njëri rajon në krahasim me tjetrin. Zhvillimin ekonomik bazuar në përparësitë natyrore mundëson të ardhura më të larta për investitorët. Përfitimet e palëve janë të ndërlidhura, reciproke dhe të dyanshme (Smith 1776). Bashkëpunimi ekonomik në mes të rajoneve të ndryshme nën ndikimin e ligjit të ofertës dhe kërkesës do të arrijë t'i shfrytëzojë pasuritë njerëzore dhe natyrore në mënyrë racionale. 'Dora e bekuar' e tregut në mënyrë të padukshme do t'i integrojë potencialet e pashfrytëzuara ekonomike (krijuese, prodhuese e shërbyese), duke i ndërlidhur bizneset e zonave të ndryshme me interes të përbashkët ekonomik. Tregu me dorën e vetë të padukshme do të arrijë të shpërndajë investimet në mënyrë racionale në ato projekte dhe rajone, duke rritur aktivitetin ekonomik me qëllim të maksimalizimit të të ardhurave pronarëve të kapitalit dhe të investitorëve të tjerë.

Në përfundim duhet theksuar se, duke lidhur ekonominë e këtyre rajoneve, Rruga e Arbërit në mënyrë multiplikative do të ndikoj në zhvillimin e shumë sektorëve të rinj të biznesit. Shumë resurse të reja të cilat deri më tani kanë qenë të pashfrytëzuara do të aktivizohen, do të rritet fuqia ekonomike e atyre zonave, do të ngrihet prestigji i ekonomisë shqiptare dhe do të eliminohen informatat asimetrike në treg në favor të ekonomisë sonë në përgjithësi. Kjo ndërlidhje ekonomike do të ndikojë në mënyrë të rëndësishme në rritjen e PBB-së si rezultat i rritjes së kërkesave për mallrat e këtyre rajoneve në tregjet e ndryshme. Ndikimi shumësektorial i kësaj rruge do të reflektohet në rritjen e fuqisë së ekonomisë kombëtare e rajonale dhe posaçërisht në ngritjen e mirëqenies njerëzore.

Ky aks rrugor lirisht mund të thuhet se ka shumë tipare të Rrugës së Kombit Durrës-Prishtinë. Jam shumë i sigurt se kostoja e rrugës do të mbulohet për një afat shumë të shkurtër. Të ardhurat dhe përfitimet e tjera që do të rrjedhin prej saj do të jenë të shumëfishta dhe ekonomikisht të pa kontestueshme. Andaj, mund të përfundoj se nuk ka nevojë aspak të hezitohet, por duhet të fillohet dhe të përfundohet ndërtimi i Rrugës së Arbrit sa më shpejtë që të jetë e mundur.

REFERENCAT:

Alchian, AA & Demsetz, H 1972, 'Production, Information Costs, and Economic Organization', The American Economic Review, vol. 62, no. 5, pp. 777-795.

Eftimi, R & Frashëri A 2012, 'Thermal and Mineral Waters of Albania and the Platform of their Integrated and Cascade Use', 3rd International Conference GEOSCIENCES AND ENVIRONMENT 27-29 May 2012, Belgrade.

Fthenakis, V & Kim, HC 2009, 'Land use and electricity generation: A life-cycle analysis', Renewable and Sustainable Energy Reviews, 13, pp. 1465–1474.

Halili, E 2013, 'Long-Term Operating Performance: An Empirical Examination of Family and Non-Family Firms Listed in Australia, Unpublished Thesis, Swinburne University of Technology, Melbourne, Australia.

Hoxha, V, Lleshi, B, Aliu, I, Shabani, S, & Karaj, N 2007 'Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës vihet në qarkullim ekonomik me ndërtimin e Rrugës së Arbërit', Gazeta Rruga e Arbërit, Nr.13, maj, fq.3

Hoxha, V 2007, 'Rruga e Arbërit, rruga e zhvillimit të Shqipërisë Lindore: Pasuritë dhe problemet", Gazeta Rruga e Arbërit, Nr.10, shkurt, fq.3-6.

Leland, EH & Pyle, HD 1977, 'Informational Asymmetries, Financial Structure, and Financial Intermediation', The Journal of Finance, vol. XXXII, no. 2, pp. 371-387.

Lleshi, B 2006, 'Rruga e Arbërit, rrugë kryesore e vendit krahas rrugës Egnatia që në lashtësi', Gazeta Rruga e Arbërit, Nr.4, gusht 2006, fq.4-5

Molden, D (Ed) 2007, 'Water for food, Water for life: A Comprehensive Assessment of Water Management in Agriculture' Earthscan/IWMI.

Shenjatari, A 2007, 'Rruga e Arbërit dhe resurset natyrore të Rrethit të Matit', Gazeta Rruga e Arbërit, Nr.13, maj, fq.3

Smith, A 1776, 'Wealth of Nations', Prometheus Books, Printed 1991, New York.

Rruga e Arbrit do ta bashkojë Tiranën me Dibrën

Shkumbin Hysa, DEBAR, MACEDONIA: Unë mendoj dhe shpresoj që kjo rrugë do të ndikojë shumë në zhvillimin ekonomik të vetë qytetit tim si dhe të gjithë rajonit.

Bajram Dedja, TIRANË, ALBANIA: Kam lindur në Peshkopi.

Robert Bushati, TIRANA, ALBANIA: Në radhë të parë është e rëndësishme për KOMBIN SHQIPTAR, duke e parë nga të gjitha këndvështrimet, pastaj direkt ose indirekt na shërben të gjithëve prej nesh.

Ledi Nano, ITALY: Për të ndërtuar një Shqipëri më të mirë.

Kristaq Jorgo, TIRANA, ALBANIA, ALBANIA: Rruga është qytetërim. «Rruga e Arbrit» ka qenë, duhet të jetë dhe do të jetë një ndër simbolet e Qytetërimit Shqiptar".

Liridona Hoxha, TIRANA, ALBANIA: Normalisht që është e rëndësishme ndërtimi i kësaj rruge. Janë të burgosura të gjitha ata bukuri, ku të them të drejtën nuk mund të veçoj ndonjërën prej tyre. Ndërtimi i rrugës do të ishte zgjidhja më e mirë e mundshme si për banorët e gjithë rrethit të Dibrës por edhe për të gjithë të tjerët që kanë një kureshtje për ta vizituar, por që tërhiqen për shkak të rrugës, largësisë dhe infrastrukturës. E çfarë tjetër mund të kërkoj unë si një ish-banor e këtij rrethi kur në atë territor aq të vogël janë një gamë e madhe bukurish. Mali më i lartë në të gjithë territorin, 7 liqenet akullnajore më të mrekullueshëm të vendit dhe normalisht lumi më i gjatë i vendit. Jam me të vërtetë më tepër se KRENARE dhe e LUMTUR për prejardhjen time, për fshatin ku unë kam lindur dhe për të gjithë Peshkopinë !

Odette Marquet, TIRANA, ALBANIA: Kontaktet midis njerëzve.

Viktor Lleshi, DURRES, ALBANIA: Sepse Dibra (Peshkopia) është vendlindja ime.

Nexhat Hoxha, TIRANA, ALBANIA: Sepse është shumë e rrezikshme rruga dhe dua një rrugë më të mirë dhe nuk dua të kem frikë sa herë shkoj në Dibër.

Xhelal Hasani, PREŠEVO, SERBIA: Kam shoqëri në Peshkopi dhe dua që të më lehtësohet udhëtimi deri atje.

Shkelzen Voka, ALBANIA: Sepse është shumë e vështirë rruga aktuale.

Indrit Kodra, TIRANA, ALBANIA: Infrastrukturë më të mirë.

Armand Karoshi, FUSHE ALIE, DIBER, GREECE: Sepse është vendi im dhe dua të krijohen kushte për mua që ta vizitoj Dibrën më shumë.

Enjana Hoxha, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo gjë është e rëndësishme për mua sepse Dibra e meriton ndërtimin e kësaj rruge që të këtë një zhvillim të gjithanshëm.

Gentian Cajka, BIRMINGHAM, UNITED KINGDOM: Sepse e vizitoj Peshkopinë çdo vit.

Mirjan Nurçja, BULQIZË, ALBANIA: Pasi Bulqiza e meriton një rrugë të tillë, me aq sa ka bërë miniera për shtetin shqiptar e për tërë Shqipërinë, nuk kërkojmë shumë.

Lulzim Plloçi, TIRANA, ALBANIA: Unë jam nga krahina e Martaneshit dhe ndërtimi i kësaj rruge është shumë i rëndësishëm për jetesën dhe të ardhmen e kësaj krahine të lënë mbas dore nga çdo qeveri politike prandaj unë kërkoj "Ndërtoni sa më shpejt dhe me standarde Rrugën e Arbrit", me pak fjale mbani premtimin që i keni dhënë votuesve tuaj në qarkun e Dibrës.

Flogerti Mandri, PESHKOPI, ALBANIA: Që të mbarohet ndërtimi i rrugës së Arbrit.

Adriatik Çekiçi, BULQIZË, ALBANIA: Rruga e Arbrit, do i sillte zonës së Dibrës një zhvillim ekonomik.

Ermira Dedja, DURRËS, ALBANIA: Për të më afruar me njerëzit e mi.

Ermira Maksuti, UDDEVALLA, SWDEN: Mendoj që duhet patjetër të përfundojë rruga e Arbërit.

Orgeta Dani, TIRANA, ALBANIA: Sepse dhe unë jam dibrane dhe dua që Dibra të lulëzojë.

Edon Muqaj, SKOPJE, MACEDONIA: Sepse do të jetë vërtetë mirë për udhëtim.

Dina Rama, Gemb GERMANY: Rruga e Arbrit duhet ndërtohet sa më shpejt, do ishte hapi i parë në zhvillimin e Veriut të Shqipërisë dhe lidhja me tokat tjera Shqiptare.

Afrim Sejdiu, PRISHTINA, KOSOVO: Turizëm/ Siguri.

Mario Trepca, SEYMOUR, CT: Ky projekt është i rëndësishëm për mua sepse do të sjellë zhvillim ekonomik dhe begati për të dy anët e shqiptarisë.

Albi Doda, DURRëS, ALBANIA: Ka njerëz që nuk e dinë ca bukurish fsheh ky vend.

Erzen Tola, TIRANA, ALBANIA: Jam lindur atje.

Ornela Hoxha, TIRANE, ALBANIA: Që të mbarohet ndërtimi i Rrugës së Arbrit.

Artur Stafa, TIRANE, ALBANIA: Mjafton të shohësh hartën...

Verdi Selishta, HERAKLION, GREECE: Sepse është shumë më lehtë për t'u lidhur me Tiranën dhe më tej, gjithashtu zhvillimi i zonës do të jetë i paparë.

Niko Gjoni, GERMANY: Të zhvillohet i tërë rexhioni dhe njerëzit të kenë një lidhje ndërmjet veti por edhe turizmi do të shtohej.

Viola Kryemadhi, DIBRA, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra dhe jam studente në Tiranë. Më duhet të udhëtoj shumë dhe është e vështirë sepse është kaq larg... Kështu që shkoj në shtëpi njëherë në tre katër muaj.

David Sina, TIRANA, ALBANIA: Shkojmë më shpejt në vendlindje :)

Mirela Alcani, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për mua sepse jam nga Dibra. Kam jetuar atje edhe e di se sa e vështirë është të shkosh andej.

Sara Feti, TIRANA, ALBANIA: Dua të shkoj dhe të vij me lehtësi nga Tirana në Dibër.

Aida Mehmeti, TIRANA, ALBANIA: është e rëndësishme për mua sepse përveç vlerave historike bën të jem më afër me të afërmit e mi.

Elena Mazari, PESHKOPI, ALBANIA; shkolla: objektivi kryesor.

Fehmi Tançi, BULQIZE, ALBANIA; Për gjithçka: jetesën, biznesin etj.

Inida Noga, TIRANA, ALBANIA: Është një investim i mirë me përfitime jo vetëm për Shqipërinë por për gjithë rajonin.

Arjan Saraçi, PESHKOPIA, ALBANIA: E duam këtë rrugë mjaft vuajtëm... vetëm premtime boshe kemi deri tani...

Andi Shkurti, TIRANA, ALBANIA: Progres.

Erion Hoxha, ELBASAN, UNITED STATES: Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Jonida Çera, TIRANA, ALBANIA: Jam me origjinë nga Dibra.

Fagiona Xhemali, GENEVA, SWITZERLAND: Shqipëria e bashkuar është më e bukur :) Na duhen rrugët e sakta, se na sakatosën gropat! Shqipëria ka nevojë për një infrastrukturë të përsosur.

Alfred Cami, DIBER, ALBANIA: Që të mbarohet rruga ...

Lorenca Bejko, TIRANE, ALBANIA: Ju lutem nënshkruani peticionin për të përfunduar misionin e "Rrugës së Arbrit" që të kemi lidhje automobilistike me te shpeshta me bashkëkombësit tanë dhe me gjerë...:)

Afrona Vrzivoli, DEBAR, MACEDONIA: Do ta sjellë Shqipërinë afër Dibrës, kështu që shqiptarët e Maqedonisë mund të shkojnë të studiojnë në Shqipëri në gjuhën e nënës.

Ariola Ziraj, TIRANA, ALBANIA: Ata njerëz kanë nevojë për të.

Bajram Maksuti, MAQELLARë, ALBANIA: Kur të bëhet rruga e Arbrit Dibra lind për së dyti.

Ariola Alku, PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtimi i Rrugës së Arbrit është e rëndësishme që Dibra dhe kryeqyteti Tirana të lidhen në një hapësirë më të shkurtër.

Bora Asllani, DISTRETTO DI TIRANA, ALBANIA: Sepse është vendlindja ime.

Fab Fab, ATHENS, GREECE: Sepse e dua Dibrën.

Sidrit Gjoni, TIRANA, ALBANIA: Po të ndërtohet ky aks rrugor ndihmon zhvillimin ekonomik të asaj pjese të vendit por dhe vetë Tiranën duke afruar kryeqytetin me ato zona dhe me Maqedoninë.

Matilda Pepa , TIRANE, ALBANIA: Bashkimi me Tiranën.

Zenel Losha, TIRANE, GREECE: Sepse atje kam fshatin tim.

Halim Ilnica, TIRANA, ALBANIA: Sepse kjo rrugë do të ndryshojë krejtësisht vendlindjen time.

Bledar Buzhiqi, KLOS, ALBANIA: Sepse Tirana mbetet vetëm 25 minuta larg këtij qyteti.

Marsida Selmani, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për punën time.

Albi Farruku, BURREL, ALBANIA: Dibrën e dua të gjithë po veç na bëhet ajo rruga e Arbërit. Të gjithë e duam rrugën e Arbërit.

Ketrina Kurti, DURRES, ALBANIA: Për të pakësuar aksidentet pikë së pari e për të udhëtuar të sigurt.

Liridona Hoxha, TIRANA, ALBANIA: E dua Peshkopinë.

Lec Nelushi, LONDON, UNITED KINGDOM: Lidh një pjesë shumë të rëndësishme të Shqipërisë, përveç Dibrës që është pjesë e zemrës të kombit, o ashtu kuptohet se e kam fjalën për Shqipërinë dhe shqiptarët që sot janë nën FYROM!

Florian Elezi, PESHKOPI, ALBANIA: Social-ekonomike.

Avdi Delishi, PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtimi i rrugës se Arbrit është një zhvillim i madh për të gjithë.

Bekim Hashani, GERMANY: Suksese, së bashku do t'ia dalim.

Rudi Toçi, TIRANA, ALBANIA: Kam prindërit në Dibër dhe unë studioj në TR dhe do të doja që kjo rrugë të bëhet që unë mund të shkoj sa më shpesh te ta.

Prof Lutfi Alia, ITALY: Politikanët shqiptarë, duhet të ndërgjegjësohen për vepra të tilla të rëndësishme, nuk duhet të presin t'i sugjerojmë, pasi kësisoj ata nuk po kryejnë detyrat që i ka besuar populli. Kjo rrugë duhej të ishte ndërtuar shumë kohë më parë, uroj që ky peticion t'i zgjojë nga gjumi e të veprojnë.

Furkan Curri, SHKUP, MACEDONIA: Ndërtoni Rrugën e Arbërit, qetësojini bashkëkombasit!

Sarie Hafizi, TIRANA, ALBANIA: Kam prindërit në moshë të thyer në Dibër dhe kanë nevojë për përkujdesjen time, por duke qenë e mbingarkuar me punë dhe koha shumë e kufizuar e bën të pamundur të vizitoj shpesh duke parë se rruga zgjat shumë.

Manuela Zerja, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse e bej shpesh rrugën Tiranë-Peshkopi dhe është shumë e gjatë dhe e lodhshme.

Redona Hafizi, TIRANA, ALBANIA: Gjyshërit e mi jetojnë atje dhe dua që të kem mundësi t'i vizitoj më shpesh.

Sara Al Ajmi, KUWAIT CITY, KUWAIT: Dua të vizitoj krahinën e Dibrës një herë.

Anjeza Shatku, DISTRETTO DI TIRANA, ALBANIA: Sepse është rrugë dhe rruga lidh njerëzit.

Viola Nure, TIRANA, ALBANIA: Shqipëria e Bashkuar :)

Reis Mulita, TIRANA, ALBANIA: Kjo rrugë është shumë e rëndësishme për shkak të ndikimit social, ekonomik, trashëgimisë dhe ndikimit. Do të sjellë zhvillim ekonomik rajonal dhe social. Gjithashtu forcon identitetin shqiptar në një epokë të re të bashkëpunimit rajonal.

Anisa Pupli, TIRANA, BULGARIA: Gjyshi im jeton andej.

Erion Çenga, PESHKOPI, ALBANIA: Për zhvillimin e vendit.

Arber Çenga, TIRANA, ALBANIA: Jam i dashuruar me këtë vend.

Fatbardha Koxhaj, TIRANA, ALBANIA: E dua Dibrën.

Roland Reçi, ITALY: Rruga e Arbrit është shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqërore të Dibrës.

Etjon Shehu, ITALY: Sepse është një e drejtë për dibranët.

Agim Mëziu, OXFORD, UNITED KINGDOM: Se i jep përparësi vendit tim.

Esmeralda Laçi, TIRANA, ALBANIA: Është vendlindja ime... është gjaku im.

Florjan Hidri, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse sjell zhvillim për pjesën e lindjes së Shqipërisë.

Julian Vraniçi, PESHKOPI, ALBANIA: Një rrugë e domosdoshme për qarkun e Dibrës dhe për ekonomin e këtij qarku. Rruga Tiranë-Peshkopi që është 180 km me rrugën e Arbrit arrin 100 km çka do të thotë që Peshkopi-Tiranë të bëhet për 1 orë e gjysëm.

Ina Allaraj, TIRANA, ALBANIA: Kjo rrugë do të përmirësojë infrastrukturën që lidh Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Malvina Cala, TIRANE, ALBANIA: Dibra është vendi im i origjinës dhe duhet ta them që kjo rrugë është shumë e rëndësishme për infrastrukturën, për zhvillimin, për turizmin dhe shumë aspekte të tjera për të cilat ka nevojë ky vend.

Mbi modalitetet e nënshkrimit të peticionit online për Rrugën e Arbërit

Dëshirojmë të njoftojmë gjithë lexuesit se peticioni online për Rrugën e Arbrit do të vazhdojë të firmoset dhe ai do të mbyllet vetëm kur të përurohet rruga Tiranë-Dibër.

Shumë qytetarë në Shqipëri dhe në vende të tjera kanë komunikuar me redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit" dhe hartuesin e peticionit për të konfirmuar se e kanë nënshkruar atë si dhe për tu interesuar nëse nënshkrimet e tyre janë regjistruar.

Pavarësisht ftesave të ripërsëritura për ta firmosur peticionin, njoftojmë se vetëm nënshkrimet që përmbushin kriteret e rrepta të transparencës të përcaktuara që kur filloi peticioni, do të përfshihen në dokumentin zyrtar që do t'i dorëzohet qeverisë së re.

Ju rikujtojmë se kush e ka nënshkruar peticionin online, nuk duhet ta firmosë për së dyti, si dhe nuk ka të drejtë ta nënshkruajë atë në letër.

Lista e plotë e nënshkrimeve dhe komentet e bëra online do të jenë dokumente publike.

Gjithashtu, njoftojmë gjithë ata që kanë firmosur peticionin në letër, t'i sjellin ato sa më shpejt në redaksi, pasi procesi i përgatitjes së peticionit për t'iu dorëzuar qeverisë shqiptare ka filluar.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj!



NDIQ HAPAT E MËPOSHTME PËR TË FIRMOSUR SAKTË:

1 - KLIKO NË FAQEN E WEB SI MË POSHTË:
www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-thearb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarderrug% C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

2- LART, DJATHTAS SHFAQEN KUADRATET BOSH
Shkruaj Emrin, Mbiemrin, Adresën e emailit dhe Qytetin tuaj. Pastaj klikon **"Sign".**
Pas kësaj, ju do të merrni një mesazh falënderimi dhe konfirmimi që emri juaj u regjistrua.
Për të gjithë miqtë tuaj që nuk kanë mundësi hyrje në web,
sharko formularin dhe plotësoje me dorë.
Për hollësi mund të vizitoni faqen e gazetës
në Web: <**www.rrugaearberit.com**>
ose në Facebook <**facebook.com/gezim.alpion**>
ose <**facebook.com/rruga.arberit**>

Firmëtarë të tjerë për Rrugën e Arbrit

Nga **ILMI DERVISHI**

Gjatë ditëve të Panairit të librit në Tiranë, shoqërova për disa ditë një mikun tim nga Gjirokastra, Thoma Naka. Mes bisedave për librin, u diskutua dhe për Rrugën e Arbrit. Ai pyet: Kam dëgjuar për Rrugën e Arbrit në media, më thuaj diçka më shumë!

Dhe për t'ia bërë më të qartë e më të kuptueshme çështjen mikut tim nga Gjirokastra, përdora një citim nga inciatori i rrugës, z. Hysen Uka: "Nga qendra e Tiranës dalin katër rrugë nacionale: "Rruga e Elbasanit" që të çon në Elbasan, "Rruga e Durrësit" që të çon në Durrës, "Rruga e Kavajës" që të çon në Kavajë dhe "Rruga e Dibrës që të çon te... shkolla e bashkuar". "Dmth, rruga e Dibrës nuk të çon në Dibër?, pyet miku im Naka.. I shpjegoj atij se ajo të çon në Dibër, por tani për tani, vetëm po të ecësh në këmbë.

Pastaj i shpjegoj shkurtimisht mikut tim historinë e rrugës, karvanet e kohës së Turqisë, hanet dhe karakollet gjatë rrugës, lidhjet tregtare mes Dibrës e Tiranës, etj. Kjo rrugë lidhte Tiranën me Burrelin, Bulqizën, Dibrën, Tetovën e deri në Shkup. U fol shumë për prioritetet, fitimin dhe domosdoshmërinë e ndërtimit të kësaj rruge, e cila këto vitet e fundit është në qendër të vëmendjes të qeverisë.

Gazetarja Teuta Isufaj Taramani, pas botimit të një shkrimi dhe një cikli poezie miat te revista "Fjala Shkaba" nr. 9., 2013, pashë se po këtë numër në revistë, e cila botohet në Shkodër, ishte botuar edhe një shkrim në faqen 5 me titull "Rruga e Arbërit, arteria e dytë me Ballkanin" me autor Festim Ceni. Një shkrim mjaft informues, por dhe një përpjekje për të treguar


Rruga e Arbërit,
Arteria e dytë me Ballkanin

se sa e domosdoshme ka qenë dhe është e do të jetë ndërtimi i kësaj rruge.

Mes të tjerave autori shkruan: "Kjo rrugë shërbente në mënyrë të veçantë për tregtinë me Venedikun, Raguzën, Romën etj., me vendet lindore të Adriatikut. Për këtë dëshmojnë edhe dy dokumente të vjetra: E para në fillim të shekullit të XIII, ku Dhimitri "Princi i madh i Arbrit" garanton kalim të sigurt në tokat e tij, pra nëpër rrugën e Arbrit. E dyta është viti 1429, e cila është firmosur nga Gjon Kastrioti dhe bijtë e tij, ku figuron dhe Gjergj Kastrioti. Rruga e Arbrit është përdorur gjerësisht në kohën e Gjon Kastriotit dhe të birit të tij Skënderbeut". (Festim Ceni, revista "Fjala Shkaba", nr. 9, f. 5, 2013).

Miku im nga Gjirokastra dhe miqtë e mi nga Shkodra, ashtu si gjithë shqiptarët e duan Rrugën e Arbërit, jo si rrugë për Dibrën, por si rrugë për Shqipërinë.

Ministri i Energjetikës, Damian Gjiknuri, ka urdhëruar pezullimin e pjesshëm të aktivitetit minerar kromnxjerrës në Zonën D.

Zona D, pesë minatorë tentojnë të vetëdigjen

Nga **HYSEN LIKDISHA**



Pesë minatorë në Zonën D, të minierës së Bulqizës, tentojnë të vetëdigjen në shenjë proteste, pasi Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (MEI), gjatë një kontrolli teknik të ushtruar në mesin e muajit nëntor në galeritë ku ata punonin, ka urdhëruar mbylljen e tyre, ku at nxirrnin bukën e gojës. Minatorët kanë tentuar t'i japin fund jetës,duke u lyer me benzinë , por fatmirësisht janë shpëtuar nga anëtarët e sindikatës së minatorëve, të cilët janë vënë në dijeni rastësisht për këtë vendim të pesë minatorëve. Kjo ka sjellë reagimin e menjëhershëm të Sindikatës së Minatorëve, e cila ka kërkuar ndërhyrjen e Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë, ndërkohë që kjo e fundit është shprehur e vendosur për pezullimin e punimeve në këtë zonë.

PROTESTA

Informacioni për pesë minatorët, të cilët punonin në Zonën D, është dhënë nga vetë kreu I sindikatës, Agron Basha, i cili ka deklaruar se janë jo pak, por 105 minatorë , të cilët kanë mbetur të papunë për shkak të pezullimit të punimeve në këtë zonë minerare. Sipas kreut të sindikatës mësohet se shkak për ndërmarrjen e akteve ekstreme nga minatorët është gjendja e vështirë ekonomike e tyre. –"Për ne nuk është e rëndësishme se kush është fajtor për këtë mbyllje, me rëndësi është që ne të punojmë. Minatorët I zbuluam me kohë dhe nuk I lejuam të kryenin aktin ekstrem fatal për jetët e tyre. U kam nisur të gjitha institucioneve shkresat e duhura për ecurinë dhe aktin e bllokimit të punës pa kriter. Minatorët kanë kushte të vështira ekonomike, kanë marrë kredi, overdrafte dhe duke mos punuar kanë vendosur të marrin aktin e vetëflijimit", deklaroi gjatë atyre ditëve kryesindikalisti Basha. Sipas tij galeritë janë bllokuar me pretekstin se nuk plotësojnë kushtet e sigurisë, gjë që nuk është e vërtetë se në këto galeri ne kemi vijuar të punojmë prej vitesh.

MINISTRIA

Ndërkaq menjëherë ka reaguar Ministria e Energjisë dhe Industrisë, duke deklaruar se ka urdhëruar pezullimin e pjesshëm të aktivitetit minerar në Zonën D, për arsye se nga kontrollet e ushtruara në galeritë e kësaj zone është konstatuar nga RISHM-i se në to ka probleme me plotësimin e kushteve të sigurisë për punë në to, kushte të paplotësuara nga kompania nënkonçensionare Tur-Alba,e cila I ka menaxhuar së fundmi këto galeri. Referuar këtyre problemeve, ministri i Energjetikës, Damian Gjiknuri, ka urdhëruar pezullimin e pjesshëm të aktivitetit minerar kromnxjerrës në Zonën D. Është detyrë e MEI, që të monitorojë zbatimin e marrëveshjeve kontraktuale mes shtetit dhe subjekteve private, veçanërisht sa I takon zbatimit të kushteve të sigurisë teknike. Ligji përcakton gjithashtu kushtet minimale që duhen plotësuar që një subjekt të vazhdojë aktivitetin minerar. Në të kundërt shteti nuk duhet të rrijë duarkryq, por ministria ka detyrimin ligjor që të pezullojë çdo marrëveshje e cila bie ndesh me përcaktimet ligjore dhe cenon sigurinë e jetës së minatorëve të punësuar.

Duke e konsideruar prioritet jetën e minatorëve, Ministria e Energjetikës dhe Industrisë refuzon çdo akt që bie ndesh me këtë parim dhe i kërkon policisë së shtetit që të hetojë çdo rast presioni që zotërues të lejeve minerare ushtrojnë në mënyrë direkte apo indirekte ndaj institucioneve shtetërore, për të neglizhuar zbatimin e ligjit dhe standardeve minerare në marrëveshjet kontraktuale, u tha në reagimin e MEI-t.

Sindikata e minatorëve:

Duam rritje page dhe kushte sigurie në punë

Sindikata e minatorëve, u është rikthyer kërkesave të grevës 3 mujore zhvilluar dy vite më parë, për rritje pagash dhe kushte të sigurisë në punë. Nëpërmjet një peticioni dërguar ministrit të Ekonomisë, Damian Gjiknuri dhe administratorit të përgjithshëm të kompanisë konçensionre "Balfin Grup" që aktualisht menaxhon minierën, sindikalistët minatorë u janë rikthyer kërkesave për rritjeje pagash dhe kushte të sigurisë në punë, por jo vetëm. Sipas kryetarit të konfederatës së sindikatave, Dilaver Përkoxha, mësohet se peticioni përmban 6 kërkesa kryesore që duhen realizuar sa më parë nga konçensionari, për ecurinë normale të punës në minierë. Para së gjithash sindikalistët kërkojnë kushte pune, që galeritë e minierës të mos jenë galeri të vdekjes siç dhe janë aktualisht. Detyrimisht duhet vazhduar me hapjen e thellësisë së minierës poshtë nivelit të 16-të, për të vënë në efiçencë rezervat e mineralit të kromit, gjë e cila do t'i shërbejë mbajtjes në këto nivele prodhimi të mineralit, si dhe zgjatjes së jetëgjatësisë së minierës. –"Kërkojmë rritjen e pagës së minatorëve, pasi ajo nuk ka ndryshuar prej vitesh, si domosdoshmëri kjo edhe ekonomisë së tregut ku çmimet kanë vijuar rritje nga viti në vit dhe ku aktualisht paguhemi me një pagë qesharake që varion nga 30 deri në 50 mijë lekë në muaj. Heqja e taksës së sheshtë për ne minatorët, ku risku i jetës dhe vdekjes për ne minatorët shkon në 50 me 50 përqind. Një tjetër kërkesë e kahershme e minatorëve mbetet edhe ajo për statusin e minatorit, që deri më sot për çdo qeveri ka rënë në vesh të shurdhët. Në minierë, ku aktualisht punojnë 700 punonjës, duhet rikthyer urgjentisht shërbimi mjekësor, me të paktën për 2 mjekë sipas legjislacionit në fuqi, si dhe duhet vendosur kirurgu e reaminatori në spitalin e Bulqizës, pasi vetë natyra e punës në galeri e bën të domosdoshëm këtë shërbim për minatorët, ku deri më tani të gjitha rastet e aksidenteve që për vetë natyrën e punës kanë qenë të rënda dhe me humbje jete, janë transferuar në Spitalin Ushtarak në Tiranë.

Kohëve të fundit, kompania "Balfin Grup", jo vetëm që nuk ka rritur pagat, por edhe i ka ulur ata, duke rritur normat edhe pse nuk ka patur elemente të rritjes së mekanizimit të minierës, por punohet ende me lopata e karroca, pasi investimet në minierë kanë rezultuar në nivele të ulta dhe të papërfillshme për të mos thënë fare.Ndërkohë, një tjetër kërkesë në adresë të kompanisë, mbetet edhe ajo për pagimin e lejes së zakonshme me 22 ditë, si dhe marrja në punë e 4 minatorëve, të cilët nuk janë shpallur fajtorë nga Prokuroria dhe Gjykata e Dibrës, për një aksident me humbje jete të një minatori.

Në rast të mos realizimit të këtyre kërkesave, thuhet më tej në këtë peticion, sindikata kërcënon se do të ndërmarrë të gjitha format e protestës deri në bllokimin e evadimit të mineralit drejt Portit të Durrësit.

Zhbllokimi i transportit të kromit

Biznesmenët: Ligjin e kemi shkelur të gjithë bashkë

Të paktën prej 4 vitesh në të ashtuquajturën Zona D e minierës së Bulqizës, ka vijuar puna e jashtëligjshme. Kështu është deklaruar nga biznesmenët e kromit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë zonë, gjatë një tryeze pune, të organizuar nga kryebashkiaku i Bulqizës, Myfit Duriçi, mes biznesmenëve dhe strukturave shtetërore në qarkun e Dibrës.

Tryeza e organizuar për zhbllokimin e transportit të kromit drejt Portit të Durrësit, evidentoi e nxori në dritë të gjithë problematikën që shoqëron aktivitetin minerar kromnxjerrës në këtë zonë. Kështu biznesmenët në fjalën e tyre theksuan se problematika në mbarëvajtjen e punës kromnxjerrëse në Zonën D është shumë më e gjërë se problemi i transportit të mineralit për shoqërimin me faturë tatimore. "Nuk është problemi vetëm këtu, pasi absolutisht prej 4 vitesh, thanë ata në fjalën e tyre, nuk ka funksionuar ligji në tërësinë e tij për shfrytëzimin e galerive. Ka raste edhe të stimulimit edhe të problemeve që s'duhet t'i themi këtu.

Fatura e shoqërimit u ra dakord prej tyre se duhet plotësuar me të gjithë elementët e saj, përfshirë edhe peshën dhe çmimin, i cili do vendoset sipas kostos së nxjerrjes së kromit nga galeritë. Në Zonën D prodhohen mesatarisht 15 mijë ton krom në muaj, ndërkohë që në eksport gjatë vitit janë shitur 88 mijë ton krom, kur i bie që të shiteshin 190 mijë ton. Nuk ka funksionuar fare asgjë, shteti është bërë aksioner me biznesin. Policia qe bërë aksioner me biznesmenët e kromit, nuk ka funksionuar asgjë. Vjen kontrolli dhe nuk ka të përfshirë në ekip një përfaqësues biznesi. Ndërkohë nga biznesmenët u kërkua që ata të organizoheshin në një shoqatë për t'u mbrojtur e zgjidhur më lehtë problemet e tyre.

Shefi i Komisariatit të Policisë Bulqizë, Niko Nikollaj, pjesëmarrës në këtë takim u kërkoi biznesmenëve plotësimin me imtësi të dokumentacionit ligjor për ta, si dhe kërkoi shkëputjen e partneritetit të tyre me subjektet e paligjshme që operojnë në të ashtuquajturën Zona D.

Gjithashtu, ai garantoi biznesmenët se kontrolli në vijimësi do jetë gjithëpërfshirës ku do kontrollohet jo vetëm transporti drejt Portit të Durrësit, siç kemi operuar deri më tani, por do shtrihet edhe në dokumentacionin për kërkim-zbulim apo shfrytëzim, pasi do përballen me bazën ligjore që vepron në shtetin shqiptar.

Për subjektet që disponojnë dokumentacionin e nevojshëm, puna do vazhdojë 24 orë pa pushim .

H.Likdisha

Në Dibër të Madhe u mbajt protesta
kundër Qeverisë se Maqedonisë dhe ELEM-it

Rruga e Arbërit nr. 91

Projekti *i hidrocentralit të* **Lukovës** *është me pasoja shkatërruese për* **Dibrën**

Nga **REXHEP TORTE**



Foto e marrë nga faqja në Facebook "STOP Devijimit të rrjedhes te lumit Radika"

Të shtunën më datë 30 nëntor 2013, në Sheshin "Skëndërbe" në Dibër të madhe dibranët protestuan kundër ndërtimit të HC "Fushë të Lukovës" nga ELEM-i, ku tentohet të merret uji nga përrenjtë e Lumit Radikë për mbushjen e këtij liqeni artificial dhe që më pastaj ky ujë të derdhet në lumin Vardar dhe të shkojë në detin Egje.

Kjo do ta shteronte Lumin Radikë duke shkaktuar dëme të mëdha në aspektin ekologjik, të biodiversitetit, florës dhe faunës dhe në ekonominë e Dibrës dhe të kësaj zone. Në këtë protestë merrnin pjesë banorët e Dibrës, përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe të institucioneve të tjera dhe të shoqatave joqeveritare të zonës përreth dhe nga qytetet e tjera ku jetojnë dibranët

Dritan Lleshi, udhëheqës i grupit bashkërendues për organizimin e kësaj proteste, para të pranishëmve në këtë tubim tha se "Jemi tubuar këtu, për të protestuar kundër një projekti absurd të firmës Elem, që në mënyrë të njëanshme, pa na pyetur, pa na konsultuar, dëshiron të konstruktojë një hidrocentral në Fushën e Llukovës duke devijuar rrjedhën e lumit Radika, gjë, që shkatërron eko-sistemin e Dibres dhe rajonit, për të çuar ujërat e këtij vendi në Maqedoninë Lindore dhe Greqi".

"Historia e kësaj firme për qytetin tonë është e dhimbshme", tha Lleshi. "Hidrocentrali i Spiles, i ndërtuar nga kjo firmë, asnjëherë nuk ka mbajtur premtimet dhe ka neglizhuar vazhdimisht kërkesat për punësim të shqiptarëve dhe minoriteteve tjera në vend, asnjëherë kjo firme nuk ka financuar projekte mbi arsimin, sportin, kulturën dhe infrastrukturën e Dibrës, pavarësisht se ky hidrocentral merr frymë nga Dibra. Kjo mizerje vazhdon akoma edhe sot.

Në kohën kur qytetarët presin të rregullohet ndonjë problem në lidhje me ELEM-in, ata tentojnë që për radhën e dytë ose të tretë, të na gënjejnë për një projekt gjoja fatsjellës për rajonin tonë. Por ne nuk gënjehemi më, thekson Lleshi. Sot jemi këtu, që në mënyre unanime të kundërshtojmë këto gënjeshtra që na serviren dhe të themi me plot gojë: Ujin dhe Gjakun nuk e falim dhe për to do luftojmë deri në realizimin e qëllimit tonë. Ne jemi me fat dhe të bekuar, që rajoni ynë është më i pasuri me ujë në Maqedoni, dhe ne nuk do tolerojmë që ky ujë në mënyrë të paprecedente të shkojë diku tjetër.".

Dritan Lleshi, i cili në këtë tubim foli edhe në emër të organizatave të tjera qytetarë në Dibër, tha se "ne nuk njohim asnjë llojë marrëveshje, gjoja të bërë mes dy regjimeve inekzistente, marrëveshje me një shtet që nuk ekziston gjëkundi i quajtur Jugosllavi, të bërë më 1963, por ne kërkojmë zbatimin e marrëveshjeve të ujërave bazuar në ligjet ndërkombëtare të Helsinkit më 1966 dhe asaj të decentralizimit të komunave". "Nuk ka asnjë rast në botën demokratike, ku një vendim sillet pa dëshirën e popullit, përveç se në vendet diktatoriale të së kaluarës. Ne sot nuk kemi frikë nga shtetet diktatoriale dhe nuk do tolerojmë asnjë devijim të ujit pa një koordinim dhe konsultim me popullin e Dibrës. Ne jetojmë në një shtet për të cilin kemi dhënë dhe japim kontribut për zhvillimin dhe ekzistencën e tij, por kjo nuk do te thotë se do të lejojmë padrejtësi të kësaj natyre".

> Nuk do të lejojmë që kjo zonë të kthehet në moçal gjigant, nuk do lejojmë zhdukjen totale të turizmit në këto hapësira, nuk do lejojmë tharjen përfundimtare të tokës së Dibrës, nuk do të lejojmë zhdukjen e florës dhe faunës të këtij vendi. Ne nuk do t'ju lejojmë të shkatërroni jetën e brezave që vijnë" - tha Dritan Lleshi.

Më tej, në fjalën e tij para tubuesve të shumtë në numër, Dritan Lleshi tha se ne "nuk do të lejojmë që kjo zonë të kthehet në moçal gjigant, nuk do lejojmë zhdukjen totale të turizmit në këto hapësira, nuk do lejojmë tharjen përfundimtare të tokës së Dibrës, nuk do të lejojmë zhdukjen e florës dhe faunës të këtij vendi. Ne nuk do T`ju lejojmë të shkatërroni jetën e brezave që vijnë", tha ai.

Ky tubim në Dibër u mbajt nga shoqatat joqeveritare "One dollar for Dibra", "Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit", "Shoqata Humanitare Bamirëse Rome – Hëna", "Shoqata e personave me aftësi të kufizuara-Poraka", "Shoqata e gruas - Dibër", "Shoqata RADIKA-DE", "Shoqata e të burgosurve Politike", "Shoqata Humanitare Nënë Tereza", "Shoqata e Bujqëve", "Shoqata Humanitare Drita", Shoqata për sport dhe peshkim - Trofta" , "Oda regjionale e zejtarëve - Dibër", "Eko-api kultura, Komiteti qendror-rinor", "Qendra për zhvillim demokratik - RITO", "Klubi i Kajakut - RADIKA", "Klubi i Karatesë-Uraniku", "Klubi i ping-pongut - Dibra", "Klubi i basketbollit – PROBASKET", "Klubi i Karatesë -KORABI", "Klubi i Basketbollit - DIBRA JUNIOR", Klubi Futbollistik KORABI" si dhe Grupi i tifozëve "SOKOLAT".

Gjithashtu, këtë nismë e kanë përkrahur fuqishëm edhe Komuna Dibër dhe kryetari.z. Ruzhdi Lata, komuna Zhupë dhe OJQ-të e Rekës dhe Zhupës, si dhe përfaqësues të komuniteteve fetare në Dibër.

Organizatorët e tubimit, me anën e një peticioni që ka mbledhur mbi 4000 firma, kërkon që ky projekt të ndalohet tërësisht, sa më parë dhe sa më shpejt. Ata kërkojnë shoqërisë energjetike Elem-it, qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe asaj të Shqipërisë, që sipas ligjeve ndërkombëtare dhe në të mirë të Dibrës, të pezullojnë çdo aktivitet mbi këtë projekt. Ata i kanë bërë apel edhe subjektet politike në vend, ambasadave të huaja, asaj të BE-së dhe SHBA-së, si dhe qeverisë, që të respektojë vendimin e popullit dhe jo të interesave të tyre të ngushta.

Peticioni dhe letra përcjellëse do ju dërgohet Qeverisë së Republikës të Maqedonisë; Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Qeverisë së Republikës të Kosovës; Bankës Botërore, Grupeve Parlamentare në Republikan e Maqedonisë si dhe z. Ali Ahmetit si përfaqësues legjitim i shqiptarëve në Maqedoni.

"Ne jemi të bindur se vullneti ynë do gjejë mirëkuptim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe institucionet e lartpërmendura, por në qoftë se kërkesa jonë neglizhohet, atëherë ne nuk do ndalemi këtu, do vazhdojmë të mbrojmë interesat tona në mënyrën më demokratike duke Ju drejtuar institucioneve më të larta të drejtësisë në nivel shtetëror dhe atë Ndërkombëtar! Protestat tona do zgjerohen deri te Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian", tha në fund Lleshi.

Ndërsa kryetar i Komunës së Dibrës, Z. Rruzhdi Lata, pas protestës tha për mediat se "Ky projekt është i dënueshëm nga Këshilli Komunal i Dibrës, nga kryetari i Dibrës nga qytetarët e Dibrës". Ai tha se, fatmirësisht kemi edhe përkrahjen e ministrave tanë në Republikën e Maqedonisë, por ndërkohë kërkoi edhe ndihmën e Shqipërisë dhe Kosovës që të mos shndërrohet Radika në shkretëtirë.

"Është thesar që na ka dhënë perëndia dhe uji është i yni dhe të marrë rrjedhën e vetë natyrale dhe të shkojë atje ku e ka vendin e jo atje ku duan njerëzit, të cilët kanë interesa parciale, prandaj përshëndes të gjithë qytetarët dhe gjithë mjetet e informimit për këtë aktivitet shumë efektiv, njerëzor, kulturor, demokratik. Vetëm në këtë mënyrë ne mund të ngremë zërin tonë dhe më tej normalisht do të vazhdojmë veprimet dhe punë ligjore dhe të padëgjueshmërisë qytetare dhe se edhe ajo është formë demokratike."

"Ne kemi pasur bisedime me përfaqësuesit tanë të partive politike, ministrit të ekologjisë dhe të ekonomisë, dhe se të gjithë janë përkrah qëndrimit dhe sjelljes tonë.

Prandaj shpresoj në një zgjidhje fatlume, që të mbetet Dibra e pastër, Radika e pastër, dibranët të mbeten gjithmonë ata që janë, të pastër shpirtërisht, të pastër fizikisht dhe të denjë për të jetuar në këtë qytet", tha për mediat kryetari i Komunës së Dibrës, z. Ruzhdi Lata.

Na ndiqni për më shumë informata në linkun në vazhdim:
https://www.facebook.com/groups/radikadheliqeniidibres/?fref=ts

Ndal devijimit të rrjedhjes së lumit **Radika**!

Retrospektivë e ngjarjeve dhe veprimtarive lidhur me problemin ekologjik të vjedhjes së ujërave të lumit Radika nga Qeveria e Maqedonisë përmes ndërmarrjes publike për prodhim të energjisë elektrike "ELEM"

Nga **BARDHYL MARKU**



Foto e marrë nga faqja në Facebook "STOP Devijimit te rrjedhes te lumit Radika"

Ndryshimi i rrjedhjes natyrore të lumit të Radikës do të shkaktojë një katastrofë ekologjike për Grykën e Radikës. Ndërmarrja publike e Maqedonisë është e angazhuar për ndërtimin e hidrocentralit të Llukovës, ndërkohë që protestuesit presin edhe reagimin zyrtar të qeverisë së Shqipërisë. Qytetarët dhe pushtetarët lokalë në Dibër të Madhe janë kundër: Mos na e thani ardhmërinë!

Siç kemi bërë të ditur edhe në numrat paraprak, Dibrës po i kanoset një rrezik shumë i madh, një bombë ekologjike, e cila do shkatërrojë florën dhe faunën e lumit Radika dhe liqenit të Dibrës.

Tani më lexuesit e kanë të qartë se bëhet fjalë për projektin famëkeq të Qeverisë Maqedonase për grabitjen e ujërave të lumit Radika, tharjen e tij, me qëllim të dërgimit të potencialit të tij ujor prej, mesatarisht rreth 17 m3/s nga liqeni i Dibrës në liqenin e ri, i cili planifikohet të ndërtohet në fushën e Llukovës ("Llukovo polje") e cila ndodhet në trekëndëshi kufitar mes Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës.

Pas takimit të mbajtur më 25 tetor 2013 në Dibër të Madhe, vërehet një lëvizje shumë më e madhe, një sensibilizim shumë më i lartë, pushteti vendor, forumet sociale por edhe nga sektori qytetar. Si duket mundësitë e reja të cilat ofron teknologjia informative dhe interneti e posaçërisht rrjeti social "Facebook" është duke ndihmuar më të madhe në shpërndarjen e lajmit për rrezikun e madh, i cili realisht i kanoset Dibrës.

Shtypja e madhe që po bëhet përmes rrjeteve sociale, përfundimisht e ngriti problemin në një nivel më të lartë dhe sot mund të thuhet lirisht se në aspekt të sensibilizimit të problemit, ai më nuk është diçka e panjohur, por për të sot flet secili dibran me frikë se: vallë a thua me të vërtetë Dibrës do ja marrin Radikën? A thua se më të vërtetë liqeni i Dibrës do ngel pa arterien e tij kryesore? A thua se liqeni do na shndërrohet në një kënetë të madhe edhe më të keqe se liqeni i Gllobojçicës? A thua se dibranët do lejojnë një gjë të tillë? Po partia shqiptare, Bashkimi demokratik për Integrim (BDI) në pushtet bashkë me partnerin e saj shumë të dashur VMRO-DPMNE do ta shpërfillë votën e dibranëve dhe do të lejojë një krim të tillë? Po Republika e Shqipërisë, e cila do ketë një kaskadë të Drinit të zi me 17 m3/s më pak do heshtë dhe nuk do ta ngrejë zërin për të mbrojte interesat e saja? Dhe shumë e shumë pyetje të tjera në të cilat dibranët presin përgjigje.

Por dibranët nuk rrinë duarkryq. Për momentin ata janë duke luftuar me mënyrën dhe instrumentet të cilat i kanë tani për tani në dispozicion. Rrjete sociale janë plot e përplot me postime të përditshme të cilët ndihmojnë në sensibilizimin e problemit. Sektori qytetar më datë 23 nëntor mbajti një mbledhje në të cilin u formua një grup pune, i cili do merret me organizimin e aktiviteteve, të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e këtij projekti famëkeq me pasoja ekologjike katastrofike për rajonin e Dibrës së Madhe, në vecanti dhe gjithë Dibrës në tërësi. Në takim ishin prezent përfaqësues të të gjitha shoqatave qytetare dhe klubeve të ndryshme sportive, të cilat veprojnë në Dibër, pa marrë parasysh përkatësi etnike apo fetare. Në këtë takim u sollën disa vendime:

• U vendos që menjëherë të fillohet me grumbullimin e nënshkrimeve dhe dërgimin e një peticioni të gjithë subjekteve relevante, të cilët mund të kenë çfarëdo ndikimi në zgjidhjen e këtij problemi, duke filluar nga: Ministritë përkatëse, ajo e mbrojtjes se ambientit jetësor dhe ajo e ekonomisë; Qeveria dhe Kryeministri i Qeverisë së Maqedonisë; Partia Bashkimi Demokratik për Integrim dhe Kryetarit të saj Z. Ali Ahmenti; Bankës Botërore, zyrës në Shkup, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë; Ambasadës së Republikës së Kosovës; dhe institucioneve tjera ndërkombëtare si OSBE, zyrës së Unionit Evropian etj.

• Më 25.11.2013 të fillojë grumbullimi i nënshkrimeve nga qytetarët dibranë ne qendër të qytetit, respektivisht në "Sheshin Skënderbe"

• Iniciativa e grumbullimit të nënshkrimeve të zgjerohet edhe në komunat tjera përgjatë rrjedhës së lumit Radika, respektivisht në komunat Qendra e Zhupës dhe Rostusha e Mavrova.

• Të mbahet konferenca për shtyp me media të vendit dhe të huaja.

Bazuar në vendimet e marra në Dibër të Madhe më datë 25 nëntor 2013, filloi grumbullimi i nënshkrimeve dhe qysh në ditën e parë u siguruan mbi 1000 mijë nënshkrimeve edhe pse kushtet klimatike, bora dhe koha e ftohët, ishin kundër kësaj iniciative duke vështirësuar kushtet. Sot, kur po përgatitet ky tekst, në ditën e katërt, janë grumbulluar rreth 4500 nënshkrime vetëm në Dibër. I njëjti aktivitet vazhdon edhe në dy komunat tjera në atë të Zhupës dhe të Rostushës, por po vërehet se në këta dy komuna interesi i qytetarëve për të nënshkruar peticionin është larg entuziazmit të cilin e kanë dibranët.

Më datë 26 nëntor 2013, pushteti vendor, respektivisht Kryetari Komunës, z. Ruzhdi Lata organizoi një takim me mediat e vendit edhe të huaja, ku shprehu mbështetjen që pushteti vendor i jep kësaj iniciative të sektorit qytetar në Dibër, duke e vënë edhe ai nënshkrimin e tij në këtë peticion. Fatkeqësisht, këtë konferencë për shtyp e ndoqën 4 media nga Shqipëria (ABC News, Top Channel, Tv Klan dhe Vizion plus) disa media lokale dhe vetëm një nga mediat e vendit.

Por përsëri problemi i devijimit të lumit Radika nuk është më një çështje e heshtur dhe e fshehtë, siç ishte plani paraprak i ndërmarrjes maqedonase për prodhim të energjisë elektrike "ELEM". Në fakt kjo çështje ishte edhe njëra nga pikat për diskutim të takimit ndërministror mes Ministrit të Ekonomisë së Maqedonisë Z. Valon Saraqini dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, Z. Damian Gjiknuri. Por, fatkeqësisht nga ky takim të dy ministrat dolën me një deklaratë të hidhur për dibranët lidhur me problemin e lumit Radika. Sipas tyre Radikës për projektin "Lukovo Polje" i merren vetëm 2m3 ujë/sekondë nga 17 m^3 ujë/sekondë (sa është kapaciteti mestar i saj), deklaratë e cila bie ndesh me informatat të cilat i prezantuan përfaqësuesit e ELEM-it dhe Bankës Botërore në Dibër në takimin e 25 tetorit të këtij viti, ku mes tjerash u tha se nëse kapet vetëm njëra nga 6 degët e Radikës (ajo më e madhja) për të cilën Banka Botërore, jep pëlqim analizuar vetëm për nga aspekti i arsyetushmërisë ekonomike, ajo ka kapacitet 7.224 m3 ujë/sekondë që është shumë më tepër se deklarata e Z. Saraqini dhe Z. Gjiknuri. Dibranët shpresojnë që kjo deklaratë e dhe jo dezinformatë të korrigjohen shpejtë, aq më tepër kur dihet se ELEM-i si institucion publik është në vartësinë e ministrisë të cilën e udhëheq Z. Saraqini.

Ndërkohë, përfaqësues të këshillit iniciativ patën mundësi të marrin pjesë në një emision të drejtë për drejtë të Radio Shkupit në Gjuhën Shqipe, ku vazhdoi fushata e sensibilizimit të opinionit më të gjerë, u shpalosën detajet lidhur me problemit në fjalë, strategjia dhe planet e ardhshme nga Kryetari i Komunës Z. Ruzhdi Lata dhe përfaqësuesi i këshillit iniciues për organizimin e aktiviteteve për parandalim të ndryshimit të rrjedhës natyrore të lumit Radika, Z. Bardhyl Marku.

Në fund të përmendim se aktiviteti i radhës përfshin organizimin e një proteste gjithë popullore në qendër të qytetit të Dibrës së Madhe në Sheshin Skënderbe. Kjo protestë është paraparë për ditën e shtunë, me datë 30 nëntor 2013, me fillim në ora 14.00. Shpresojmë që ky tubim do ndihmojë edhe më shumë në përcjelljen e mesazhit tek strukturat vendimmarrëse që sa më parë të ndërpresin realizimin e këtij projekti me pasoja katastrofale në radhë të parë për Dibrën por edhe për Shqipërinë.

Në të njëjtën kohë shpresojmë që edhe Republika e Shqipërisë të angazhohet drejtpërsëdrejti në këtë proces dhe të mos luajë rolin e vëzhguesit, por të marre rolin aktiv dhe bazuar në konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e ujërave dhe rrjedhave të lumenjve, t'i thotë një JO të fortë dhe vendimtare projektit "Lukovo Polje"

Të njëjtën gjë dibranët shpresojnë të dëgjojnë nga goja e përfaqësuesve më të lartë dhe vendimmarrës të BDI në Maqedoni, të cilët mes tjerash kanë marrë edhe votat e dibranëve. Dibranët ndër shekuj kanë treguar se dinë të vlerësojnë të mirën dhe të drejtën, por dinë të vlerësojnë dhe kur nuk harrojnë edhe të keqen dhe për të asnjëherë nuk falin.

Rruga e Arbërit nr. 91

Durrësi nderon dy ndërtuesit dibranë,
Zabit Muda dhe Agim Islami me titullin "Nderi i qytetit"

reportazh

Mbresa nga një veprimtari



Zabit Muda e Agim Islami nderohen me motivacionin:
"Për kontribut të rëndësishëm që japin në zhvillimin ekonomik të qytetit të Durrësit, në mbështetjen e aktiviteteve, në promovimin e historisë dhe kulturës qytetare durrsake, për vlerat e spikatura intelektuale, qytetare dhe humane".

Nga **GAFUR ZOTO**

"Festa e ullirit - 2013" ka diçka të veçantë sot. Me këtë rast Durrësi nderon me titullin "Nderi i qytetit" zotërinjtë Shpëtim Prodani, Zabit Muda e Agim Islami. Kjo e bën atë me përmasa më të mëdha. Sipas traditës, kryetari i bashkisë, z. Vangjush Dako, mbjell një fidan ulliri. Zabiti dhe Agimi bëhen pjesë e këtij evenimenti. Kjo tashmë është një traditë e përcjellë nga gjithë kryebashkiakët.

Që këtej të ftuarit e shumtë drejtohen për te pallati i kulturës "Aleksandër Moisiu" ku edhe pritet të zhvillohet veprimtaria. Nën ritmet e muzikës, që orkestra frymore e qytetit ekzekuton, të ftuarit futen në hollin e pallatit të kulturës. Aty gjenden para një fotoekspozite kushtuar njerëzve që Durrësi sot nderon. Vizitorët për një çast ndalen te këndi kushtuar dy ndërtuesve dibranë. Ekspozita çelet me fotot e zotërinjve Zabit Muda e Agim Islami. Njerëzit jo se nuk i njohin, por kureshtja i shtyn të mësojnë më shumë rreth tyre. Shtrëngime duarsh dhe përqafime me miq e shokë, por edhe koleg, ndërtues durrsak.

Që këtej të pranishmit drejtohen për në sallën e madhe të pallatit të kulturës. Ajo është e tejmbushur. Politikanë, deputetë, autoritete vendore, përfaqësues të shoqatës "Tirana" e bashkë me ta kanë zënë vend ata që nderon sot qytetaria e Durrësit, ata që sonte shpallen "Nderi i qytetit". Në skenë ngjitet prezantuesi i programit. Ai fton kryetarin e shoqatës "Durrësi" z.Halil Myderizi. Ky, mes duartrokitjeve thekson: "Sot festa e ullirit është disi më e veçantë. Durrësi shpall "Nderi i qytetit" z. Shpëtim Prodani, Zabit Muda e Agim Islami". Motivacioni: "Për kontribut të rëndësishëm që japin në zhvillimin ekonomik të qytetit të Durrësit, në mbështetjen e aktiviteteve, në promovimin e historisë dhe kulturës qytetare durrsake, për vlerat e spikatura intelektuale, qytetare dhe humane".

Ceremonia vazhdon në formë spektakli. Me anë të një videoprojeksioni në ekran shfaqet portreti i z.Shpëtim Prodani. Ai sot nuk jeton, por qytetaria durrsake ka në mesin e saj kujtimin e Tij, emrin dhe veprën e lënë. Aspekte nga jeta e Tij. Intervista me ish koleg, shok e të afërm të Shpëtimit. Bashkëshortja, fëmijët, nipër e mbesa të ardhur nga Sh.B.A. nuk gjejnë fjalë të falënderojnë shoqatën "Durrësi", bashkinë e qytetit dhe stafin realizues.

Më pas, në ekran, shfaqen njëri pas tjetrit: z. Zabit Muda dhe z. Agim Islami, dy bashkëadministratorë të shoqërisë ndërtimore "DIBRA AG-ZA" sh.p.k. Në retrospektivë shfaqet në ekran jeta e Zabit Mudës dhe Agim Islamit. Zabiti që 15 vjeç e kish nisur punën në kantierin e hidrocentralit të Fierzës. U rrit bashkë me veprën. Mbaroi shkollën teknike të ndërtimit ku jepnin mësim inxhinier elitarë. Shquhet për pasion e përkushtrim. Drejtues të kantierit e rritën konsideratën për të. Filloi gradualisht të kryente detyra të ndryshme. Me shumë respekt kujton mbështetjen e dhënë nga ing.Faraudin Hoxha, Nexhat Turkeshi etj. Mes tyre fitoi shumë përvojë, por edhe dituri profesionale.

Me përfundimin e veprës Zabiti u kthye në Peshkopi. Pas shumë peripecish filloi punë në N.N.Peshkopi. Këtu filloi punë edhe Agim Islami. Vinte nga auditoret e universitetit, fakulteti inxhinierisë së ndërtimit, dega arkitekturë. Bashkë me të ndjerin Sakip Zebi, Ramiz Plaku, Mefat Shehun etj., u bënë një grup i mirë. Ishin vite tejet të vështira. Mungonin materialet, fondet, gjithçka. Mbledhje e kritika të pafund për mosrealizime. Si për të qeshur Zabiti dhe Agimi nuk harrojnë të kujtojnë ato mbledhje të tejzgjatura.

Punuan në degën teknike dhe zbatimin e veprave të tilla si: frigoriferi rajonal, pallati i kulturës, i sportit, Bulqizë, minierën e kromit-Tërnovë e gjetkë. Por edhe këtu paradokset nuk kanë fund. Në ceremoninë e përurimit të frigoriferit erdhi z.Leandro Zoto, ish zv.Ministër i ndërtimit. Ai që kishte zbatuar veprën nuk duhej të shfaqej para titullarëve. Në dhomën e pritjes së hotel-turizëmit u shtrua edhe një koktej. Leandro Zoto, pyeti: "Ku është zbatuesi i veprës"? Vrapuan t'a gjenin Zabitin duke theksuar se kjo ishte një pakujdesi. Në fakt kështu ishte protokolli i asaj dite.

Me ardhjen e pranverës së demokracisë, Agimi dhe Zabiti lanë Dibrën dhe u nisën drejt Durrësit. Kishin punëra të mira, por tash kishin vendosur të provonin përvoja të reja. Këtu ngritën të parin biznes privat në fushën e ndërtimit. Fillimi ishte tejet i vështirë: mungonte përvoja, fondet, lënda e parë, por jo shpresa dhe vrulli. Shpejt u mësuan me vështirësitë, ndaj dhe i kapërcyen ato me sukses. Në ato ditë të vështira patën mbështetjen e ish kryetarit të bashkisë z. Tomor Golemi. Me Dibën z.Tomor e lidhte kujtimi i të atit, Mahmut Golemi, ish prefekt. U ofroi gjithçka e mbetën miq e shokë të ngushtë. Edhe sot, pas më shumë se njëzet vitesh, do të gjejnë kohë të kalojnë disa çaste bashkë. Bashkëpunim vendosën me ing Hajdar Kovaçi.

Zabiti dhe Agimi e nisën nga hiçi. Të bindur në epërsinë e ekonomisë së tregut të lirë, shënuan suksese. Fillimisht bashkuan kapitalet me familjen "Rexha" nga Dibra e Madhe duke realizuar një investim të konsiderueshëm për fillimin e viteve 90-të. Në pak kohë bënë emër të mirë në gjithë Durrësin e më gjërë. Janë një sërë objektesh në qytetin e Durrësit si: rezidenca turistike, hotele, kompleksi arsimor "Turgut Ozal", hotele, vila luksoze, objekte kulti -vlera të shtuara në mozaikun urban të qytetit. Për ata që vijnë nga rrethe tjera, shpesh herë objektet e ndërtuar nga "Dibra ag-za" jepen nga qytetarët si pika reference për adresat.

Episode të tilla ka shumë, por më duhet të rikthehemi aty ku e nisëm, në sallën e pallatit të kulturës "Aleksandër Moisiu". Prezantuesi i programit fton në skenën e teatrit kryebashkiakun e qytetit Z.Vangjush Dako. Më pas mes duartrokitjeve ftohen të marin titujt e nderit z.Leonard, djali i Shpëtim Prodanit, z.Zabit Muda dhe Agim Islami. Z.Vangjush Dako jep titujt e nderit. Janë simbole shumë domethënës. Të larë në argjend. Janë përgatitur në Itali. Shtrëngime duarsh e urime të ndërsjella. Salla e gjitha duartroket. Dy vajza të vogla, ngjitën në skenë dhe u dhurojnë tufa të freskëta me lule. Përshëndet Leonard Prodani. Zabit Muda është i emocionuar. E ka vështirë të flas për vete. Mikrofonin ia kalon kolegut të tij, Agim Islami. Falënderime shoqatës "Durrësi", autoritetet vendore dhe qytetarisë durrsake për vlerësimin e lartë.

Mirënjohje e respekt për qytetarët e Durrësi, për frymën bashkëpunuese, për mikpritjen, tolerancën dhe partneritetin e treguar. Suksesin tonë sonte dua t'a ndaj me ju bashkëqytetarë të mi - përfundoi fjalën përshëndetëse z.Agim Islami.

Spektakli vazhdon. Ngjiten e ulen në skenë: Kastriot Tusha, Eranda Libohova, Manjolla Nallbani, Valbona Halili, humoristët Gëzim Kruja, Rajmonda Marku, parodistët e Vlorës... Humoristi Muharrem Hoxha dhe pse ka një shekull që të parët e tij kanë ardhur nga Reka e Dibrës në Durrës, ndjehet dibran. Gjithçka për bukuri dhe kjo në sajë të regjisë së Gjergj Vlashit, drejtorit artistik Minella Kureto, drejtuesit të spektaklit Bujar Qesja dhe filmimit të z.Astrit Tahiri. Që këtej spektakli vazhdoi me darkën gala në bar restorant "LIAL".

...Dhe, pas kësaj: telefonata, mesazhe urimi të pa fund. Vijnë ato nga Shqipëria, por edhe nga Italia, Greqia... Urojnë ata që kanë blerë apartamente e vila. Dikush si me shaka është edhe kritik. Dëshironim të vinim në aktivitet, por nuk kishim ftesa. Ka edhe nga ata që marrin rrugën e vijnë t'i urojnë. Shumë prej tyre kanë ndërtuar vila, rezidenca pushimi, apartamente me projekte të ofruara nga "DIBRA AG-ZA". Dhjetra të tillë të projektuar nga Agim Islami i gjen të ndërtuara në qytetin e Durrësit, Kënetë, Arapaj, Rash-Bull, Peshkopi e gjetkë. Ata janë mirënjohës edhe për faktin se bashkë me projektet kanë marrë nga Agimi e Zabiti edhe konsulencë teknike e juridike. Madje Zabit Muda nuk përtoi kurrë të shkonte aty ku dhe do ndërtohej duke ndihmuar që bashkëqytetar të tij të mos investonin pa dokumentacionin përkatës. Dhe për këtë vepër humane kanë marrë si shpërblim vetëm mirënjohje e falënderim. Urime e mesazhe vijnë nga shoqata, artiste, njerëz të sportit e të artit në Dibër e Durrës. Duan t'u shprehin urimet dhe mirënjohje, ndonse Agim Islami e Zabit Muda kanë kontribuar me zemër duke kërkuar gjithmonë të mbeten anonim për atë që kanë dhënë.

Mesazhe e telefonata vijnë nga qytetar durrsak që kanë patur rastin të punojnë pranë shoqërisë "Dibra ag-za", por që për arsye të ndryshme nuk ishin në ceremoninë e organizuar. Në të vërtetë shoqëria ndërtimore "Dibra ag-za" nëpërmjet biznesit të ndërtimit u bë edhe si urë lidhëse mes të ardhurve, kryesisht komuniteti dibranë dhe banorëve të vjetër të Durrësit. Zabiti dhe Agimi kanë punuar në partneritet me qytetarët duke vendosur mes tyre marrëdhënie të ndërsjella. Edhe unë bashkoj urimin me të tjerët. Urim Zabit Muda dhe Agim Islami! Urime edhe për shoqatën "Durrësi"!

Tash, i emocionuar nga gjithçka ndoqëm, nuk mund të mos kujtoi ditën kur një përfaqësi e kryesisë së shoqatës "Durrësi" ngjiste shkallët për te zyrat e shoqërisë ndërtimore "DIBRA AG-ZA". Janë njerëz elitarë të qytetit të Durrësi. Vijnë nga fusha të ndryshme. Kanë një përvojë të admirueshme në jetën e qytetit. Në hollin e zyrave takojnë Zabit Mudën dhe Agim Islamin. Fjalën e merr z.Shpëtim Metani, sekretar i shoqatës. Vijmë t'u përcjellim një mendim të kryesisë së Shoqatës "Durrësi". Lidhur me punën tuaj kemi patur shumë apele e konsiderata nga bashkëqytetar të Durrësit. Me atë ç'ka i keni ofruar qytetit, njerëzve, planit urban, meritoni gjithë konsideratat. Kryesia ka mendimin t'u shpall "Nderi i qytetit" - përfundoi z.Shpëtim. Për Zabitin dhe Agimin kjo ishte diçka e papritur, ndaj fillimisht e morën vetëm si një bisedë. I ftuan për një kafe. Më pas unë u bëra pjesë e grupit organizues. Në bashkëpunim e sipër pata rastin të ndjek nga afër se me çfarë përkushtimi e pasion punonin (një përvojë kjo me vlerë edhe për rrethet e tjera). Ndaj duke ndarë me ta suksesin, uroi dhe ofroi bashkëpunim për tjera veprimtari në të ardhmen.

Durrës, 28 tetor 2013

arsim

Përmirësimi i cilësisë së shkollës bëhet përmes drejtorëve, nëndrejtorëve e mësuesve të zgjedhur me konkurs, përmes parimit të gjithëpërfshirjes dhe ngritjes profesionale të tyre.

Sfidat e drejtorit të ri të DAR-it, Dibër

Nga **MENTOR HOXHA**

Rotacioni politik që ndodhi në Shqipëri më 23 qershor, solli edhe një risi të re në skenën publike shqiptare. Solli emërimin e Drejtorëve të Drejtorive Arsimore Rajonale (DAR) me konkurs, gjë që nuk kishte ndodhur ndonjëherë gjatë 23 viteve të tranzicionit shqiptar. Këto poste kanë qenë poste politike dhe zgjidheshin nga partia sipas kontributit partiak. Kjo politikbërje në arsimin rajonal, zhduku meritokracinë dhe solli në krye të Drejtorive Rajonale Arsimore mjaft militantë, të cilët e kthyen arsimin në çerdhe ku punësoheshin militantët dhe sulmoheshin kundërshtarët politikë. Mjaft prej këtyre drejtorëve rajonalë apo zonalë nuk kanë patur as arsimin përkatës, madje ka patur në krye të arsimit edhe agronom, apo veteriner.

E ndërgjegjshme për këtë katastrofë në arsimin shqiptar, ministrja e Arsimit dhe e Sporteve, znj., Lindita Nikolla, sapo mori detyrën, ushtroi kontrolle në të gjitha Drejtoritë Arsimore Rajonale. Pasi zbuloi abuzimet e këtyre drejtorive, vendosi të largojë nga puna drejtuesit e arsimit në të gjithë qarqet e Shqipërisë. Më pas, përmes një njoftimi zyrtar në media në tetor 2013 hapi konkursin për 13 vendet vakante në të 13 qarqet e vendit, duke ftuar të gjithë personat, që mendonin se i plotësojnë kriteret.

Ndër kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për drejtor arsimi janë: diploma master në mësuesi, eksperienca 5 vjeçare profesionale e menaxhuese, gjuha e huaj, aftësi për programe kompjuterike,të jetë i padënuar nga gjykata, etj. Konkursi u zhvillua në tre faza dhe u menaxhua dhe u drejtua nga një grup me mjaft përvojë nga Ministria e Arsimit. Faza e parë, kishte të bënte me plotësimin e kushteve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Në këtë fazë konkurruan 229 persona, por vetëm 202 plotësonin kriteret për të kaluar në fazën e dytë. Faza e dytë, ajo e provimit me shkrim u zhvillua më 11 nëntor në orën 10.00-12.00 në fakultetin Ekonomik në Tiranë, ndërsa intervista me gojë u zhvillua më datë 12 deri më 15 nëntor pranë Ministrisë së Arsimit. Pas provimit me shkrim dhe intervistës me gojë, Komiteti ad hoc, bazuar në rezultatin më të mirë për pozicionin e drejtor/e në drejtoritë arsimore rajonale, i propozoi ministres së Arsmit dhe Sportit, znj. Lindita Nikolla, që në fazën finale, të kalojnë kandidaturat sipas listës. Me datë 21 nëntor 2013, Ministria e Arsimit dhe e Sporteve publikoi në faqen e saj zyrtare, listën e fituesve të fazës së fundit të konkurrimit për postin e drejtuesit të Drejtorisë Arsimore për 13 qarqet e Shqipërisë. Lista u publikua nga të gjitha mediat elektronike e të shkruara shqiptare. Për Tiranën e Vlorën dolën më shumë se pesë kandidatë, pasi sipas njoftimit të MASH-it, kandidatët që kanë pasur pikë të barabarta, janë përfshirë të gjithë listën e të kualifikuarve duke tejkaluar kështu numrin pesë në nivel qarku. Nga të gjithë qarqet u kualifikuan për në finalen publike gjithsej 69 persona. Nga Dibra u kualifikuan Drini Gjeci, Kujtim Kërkuti, Llesh Doçi, Mentor Hoxha dhe Valentina Haliti. Gjatë këtyre ditëve u zhvilluan përballjet e fundit publike, duke përcaktuar fituesit e DAR, Shkodër, Lezhë, Durrës, etj.

Të gjithë konkurrentët shpalosin idetë, propozimet dhe projektet e tyre se si do të përmirësojmë politikat arsimore në qarkun ku konkurrojnë. Shpalosën vizionin dhe objektivat e tyre për:

I. Përmirësimin e cilësisë së punës, efektivitetit dhe efiçencës së DAR-it;

II. Përmirësimin e cilësisë së arritjeve të shkollave;

III. Rritja e kompetencave profesionale të drejtuesve dhe mësuesit:

IV. Shkolla si mjedis miqësor për nxënësit, prindërit komunitetin.

Drejtoria Arsimore Rajonale në Dibër përfshin arsimin në tre rrethe: Dibër, Mat dhe Bulqizë. Ka dy zyra Arsimore (ZA), një Bulqizë dhe një në Mat. Administrata e DAR Dibër përbëhet nga 20 punonjës, të ndarë në katër sektorë: Sektori i Programeve të Zhvillimit, Sektori i Kurrikulës dhe Cilësisë, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës dhe Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme. Në varësi të kësaj administrate janë 48 institucione arsimore të arsimit parauniversitar në Rrethin e Dibrës, në të cilat shërbejnë 1040 punonjës. Gjatë vitit mësimor- edukativ 2012-2013 ndjekin mësimin 15455 nxënës (16101 nxënës kanë qenë regjistruar në vitin shkollor 2010-2012), pra 6546 nxënës më pak. Pikat e dobëta të arsimit rajonal në Dibër, janë politizimi i DAR-it, mungesa e madhe e stafit mësimdhënës, mbingarkesë kuadri, mësues me kontratë të përkohshme të emëruar para zgjedhjeve parlamentare të 23-qershorit, klasa me numër të paktë nxënësish, mësues nën normë dhe largësia e madhe e shkollave të mesme dhe 9-vjeçare nga qendrat e banuara, ku nxënësve u duhet të bëjnë disa orë në këmbë, si dhe plot probleme të tjera që duhen zgjidhur përmes një reforme radikale dhe të menjëhershme nga drejtori i ri. Rasti më tipik ishte në emisionin "Alarm" më 27 nëntor te TV "Ora News", ku nxënësit e Çidhnës në komunën e Arrasit të Dibrës, bënin çdo ditë katër orë në këmbë një rrugë të ngushtë mali dhe të rrezikshme nga egërsirat, vetëm e vetëm për të vazhduar Shkollën e Mesme të Bashkuar në Arras, ndërkohë që nxënës të tjerë të këtij fshati kishin marrë shtëpi me qira në qytetin e Peshkopisë për të ndjekur studimet në shkollën e mesme dhe për t'i shpëtuar rrugës së mundimshme që bënin bashkëfshatarët e tyre në zheg dhe acar, në shi e dëborë.

Cilësia e punës, efektivitetit dhe eficencës së DAR-it, Dibër duhet të mbështetet në parimin e profesionalizmit, përgjegjshmërisë, bashkëpunimit, barazisë dhe etikës së komunikimit. Në ushtrimin me efektivitet dhe përgjegjësi të detyrave, zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në veprimtarinë mësimore-edukative, menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore sipas parimit të meritës, rritjes së bashkëpunimit me komunitetin, qeverisjen vendore dhe organizma partner të interesuar, që operojnë në fushën e arsimit, etj.

Riformatimi i kuadrit të DAR dhe të institucioneve arsimore në varësi të saj të bëhet me transparencë dhe sipas ligjeve, urdhërave e udhëzimeve të MASH, pa shkelur Kodin e Etikës dhe Statusin e Nëpunësit Civil. Nuk duhet të ketë më emërime e shkarkime drejtorësh, nëndrejtorësh apo mësuesish me urdhëra partiakë apo thjesht se i teket drejtorit të DAR. Stop emërimeve politike, nepotike dhe pa arsim përkatës. Gjithçka të bëhet me konkurs të hapur.

Zbatimi i Reformës Territoriale që do të vihet në zbatim vitin e ardhshëm kërkon edhe një studim të detajuar të arsimit rajonal, pasi mjaft shkolla nuk plotësojnë numrin e duhur të nxënësve. Ka klasa me pak nxënës, mbingarkesë kuadri dhe mësues nën normë. Është mirë që klasat me numër të paktë nxënësish të mbyllen dhe këta nxënës të grumbullohen në ndonjë shkollë tjetër, duke i'u siguruar transport falas dhe kushte më të mira. Kështu rregullohen edhe ata, por largohen edhe mësuesit parazitë.

Përmirësimi i cilësisë së arritjeve të shkollave, bëhet përmes drejtorëve, nëndrejtorëve e mësuesve të zgjedhur me konkurs, përmes parimit të gjithëpërfshirjes dhe ngritjes profesionale të tyre. Duhen bërë kontrolle e konkurse të shpeshta, dhe duhen shpërblyer punonjësit e nxënësit e dalluar.

Bashkëpunimi i ngushtë mësues-nxënës, komunitet është një tjetër tregues që ndikon në përmirësimin e cilësisë së punës. Shkolla duhet të shërbejë si mjedis shoqëror për nxënësit, prindërit d komunitetin. Nxënësit, mësuesit, drejtuesit e prindërit duhet të kontribuojnë në vendimmarrjen e shkollës.

ÇFARË FITUAM NGA KY KONKURS I MASH

Së pari, fituam një medium të ri, ku ç'dokush që u ndje i aftë për të marrë përsipër përgjegjësi dhe për të shpalosur vizionin e tij mbi arsimin rajonal pati mundësinë ta bënte. Së dyti, ishte një eksperiencë që na kishte munguar prej kohësh, ndonëse kishim vite që e kërkonim një ballafaqim të tillë publik nga qeveritë e mëparshme. Të marrësh pjesë këto konkurse të mëdha publike ku varet, jo vetëm e ardhmja jote, por e ardhmja e arsimit në një qark me mijëra banorë, është një sfidë e përgjegjësi e madhe ndaj vetes, ndaj kombit e ndaj qytetarëve. Megjithatë, të marrësh pjesë në këto konkurse të mëdha kombëtare nuk është edhe aq lehtë. Duhet një guxim i rrallë dhe një përgatitje e madhe profesionale e emocionale. Mund të arrish deri në finale, por mund të eliminohesh që në fazën e parë. Ndërkohë,të arrish në finalen publike me pikë të barabarta me konkurrentët, është një emocion dhe arritje mjaft e madhe. Në finale nuk ke më se ç'të humbasësh, ndaj shpresa se nga çasti në çast se edhe ti mund të jesh fituesi të jep emocione të mëdha, por dhe humbja e ndershme në një garë të ndershme nuk duhet paragjykuar. Si përfundim, nga ky konkurs fituam shumë gjëra, ndërkohë që nuk humbëm asgjë.

Shënim i redaksisë:

Autori i këtij shkrimi ishte njëri nga kandidatët për drejtor të Drejtorisë Arsimore të Qarkut Dibër. Botimi i shkrimit në gazetë, nuk ka për qëllim që të bëjmë një mbrojtje publike për autorin, këtë më mirë se gjithkush e ka bërë ai vetë, aq më tepër, që kur ky shkrim të jetë botuar, drejtori i DAR Dibër është zgjedhur. Botimi i shkrimi bëhet me qëllimin për të përcjellë për lexuesin disa shqetësime dhe problematika që lidhen me arsimin në rrethin e Dibrës, të cilat mbeten për zgjidhje nga drejtuesi i ardhshëm i DAR-Dibër.

- Cilësia e punës, efektivitetit dhe eficencës së DAR-it, Dibër duhet të mbështetet në parimin e profesionalizmit, përgjegjshmërisë, bashkëpunimit, barazisë dhe etikës së komunikimit.

Revista letrare "Keleno" boton një cikël poetik të poetit, gazetarit e studiuesit dibran


Κελαιρώ

Χρόνος 12ος • Τεύχη 45-46ον • Απρίλιος - Σεπτέμβριος 2013

ΤΡΙΜΗΝΙΑΙΟ ΠΕΡΙΟΔΙΚΟ • Λόγος - Τέχνη - Πολιτισμός

ΤΟ ΠΡΩΤΟ ΣΚΑΙ

Η απάντηση του αγαμού

Mentor Hoxha botohet në greqisht

Nga ***Spiro XHAVARRA***
Athinë

Revista e njohur e letrave greke "Qeleno" në numrin e saj të fundit i kushtoi një faqe edhe poetit e gazetarit të njohur nga Dibra, z. Mentor Hoxha.

Janë pesë poezi të përkthyera dhe të botuara në greqisht nga kjo revistë e njohur letrare në Greqi. Poezitë janë marrë nga libri "Lirika nga Europa" që Mentor Hoxha ka shkruar gjatë emigrimit katër vjeçar në Angli, Belgjikë, Francë, Greqi, etj.

Ky libër ka dalë në qarkullim para katër vjetësh dhe është pritur mjaft mirë nga lexuesi e kritika.

Revista "Keleno" botohet nga Lidhja e Poetëve dhe Shkrimtarëve XASTERON-Zalloni me qendër në Athinë, me presidente znj. Panajota Hristopulo-Zalloni, e cilësuar si margaritari i lirikës moderne greke. Poezitë e saj janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Është poete, prozatore, përkthyese dhe aktiviste. Docente Nderi e Filozofisë në Universitetin e NEY-YORKUT dhe autore e mbi 20 librave.

Një tjetër cikël me poezi nga Mentor Hoxha, shkëputur po nga libri "Lirika nga Europa", është përkthyer e botuar në greqisht edhe nga revista e njohur greke "Eolika Grammata", e cila pritet të dalë këto ditë nga shtypi. Botues e drejtori i saj është Kostas Valetas, zv.president i Bashkimit të Shkrimtarëve Europianë, zv.president i "Lidhjes Ndërkombëtare të Kritikëve të Letërsisë" e zv.kryetar i Firmës së Shkrimtarëve Grekë.

Edhe revista letrare "Keleno" edhe "Eolika Grammata" botojnë në faqet e tyre poezi dhe prozë të përzgjedhur nga autorët më të mirë nga Greqia dhe nga bota.

Elliott Moglica, një mbështetës i flaktë i Justin Trudeau, kryetar i Partisë Liberale Kanadeze, kandidat për kryeministër i Kanadasë gjatë zgjedhjeve të ardhshme federale të vitit 2015

Poeti shqiptar Elliott Moglica, veprimtar i angazhuar i liberalëve kanadezë

Media kanadeze, vitet e fundit ka shkruar se poeti shqiptaro-kanadez Elliott Moglica i cili është kthyer në një aktivist të flaktë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut me penën dhe veprimtarinë e tij.

Moglica është shquar si një poet më zemër të madhe, romancier me tema jetike e kritike, biografist profesional dhe tashmë edhe si aktivist politik i balancuar në politikën Kanadeze.

Poeti është përfshirë në "levizjen për ndryshim" duke u kthyer në një prej mbështetëve më të flaktë të Justin Trudeau-t gjatë fushatës politike (2012-2013) për zgjedhjen e Kryetarit e Partisë Liberale Kanadeze, fushatë e cila përfundoi me një fitore të thellë të Z. Trudeau me 14 prill 2013 në Kanada.

Susan Delacourt, një gazetare e talentuar e gazetës "Toronto Star" për Byronë e Otavës (Ottaëa Bureu) në shkrimin "Kandidati" më 6 prill 2013 shkruan gjerësisht (f. 38, 39-40) se si poeti shqiptaro-kanadez Elliott Moglica ka mbështetur Parlamentarin Justin Trudeau në mendim dhe veprim. Aty vihet në pah përkushtimi i poetit Moglica për zgjedhjen e Z. Trudeau si Kryetar i Partise Liberale Kanadze.

Ndërsa Althia Raj gazetarja e "The Huffington Post" (shefe për "Ottaëa bureau") në librin elektronik "Contender: The Justin Trudeau Story" (publikuar në mëmyrë elektronike me 9 mars 2013, shkruan ne kapitullin e 9-te se Elliott Moglica deri ne mes te shkurtit 2013 i kishte sjelle Z. Trudeu "mbi 1000 mbeshtetes" dhe se si ai ne menyre poetike e pershkruar Justinin si një "dhurate për krishtlindje" për popullin Kanadez.

Duke e pyetur rreth mbështetjes së dhënë në zgjedhjen e Kryetarin e Partisë Liberale Kanadeze, Moglica shprehet se Parlamentari Justin Trudeau është politikani më i balancuar e me virtute të larta, integritet , respekt e profesionaizëm. Ishte në nderin tim qe e mbështeta hapur në mendim dhe veprim, duke u bërë pjesë e historisë për ndryshim dhe prosperitet



Toronto, Kanada, 30 maj 2013: Kryetari i Partisë Liberale Kanadeze Justin Trudeau dhe poeti Elliott Moglica "kokë-më-kokë kafe falenderimi me poetin" - mbi nënshkrimin e numurit më të lartë të mbeshtetesve për Justin-in tek "Qendra Kombëtare Telefonike e Fushatës së Justin Trudeau-t" në Toronto.

të politikës kanadeze. Konkretisht, për rreth 6 muajsh isha ne fushatë intensive në Qendrën Telefonike Kombëtare të Justin Trudeau-t në Toronto. Kam ndjerë një prej fushatave më pozitive në jetën time dhe jam krenar me atë që arritëm si grup progresiv i fokusur për ndryshim dhe zhvillim progresiv politik. Personalisht duke e njohur nga afër dhe duke e ditur se Zoti Trudeau mbart virtutet më të larta që edhe politikanët global duhet të marrin, nuk mund të rrija duarkryq por u bëra pjesë e 'lëvizjes për ndryshim' progresiv. Përveç mbështetjes në mediat sociale qe kam berë vullnetarisht prej vitesh, gjatë fushatës zgjedhore kam berë mbi 10 mijë telefonata për Z. Justin Trudeau duke i garantuar mbi 1541 mbështetës nëpërmjet telefonatave si dhe mbi 400 mbështetës nëpër shtëpi, rruge, lokale, autobuz, tren, etj. Si resultat i një përkushti dhe fokusimi të përkryer, grupi ynë arriti fitoren mbi 80%: duke sjellë shpresë për fitoret e ardhshme të Partisë Liberale Kanadeze.

Po ashtu media sociale ka shkruar se poeti Elliott Moglica ka firmosur numurin me të lartë të mbështetësve për parlamentarin Federal Justin Trudeau në Qëndren Telefonike të Justin Trudeau-t n në Toronto. Për këtë Kryetari i Partisë Liberale Kanadeze JustinTrudeau – i ka dedikuar një takim të vecante falenderimi "kokë-më-kokë kafe me Justinin" me 30 maj 2013 - mbi nënshkrimin e numurit më të lartë të mbeshtetesve për Justin-in tek "Qendra Kombëtare Telefonike e Fushatës së Justin Trudeau-t" në Toronto.

Zoti Trudeau i fitoi zgjedhjet me datë 14 prill 2013 me rreth 80%. Tashmë, nese Partia Liberale Kanadeze fiton zgjedhjet federale në fund të vitit 2015, z. Justin Trudeau automatikisht bëhet Kryeministri i Kanadase, shtetit më demokratik në botë.

Justin Trudeau është i biri i ish kryeministrit kanadez dhe reformatorit të madh të Kanadasë Pier Tredeau.

Përgatiti: **Sakip Cami**

Kristaq Traja sjell Shekspirin e munguar



I kemi lexuar tragjeditë e Shekspirit, i kemi studiuar edhe në shkollë, i kemi dhe në bibliotekat tona. Këto na i solli në shqip Fan Noli, ku të përkthyera me një gjuhë të pastër ato u bënë shpejt pronë e mijëra de mijëra lexuesve shqiptar. Shumica prej tyre u vunë dhe në skena teatrore.

Kaq dinim për dramat e tij, nuk dinim se dramaturgu i madh anglez na kishte lënë dhe mjaft drama të tjera. Të gjitha këto ishin në gjuhën angleze dhe lexuesi shqiptar nuk kishte shumë njohuri për to, përjashto ndonjë student apo anglisht folës që kishte punuar dhe jetuar gjatë në Angli.

U desh ky muaj nëntori ku në mjaft rafte të librarive të kryeqytetit të shikonim një botim krejt të ri, një botim të veçantë, tre drama të panjohura për ne nga Shekspiri. Dhe këtë radhë dramaturgun anglez e bëri të flas shqip një përkthyes ndoshta i panjohur në fushën e përkthimeve por një emër mjaft i njohur në fushën e jurisprudencës.

Dibrani Kristaq Traja këtë radhë na solli Shekspirin më pranë nesh dhe me drama të tjera. Kristaqi ka lindur në Peshkopi në vitin 1955. Emri i tij u bë i njohur kur 1998-2008 ishte gjykatës në Strasburg tek Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Por jo vetëm kaq. Para se të shkonte në Strasburg Kristaq Traja kishte punuar në organet e drejtësisë shqiptare si prokuror apo dhe deri zv. ministër i drejtësisë në vitet 1992-1993.

Ka botuar "Drejtësia kushtetuese", "Demokracia në Amerikë", "Fetë dhe civilizimet në mijëvjeçarin e ri-Rasti i Shqipërisë", "Mbi natyrën e procesit gjyqësor", "Të drejtat e njeriut, Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut" si dhe përkthimin "Letrat e Federalistit". Kristaq Traja është njohës mjaft i mirë i gjuhëve anglisht, frëngjisht, italisht dhe rusisht. Dhe sot shkruan, lexon e përkthen mjaft mirë në të katërta këto gjuhë. Shekspiri si idhulli i tij dhe duke e njohur në detaj veprën e madhe të këtij dramaturgu ven-

dosi ti përkthejë të gjitha drama që ende nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe. "Unë nuk pretendoi se do të bëj gjithçka apo më mirë se Noli por pretendoi se së shpejti Shekspiri tashmë këtej e tutje do të flas edhe shqip me të gjitha dramat që ka lënë dhe lexuesi shqiptar nuk i njeh ende. Kristaqi tashmë për të na sjellë në shqip të gjithë veprën shekspiriane ka bërë një kontratë me shtëpinë botuese "Saras" ku vëllimi i parë sapo ka parë dritën e botimit.

Në këtë vëllim janë përkthyer tre drama: "Timoni nga Athina","Simbelini" dhe "Masë për masë".Të tria këto drama lexuesi shqiptar nuk i ka lexuar më parë e sot falë përkthimit që u ka bërë Kristaq Traja dhe botimit të shtëpisë botuese "Saras" me një format të vogël xhepi, dramat e reja shekspiriane lexohen fare mirë e rrjedhshëm shqip. Jo vetëm për lexuesin por përkthimi i ri i Kristaq Trajës ka ngjallur mjaft interes edhe në mjaft trupa teatrore që kanë shprehur dëshirën të bashkëpunojnë me të për ti vënë në skenë dramat shekspiriane.

Për përkthyesin Kristaq Traja ky është një fillim i mbarë. Tashmë që u fut në fushën e përkthimeve dhe me dramaturgun gjenial anglez, duke qenë dhe një njohës i mirë i gjuhëve frëngjisht, italisht, anglisht e rusisht, lexuesi shqiptar pret dhe më shumë, pret që mjaft shkrimtar, dramaturg e komedian janë ende të pa përkthyer, të pa njohur për ne. Shpresojmë nga Kristaq Traja të tjera përkthime me vlerë.



rreth e rrotull-a

Ç'kemi asaj Dibre!

(Vijon nga faqja 1)

Ata do dalin një ditë tjetër të protestojnë, tani që mësuan se çfarë humbëm, me parullën: "Duam helmet kimike!..." Studentët e universitetit s'patën mundësi të dilnin në grevë: u mbyllën dyert e auditorëve nga jashtë dhe të shkretët vuajtën duke ndjekur leksionet...

Një aksion i madh u bë për pastrimin e plehrave. Aq shumë plehra u pastruan... gjithë natën në Facebook, sa të nesërmen nuk gjeje plehra as për një fotografi...

Një stacion televiziv, e ke parë me siguri, që disa fëmijë nga Çidhna ecnin 4 orë në ditë për të shkuar në shkollë.

Ata ishin mirë me shëndet si kokrra e mollës. Gazetari që i shoqëroi një ditë të vetme, u ftoh... Por këtë çështje do ta zgjidhim shpejt, se drejtorin e arsimit të Dibrës e zgjodhëm me konkurs...

Bulevardit u përhap shpejt lajmi për arrestimin e një drejtori. Njëri thoshte për drejtorin e makinave, tjetri për të pyjeve, një tjetër për të rrugëve... Sa u mor vesh se ishte për drejtorin e tatimeve, ai u lirua...

Në Dibër u hap një ekspozitë e një piktori të njohur. Në ceremoninë e hapjes nuk kishte qytetarë... Sepse nuk kishte ardhur lideri...

Në Peshkopi u mbajt edhe këtë vit "Oda Dibrane". Shteti nuk pati para ta financonte. Megjithatë, leka-leka u bënë ca para, për të mos humbur traditën. Erdhën grupe nga gjithë hapësirat shqiptare, morën nga një çmim dhe ikën... Problemet e organizimit mbetën aty!

Në fund të muajit një protestë e madhe u mbajt në Dibër. Kërkojnë që kuçedra të mos ua marr ujin e Radikës... A thua është qytetëruar kuçedra sa ta kuptojë protestën e qytetarëve në sheshin "Skënderbej"? Apo duhet të ringjallet statuja në mes të sheshit!?

Ah, se desh harrova. Vendimi për Radikën duket se është marrë! Nuk do ketë më ujë! Dhe ku nuk ka ujë, sigurisht s'ka as jetë!

nostalgji

67 vite më vonë takohen
nxënësit e shkollës Unike të Peshkopisë

Takim i brezit të vuajtjeve, sakrificave dhe ëndrrave



Janë nxënësit e shkollës unike të Peshkopisë të vitit 1946. Një vit më parë, më 1945-sën ishte hapur shkolla unike. Ndërsa këtë vit, shkolla u bë më konvikt dhe mblodhi nxënës nga gjithë Dibra dhe Mati. Në këtë takim pas 67 vitesh janë të paktë. Nga 35 nxënës të klasës, në takimin e nëntorit kanë ardhur vetëm 8: Nuri Abdiu, Riza Lika, Fiqrete Shehu, Nusrete Shehu, Ismet Bellova, Shemsi Manjani,Rexhep Klosi dhe Mendu Dema.

Para 67 vitesh janë takuar për herë të parë. Atëherë ishin fëmijë. Tani mosha dhe hallet i kanë lodhur pak, por një dritë mirësie i ndez nga brenda. Takohen në një kafe në fillim të Rrugës së Durrësit, dhe pastaj ulen në një lokal, larg zhurmës dhe rrëmujës. Ndërsa pyesin për familjet dhe fëmijët e njëri-tjetrit, porosisin kafe dhe ujë. Pastaj kujtohen për ekspresin e fortë dhe ndërrojnë mendje: "Më mira na i bëj makiato more djalë!"

Janë nxënësit e shkollës unike të Peshkopisë të vitit 1946. Një vit më parë, më 1945-sën ishte hapur shkolla unike. Ndërsa këtë vit, shkolla u bë më konvikt dhe mblodhi nxënës nga gjithë Dibra dhe Mati. Në këtë takim pas 67 vitesh janë të paktë. Nga 35 nxënës të klasës, në takimin e nëntorit kanë ardhur vetëm 8: Nuri Abdiu, Riza Lika, Fiqrete Shehu, Nusrete Shehu, Ismet Bellova, Shemsi Manjani,Rexhep Klosi dhe Mendu Dema.

Nuriu ka marrë nga shtëpia pak raki. Asnjëri nuk e pi. Rizai e ka lënë që kur është dehur njëherë kur ishte me studime në Rusi.

Në fillim pyesin për shëndetin e njëri-tjetrit, për fëmijët, të shumtët i kanë jashtë. Malli për ta dhe brengat e prindërve për fëmijët, megjithëse nuk shprehet, ndjehet. Por shprehin edhe gëzimin që ëndrrat e tyre janë realizuar, deri diku. Fëmijët e tyre janë të suksesshëm në fushat ku punojnë dhe jetojnë, dhe për këtë, megjithëse i kanë larg, gëzohen!

E veçanta e këtij takimi është Fiqreti. Ajo ka qenë vetëm një vit në klasën e tyre, pastaj iku për të vazhduar jetën diku në Durrës.

Nuriu ka marrë me vetë disa fotografi, mes të cilave, një foto e klasës së tyre në vitin 1949. "Po bëj apelin, thotë Nuriu dhe lexon emrat në fotografi (foto më lart): Poshtë (nga e majta në të djathtë), ulur tre vajzat e klasës; Hava Shehu, Vera Nura (Muça) dhe Nusrete Shehu (Haxhiymeri). Në rreshtin e dytë: Rremzi Dema, Nazmi Tafaj, Shemsi Manjani,Shefqet Uka, Menduh Dema, Ibrahim Dervishi, Bashkim Kukeli. Në rreshtin e tretë: Ahmet Alliu, Ismet Bellova, drejtori i shkollës Mehmet Çadri, mësuesi kujdestar Islam Vani, Selami Muglica, Mehdi Kaba, Hasan Dervishi dhe Ramazan Muça. Ndërsa në rreshtin e katërt Zenel Kazhani, Riza Lika, Riza Manjani, Mehmet Ceni, Izet Bajrami, Nuri Abdiu, Rexhe Klosi, Esat Caka dhe Mithat Shehu.

Në këtë foto mungojnë Fiqrete Shehu, Bardhyl Cami, Ali Koçeku, Ismet Neziri, Xhavit Spata, Haki Ndreu, Lutfi Mehmeti dhe Riza Fejza.

Pas bërjes së apelit, një minutë heshtje është homazhi dhe respekti për shokët e tyre që nuk jetojnë më...

Ndërsa lexohen emrat, si në apel dikur, secili kujton një detaj nga shokët e klasës, dikush nuk kujton ndonjë emër, për ndonjërin nuk kanë dëgjuar për vite me radhë. Kujtojnë Bardhyl Camin nga Dibra e Madhe, i cili me mbylljen e kufirit më 1948 iku te familja e tij dhe nuk u panë më. Nuri Abdiu thotë se Bardhyli ishte nxënësi më i mirë i klasës. I vazhdoi studimet në ish-Jugosllavi dhe u bë drejtor i gjimnazit në Dibër të Madhe. Pastaj kujtojnë Xhavit Spatën, Ali Koçekun, Hava Shehun, të cilët pasi mbaruan semimaturën, klasën e tretë, filluan punë si mësues dhe krijuan profilin e tyre të suksesshëm në arsim, duke edukuar dhjetëra breza. Fiqretia kujton lënien e shkollës dhe vazhdimin e një jete të re, po ashtu si Lutfi Mehmeti dhe Riza Fejza. Ndërsa Haki Ndreu iku në Amerikë.

Në këtë takim nuk mbetën pa u kujtuar edhe mësuesit. Drejtorin e parë të unikes Edip Tërshana, drejtorin e tyre Mehmet Çadri. Po ashtu edhe mësuesin Hysni Merkaj që jepte lëndët e gjuhës shqipe, historisë dhe gjeografisë; Martin Jakovën, mësuesin shkodran të vizatimit; Luigj Bojanin, gjithashtu nga Shkodra, mësuesin e fiskulturës; Islam Vanin dhe Muharrem Toncin, mësuesit e historisë dhe gjeografisë; Hasan Rrapin dhe Mustafa Shahinajn, mësuesit e gjuhës shqipe. Nuk lënë pa kujtuar edhe mësuesit që kanë patur në klasën e II-të, Kadri Kajni (matematikë), Ded Gajtanin (shkencat biologjike), Fadil Hafizin, (histori), Reshit Kasharin (matematikë) apo edhe drejtorin e parë të pedagogjikes Rexhep Kadzadej nga Elbasani që u mësonte Kimi. Sigurisht, nuk lënë pa kujtuar edhe drejtorin e konviktit, korçarin Nuri Përrenjasi.

Kujtimet kanë brenda nostalgji, dhimbje, mall, naivitet fëmijëror. "Ishim fëmijë, kujton Shemsi Manjani. Ne iknim nga shkolla bashkë më një shokun tim, dhe të nesërmen babai na kthente sërish në shkollë, vendosur në kosha të kalit..." "Mbi 75 përqind e fëmijëve vinin nga fshati, nga gjithë Dibra dhe Mati. Konvikti ishte i vështirë. Ushqimi ishte me racion. Familjarët na sillnin ndonjëherë ushqime nga shtëpia. I ndanim mes shokëve..."

Kjo klasë ka nxjerrë personalitete të njohura. Shumë prej tyre studiuan jashtë. Në Moskë vazhduan studimet Riza Lika për Ekonomi, Nuri Abdiu për Psikologji - Pedagogji, Izet Bajrami për Histori. I ndjeri Riza Manjani studioi në Bullgari për histori. Kujtojnë me mall edhe Vera Muçën, Ramzan Muçën, Xhavit Spatën, të cilët patën një karrierë të suksesshme në fushat e tyre të punës. Kjo klasë ka nxjerrë edhe dy profesorë doktorë, Nuri Abdiun dhe Ismet Bellovën, të cilët janë nderuar edhe me titullin "Mësues të Popullit", apo edhe Hava Shehun, Mësuese e Merituar. Nga kjo klasë kanë dalë mjekët e njohur Rexhep Klosi, Ahmet Alliu dhe Zenel Kazhani.



Ne foto: Nga e majta në të djathtë: Ismet Bellova, Mendu Dema, Rexhep Klosi, Nusrete Shehu, Nuri Abdiu, Fiqrete Shehu, Riza Lika dhe Shemsi Manjani. Foto: B.Karoshi

Shemsi Manjani është njëri nga organizatorët e takimit. Tregon shkurtimisht për jetën e tij, sidomos për 20 vitet e fundit. Humbjen e bashkëshortes e kujton me hidhërim, por ndjehet gëzimi në sukseset e fëmijëve, Sokolit dhe Teutës. Shemsiu ka qenë për rreth një dekadë shef i drejtorisë arsimore të Dibrës, drejtor i gjimnazit dhe pedagogjikes si dhe kryeredaktor i gazetës lokale "Ushtima e Maleve".

Pas tij flet Riza Lika. Ai jeton në Amerikë. Si në pleqëri, ka kohë dhe merret me veprimtari atdhetare. Drejton atje shoqatën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", por jetën familjare e ndan mes Neë Yorkut dhe Moskës, ku jetojnë dhe punojnë djali dhe vajza.

Për jetën e tyre, flasin edhe Fiqrete Shehu - vajza e tregtarit dhe dibranit të mirënjohur Ymer Maliqit; Nusret Shehu, e shoqja e Tahir Haxhiymerit, docent dhe pedagog në fakultetin e inxhinierisë.

Doktori Rexhep Klosi më shumë mundohet ti kuptojë shokët e tij nga mimika dhe lëvizja e buzëve, pasi dëgjon më vështirësi. Ndërsa bisedës i jep ton të lartë Ismet Bellova, i cili pas çdo shqiptimi të fjalëve të kujton fushat e futbollit. Ismeti dhe Bashkim Kukeli pas unikes ndoqën shkollën dhe institutin e fizkulturës, duke e lidhur kështu karrierën përjetësisht me fushat e blerta.

Tetë shokët e shkollës unike e pinë makiaton e ftohtë në këto ditë nëntori. Filxhani dhe biskotat mbi tavolinë ishin vetëm një zbukurim i tavolinës, sepse ngrohtësia, kujtimet, respekti dhe dashuria për njëri-tjetrin i ngrohu më shumë se çdo gjë. Duke dëshmuar se ata ishin jo vetëm një brez i vuajtjeve dhe sakrificave, por edhe një brez i ëndrrave plot shpresë!

Bujar Karoshi

Përfundoi edicioni i 19-të i Festivalit mbarëkombëtar
"Oda Dibrane" 2013

"Oda Dibrane"

Festivali i trashëgimisë popullore nga gjithë trojet shqiptare

Më 22 dhe 23 nëntor 2013, në qytetin e Peshkopisë u zhvillua edicioni i 19 – të i Festivalit mbarëkombëtar "Oda Dibrane", i vlerësuar nga specialistët si një nga festivalet më të rëndësishëm e më të suksesshëm në Shqipëri. Në të morën pjesë 15 grupe nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Ky Festival, është një ngjarje e madhe kulturore jo vetëm për Dibrën, por për të gjithë kulturën tonë kombëtare.

Peshkopia, me "Oda Dibrane" është dallëndyshja e parë në Shqipëri që realizoi evenimente të tilla madhore kulturore që me pas u imitua pothuajse nga të gjitha qytetet e Shqipërisë. Por asnjëra nuk pati një vazhdimësi të tillë e sidomos një sukses të tillë. Kjo si meritë e gjetjes dhe e përcaktimit të profilit të papërsëritshëm me asnjë festival, mënyrës së organizimit dhe sidomos të vlerave që sjell çdo vit.

Festivali Folklorik "Oda Dibrane" ka për qëllim të prezantojë kulturën shpirtërore të popullit tonë si dhe të promovojë vlerat e trashëgimisë shpirtërore në një gjini krejt të veçantë të folklorit tonë, atë të këngës dhe valles humoristike, të ritit dhe të alegorisë, si dhe ruajtjen, mbrojtjen dhe propagandimin e vlerave më të mira të trashëgimisë shpirtërore mbarëkombëtare të formave dhe gjinive të tij si: kënga, melodia, interpretimi, instrumentet popullorë, vallja popullore, ritet,veshjet e traditës, zejet tradicionale,lojërat popullore etj. Kjo e bën këtë festival të papërsëritshëm, të veçantë e të kërkuar.


Veç konkurrimeve të grupeve pjesëmarrëse në ditët e festivalit, ditën e dytë, në hollin e Pallatit të Kulturës u hap ekspozita e skulptorit Ramadan Kanxha me punime në dru e bakër.

Në ditën e dytë të festivalit u zhvillua edhe parakalimi tradicional me kostume kombëtare në bulevardin "Elez Isufi" dhe më pas në sheshin para Pallatit të Kulturës u zhvillua një koncert nga grupet pjesëmarrëse që u ndoq nga qindra qytetare.

Në natën e dytë, ose ndryshe nata e ndarjes së çmimeve, veç grupeve konkurruese u dha edhe një koncert nga artistët profesionistë të Qendrës Kulturore "Haki Stërmilli" të qytetit, me materiale humoristike, këngë qytetare dibrane, pjesë orkestrale e këngë folklorike.

Në fund, me motivacionin "Për kontributin e dhënë ndër vite në festivalet 'Oda Dibrane'", juria nderoi Refajete Fazlliun, Rizvan Sinanin, Jetmir Rexhepin, Sherif Dervishin dhe Myfterim Kupën.

Ndërsa për grupet pjesëmarrëse, Shoqëria Kulturore Artistike "Muharem e Xhevat Qena", Prizren- Kosovë u nderua më çmim për "Vallen e vajzave nga riti i kanagjegjes". Ansambli " Gjilani" Gjilan-Kosovë u nderua për "Vallen e burrave". Shoqëria Kulturore Artistike "Jehona" Koroshishtë - Struge u nderua me çmimin ikurajues për pjesëmarrjen në "Oda Dibrane" 2013. Qendra Kulturore Kamëz u nderua për grupin vokal të vajzave, ndërsa Shoqëria Kulturore Artistike "Xheladin Zeqiri" - Tetove dhe "Etno" Ansambli, Tetovë për grupin vokal të burrave. Ansambli folklorik "Drashovica" - Vlorë u nderua për performancën e shkëlqyer të këngës polifonike, ndërsa Ansambli, "Shote Galica" Drenas- Kosovë,



Ky festival vazhdon t'i bëjë jehonë emrit të mirë të Dibrës

për orkestrinën popullore. Qendra Kulturore Bulqizë u nderua për kostumet kombëtare të vajzave. Shoqëria Kulturore Artistike "Strajani" Gostivar u vlerësua për instrumentistin në gajde Adnan Aliu. Ansambli "Besa", Kavajë për Vallen e qypave. Qendra Kulturore "Haki Stërmilli" Peshkopi u vlerësua për melodinë orkestrale në instrumente popullore luajtur nga formacioni i fëmijëve. Shoqëria Kulturore Artistike "Drita e Dervenit" Saraj - Shkup për instrumentistët me curlë e lodër që shoqëruan vallet e burrave. Të gjitha çmimet u shoqëruan me logo në bakër të festivalit "Oda Dibrane".

"Ky edicion i Odës Dibranë, është i vetmi vit që realizohet pa mbështetjen e Ministrisë së Kulturës", thotë Drejtori i Festivalit Veli Vraniçi. "Ky vit ka qenë i vështirë, por me këmbëngulje u arrit të realizohet. Ne do të vazhdojmë të punojmë për realizimin pandërprerje të këtij evenimenti shumë të rëndësishëm për Dibrën. Ndaj që tani kemi filluar të mendojmë për edicionin jubilar, të 20-tin, që do të realizohet vitin e ardhshëm. Besojmë dhe shpresojmë që edicioni i 20-të do të jetë ndryshe, jo vetëm në kohë, por dhe në mënyrën e organizimit, kohëzgjatjes, realizimit e shumë elementëve të tjerë", thotë ai për gazetën "Rruga e Arbërit".

"Ne e dimë se ky festival vazhdon t'i bëjë jehonë emrit të mirë të Dibrës, thotë Vraniçi. Me këtë rast, ai shpreh edhe falënderimet për mbështetësit, sponsorët, qytetarët, e sidomos kompanitë e mëdha si Vodafon Albania, Societe Generale Albania,hotelet e qytetit, firmat e ndërtimit, biznesmenët dibrane në Tirane e qytetarët e Peshkopisë, që pavarësisht shumës, me dëshirë duan të jenë pjesë e realizimit të këtij Festivali.

Korresp. "Rruga e Arbërit"





cyan magenta yellow black

"Kanun" - i pari studim në llojin e vet që rrok një tërësi problemesh dhe dukurish kanunore që nuk janë prekur deri më sot nga studiues të tjerë.

"Kanun" nga Xhafer Martini, një enciklopedi e jetës shqiptare

Nga **RAMIZ GJINI**

Çquajta për nder dhe si një privilegj të veçantë që më bëhet nga shkrimtari dhe studiuesi i mirënjohur Xhafer Martini që të shkruaja parathënien për studimin mbi Kanunin. Ky studim është një vepër e dorës së parë për shumë arsye që do t'i rendis më poshtë:

Është i pari studim në llojin e vet që rrok një tërësi problemesh dhe dukurish kanunore që nuk janë prekur deri më sot nga studiues të tjerë. Mjafton të kujtojmë pak prej temave të tilla, si: Ndikimi i Kur'anit në Kanun, Kanuni dhe totalitarizmi, Sjellja agresive, Dhuna e fjalës, A e kishte Kanuni dënimin me vdekje, Veprimet mbi Kanun, Koncepti mbi burrin, Kur dhe si është krijuar Kanuni, Kanuni dhe Kushtetuta, Si krijohen norma kanunore, Kanuni dhe nacionalizmi, Kanuni dhe totalitarizmi dhe disa kapituj nën titullin: Ndryshime e përkime (krahasime midis Kanunit të Lekë Dukagjinit, Kanunit të Skënderbeut dhe Kanunit të Dibrës). Edhe ndonjë temë që është trajtuar më parë, si: Kanuni dhe letërsia, tek ky autor vështrohet ndryshe dhe mënyra e qasjes më duket më efikase.

Autori hedh konceptin e një Kanuni për të gjithë botën shqiptare. Këtë mendim e kanë hedhur edhe të tjerët, por duke e ngushtuar këtë, sepse kanë pasur parasysh vetëm Kanunin e Lekë Dukagjinit. Kurse Xhafer Martini këtu ka parasysh Kanunin në tërësi.

Autori përdor rrugën ose metodën e krahasimit për tre kanunet që ka marrë në shqyrtim: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Dibrës, duke parë tek secili prej tyre dhe tek të gjithë bashkë, (edhe tek kanunet e tjerë që nuk përfshihen në këtë studim), nëpërmjet varianteve dhe invarianteve, unitetin e të drejtës sonë juridike shqiptare. Përfundimi se Kanuni është i njënjëshëm në ndryshim, është baza nga niset autori për ta parë atë si pasuri në larmi.

Xhafer Martini sjell nocione dhe koncepte të reja për përmbajtjen e Kanunit, duke dalluar tek ai dy shtresa: shtresën e normave dhe shtresën e praktikave popullore (kazuseve). Këto të fundit, edhe kur nuk zënë vend në Kanun, në jetë ekzistojnë. Autori tregon në mënyrë shkencore lidhjen, ndërvarjen dhe integrimin e këtyre shtresave në njëra-tjetrën, por duke u dhënë përparësi praktikave kanunore, që janë burimi i vërtetë i normave kanunore. Në këtë studim hyhet në thellësi, në thelbin e normave kanunore, duke i dalluar zgjidhjet kanunore nga normat dhe këto të fundit nga përkufizimet. Ai tregon se si krijohen normat kanunore, ku ndryshojnë ato nga zgjidhjet, dhe nga përkufizimet.

Praktikat kanunore (kazuset) kanë edhe ato nënndarjet e veta. Autori i jep ato deri në hollësi. Në këtë studim ka mbi pesëdhjetë kazuse, të paraqitura me një gjuhë të pasur dhe stil të përshtashëm, që jo vetëm tregojnë ku është mbështetur dukuria kanunore, por edhe të japin kënaqësinë e prozave të shkurtra e të bukura letrare. Autori është mjeshtër i mënyrës së rrëfimit popullor. Studimi i Xhafer Martinit ka një bazë të shëndoshë referencash. Por kryesorja në këtë studim qëndron tek përvoja personale, që është e pazëvendësueshme me asgjë tjetër. Falë kësaj përvoje ai tregon edhe se si krijohet dhe si vdes KANUNI, duke dalluar dy vdekje për të: njëra kur mblidhet e kodifikohet, pra, kur kthehet në libër, dhe tjetra kur e humb funksionin e përdorimit. Vdekje intelektuale, kulturore dhe artistike për Kanunin nuk do të ketë kurrë.

Dhe në fund desha të them se Gjakmarrjen për të cilën është folur dhe flitet shumë, Xh. Martini e ka paraqitur me thellësi dhe thjeshtësi, duke argumentuar me shumë shembuj dhe logjikë kanunore se sot nuk kemi gjakmarrje por krim të pandëshkuar. Autori bën shumë mirë dallimin midis hakmarrjes dhe gjakmarrjes.

Ky autor, me gjithë kontributin e madh që sjell, është modest në paraqitjen e çdo gjëje. Nuk ka pretendime shteruese. Ai jep mendimin e tij, por nuk e konsideron atë si fjalë të fundit.


Në këtë studim ngrihen edhe probleme të tjera, por edhe me këto që thamë, besojmë se ai ka merita të mëdha dhe i shtyn më përpara studimet tona për Kanunin. Kanuni është enciklopedia e jetës shqiptare dhe për studimin e tij mund të angazhohen shumë shkenca dhe disiplina shkencore sipas specifikave që kanë.

Për gjuhën e pasur dhe të saktë, për mënyrën se si është shkruar, për lirshmërinë dhe dallgëzimet stilistike, ky studim është i përdorshëm dhe i dobishëm edhe për lexuesin e thjeshtë, edhe për shkencëtarët e kësaj fushe. Një nga meritat e autorit në këtë studim qëndron në faktin se ai është konceptuar si një dramë, e cila, nga akti në akt vjen duke u ngritur dhe duke ngjallur më shumë interesin dhe vëmendjen e spektatorit deri në çastin kur bie perdja e kur, natyrshëm, shpërthejnë duartrokitjet e tyre. Kjo ka ndodhur se autori e ka strukturuar mjaft mirë materialin që ia ka paraqitur lexuesve.

Të studiosh Kanunin shqiptar do të thotë të kontribuosh për studimin e njerit prej qytetërimeve që u ka rezistuar shekujve dhe mijëvjeçarëve. Kur shprehem kështu kam parasysh kuptimin e Fernand Braudel, i cili nën veprën e tij "Gramatika e qytetërimeve", thotë se karakteristikë për qytetërimet është përbërja e tyre nga struktura të vjetra, që zgjasin shumë në kohë dhe që kanë përgjithësisht tipare të dallueshme dhe origjinale, dhe u japin qytetërimeve fytyrën e tyre të veçantë, qenien e tyre.

Qytetërimi ynë i lashtë përbëhet nga Kanuni - një strukturë e lashtë, tipike e palëvizshme, shumë e qëndrueshme.

Edhe nëse ky studim nuk është i përkryer, sepse vepra të përkryera njerëzore nuk ka, hap një trase, tregon një shteg nga hyhet, dhe një rrugë në të cilën mund të ecin shumë të tjerë në kohët që do të vinë.



> Për gjuhën e pasur dhe të saktë, për mënyrën se si është shkruar, për lirshmërinë dhe dallgëzimet stilistike, ky studim është i përdorshëm dhe i dobishëm edhe për lexuesin e thjeshtë, edhe për shkencëtarët e kësaj fushe.

Tablo atdhetare që ka sfiduar kohën

Nga **ATLI DEMA**

Dibra - rrugicat dhe shtëpitë karakteristike dibrane, çezmat, figurat patriotike shqiptare, monumentet kulturore te djeshme dhe të sotme, ndërmjet tyre ato që i kanë lënë përshtypje autorit të skalitura nga çekani i kohës, por edhe të mbetura në një fotografi apo imazh përshkrimi i të moshuarve, të gjitha këto që kanë kaluar përmes tablosë së pikturave të piktorit të njohur Sabit Bocku, u prezentuan në ekspozitën e Qendrës për Kulturë me rastin e festës së 28 nëntori në Dibër të Madhe.

Ekspozitë pikturash apo koloni e larmisë patriotike u pasqyrua në ekspozitën 30 pikturëshe të shtruar në pëlhurë të Sabit Bockut, që pareshtur Dibrën dhe dibranët ka ditur ti prezantojë me virtyte e anë pozitive, që nga veshja tradicionale arte fakte të ndryshme, por edhe raritete që sfidojnë kohën nëpër breza.

Gjatë hapjes së kësaj ekspozite Kryetari i Komunës së Dibrës Ruzhdi Lata foli për pasqyrimin e të kaluarës në pëlhurë, ku Sabiti e paraqet disi më ndryshe sepse peneli i tij më shumë hijeshon figurat eminente dibrane që me pushkën apo pendën e tyre hyjnë dhunshëm në historinë mbarëkombëtare.

Ismail Qemali e Isa Boletini, Elez Isufi e Mersim Dema të portretizuar në stilin e tij modern ku ngjyrat e lehta dominojnë hareshëm në portretet e radhitura, jo sipas hierarkisë së meritave, por të radhitura si një barrikadë mbrojtëse të së kaluarës nga turqit e serbët. Ku në këtë rrafsh janë vënë edhe arsimtarët e parë dhe parësia e Dibrës si Said Najdeni, Vebi Dibra e dom Nikoll Kaçorri. E të tjerë, që në Dibër e rrethina nuk janë të pakët.

Edhe skulptori Fitim Sula nga Rogozhina, që aktualisht në Dibër është duke portretizuar skulptorin në gur të luftëtarit dibran kundër serbit, për profesorin Bocku thotë se shija patriotike është dominante në bagazhin e pikturave të paraqitura në ekspozitën e 28 nëntorit.Ndërkaq prof.dr. Mahmut Hysa nënvizon se Sabit Bocku në këtë ekspozitë ka paraqitur Dibrën që nga e kaluara e deri më sot. Në këtë ekspozitë gjenden edhe tablo që sjellin në kujtesë ngjarje të kalave si kalaja e Ulqinit e Shkodrës dhe kalaja e Sfetigradit, pamje të vjetra të qytetit, por nuk ka munguar edhe shtëpia e Kongresit të Dibrës.





Ekspozitë e piktorit Sabit Bocku

> Piktori i njohur Sabit Bocku prezantoi pikturat në Qendrën për Kulturë me rastin e festës së 28 Nëntorit. Ai numëron në agjendën e tij gati 25 ekspozita të hapura jashtë vendit dhe me qindra në Dibër, për të cilat ka marrë edhe mjaft mirënjohje.

Mjaft qytetarë gjatë vizitës së pikturave shprehën dëshirën që të pyesin ku gjendet kjo pjesë, kjo lagje apo ajo shtëpi, që për një numër mjaft të madh tek të rinjtë mbolli kureshtje.

Në agjendën e tij artistike piktori numëron gati 25 ekspozita të hapura jashtë vendit dhe me qindra në Dibër, për të cilat ka marrë edhe mjaft mirënjohje.

Piktori Sabit Bocku mburret jo vetëm për punimet e tija, por edhe për atë se djali i tij Dritani është duke punuar si arsimtar i artit në shkollën fillore "Penestia", që do të thotë se ka lanë trashëgimtar në profesionin e tij, që ai e quan të shenjtë.

Dëshmi e vizitave të kryera në këtë ekspozitë të pikturave, janë edhe mbresat e lëna me shkrim, në "Librin e përshtypjeve". Të pranishmit në ekspozitë e uruan profesor Sabitin për pleqëri të mbarë dhe me krijimtari të bollshme e cilësore.

Kërkojini njerëzit e shquar midis njerëzve të zakonshëm
dhe do të shihni se sa shumë do të rritet numri i tyre.

Bajram Stojku, portret i paautorizuar

Nga **GENC MELONASHI**


Në foto: Bajram Stojku

Jeta jonë, jeta e çdo njeriu, familjeje apo komuniteti, ngjan pak a shumë me një dramë, veçse me një dramë disi të veçantë. Një dramë, ku secili prej nesh është jo vetëm aktor edhe regjisor, por edhe spektator i saj. Varet prej nesh, d.m.th. nga "loja" jonë individuale dhe në ekip, në se kjo dramë kthehet në tragjedi apo komedi. Varet prej nesh nëse ajo bëhet dinamike, si një përrua i fuqishëm, apo monotone, si uji i ndenjur moçalor. Paradoksalisht, shumica prej nesh futen në grupin e këtyre të fundit, e njerëzve të pa fat, që vijnë dhe ikin nga kjo botë si hije dhe janë të destinuar të harrohen. Fatlumët i përkasin grupit të parë. Jetët e tyre janë të plota, të mbushura me ngjarje. Ata kanë çfarë t'u tregojnë apo t'u lënë trashëgim brezave. Në historitë e tyre gjen të ndërthurura në mënyrë harmonike, dashurinë, mençurinë, besnikërinë, ndershmërinë dhe heroizmin. Mbase për këtë kategori njerëzish e ka patur fjalën një burrë i ditur, kur ka thënë: Sa herë që largohet nga jeta një i moshuar, bota humbet një bibliotekë. Unë besoj se kjo thënie nuk është vetëm një konstatim. Më së shumti, ajo është një thirrje ndaj ndërgjegjes së gjithsecilit që të ketë kurajën ta tregojë apo ta shkruaj jetën e tij, jetën e familjes apo të komunitetit të vet. Është ky, një shërbim, një dhuratë, sado modeste, që secili prej nesh detyrohet t'ia lerë njerëzimit. Por, mjerisht kjo gjë ndodh shumë rrallë. Janë të paktë ata që marrin guximin të shfaqin në publik jetën e tyre apo të familjes së tyre. Dhe ndër këta të paktë, fati bëri të njihem me njërin prej tyre.. Është një burrë me një shtat të lartë dhe të drejtë. që të befason kur mëson se në dhjetorin. e vitit tjetër, mbush tetëdhjetat. Ndërsa e sheh të dali çdo mëngjes nga shtëpia me kostum, këpucë të lustruara, këmishë të bardhë e të kollarisur, mendon se do t'i hipi ndonjë mercedesi dhe do të shkoj për kafe në Sheraton. Por jo. ai çapit me hapa të drejtë si një statujë e bukur gdhendur, drejt lokalit më të thjeshtë të lagjes. Dhe kjo ndodh çdo ditë në orën nëntë të mëngjesit. Atje e presin ose ai pret miqtë e tij. Janë njerëz të thjeshtë ose të rëndësishëm, të moshuar ose të rinj, të shkolluar ose jo dhe nga të gjitha krahinat. S'është vetëm një gjerbje kafeje, por një "kuvend" ku diskutohen "të gjitha problemet dhe hallet e botës". Diskutohet mbarë e prapë, për dashurinë, për familjen, pleqërinë, letërsinë dhe politikën. Një kuvend i këndshëm, ku të pranishmit nuk e venë re si kalon koha dhe habiten kur dikush thotë se "paska vajtur ora 12 dhe hajde të çohemi se na pret familja". Të gjithë flasin, të gjithë tregojnë copëza nga jeta e tyre, familja dhe krahinat ku kanë jetuar apo punuar. Flet edhe ai, por seç ka diçka të veçantë në fjalët dhe shprehjet që artikulon. Gjen aty pasionin, etikën, kulturën e mjaftueshme, edukatën, vendosmërinë dhe saktësinë e asaj që thotë. Me pak fjalë, është i drejtpërdrejtë, pa dredha, ose siç thotë një poet verior: "E qet fjalën rrumbullak, pa qoshe aspak". Mbase e gjithë kjo është përvojë e moshës, e aktivitetit të larmishëm jetësor, mbase, mbase... Por ajo që spikat, që është e qenësishme, duhet të ketë të bëjë me genin. Jo genin mjekësor, atë të gjakut, por një gen i krijuar nga mjedisi ku ka lindur dhe është rritur, ku mishërohet historia shekullore e popullit të një krahine të tërë. Tashmë, dhe jo si në fillim të njohjes me të, unë nuk habitem më, me vendosmërinë e tij për të mbrojtur me pasion çdo vlerë të popullit të krahinës ku u lind, u rrit dhe punoi një jetë të tërë. Nuk habitem kur ai hyjnizon bij dhe bija të asaj krahine që kanë sakrifikuar në shekuj, për lirinë, pavarësinë dhe mirëqënien e gjithë trojeve shqiptare. Unë nuk do të çuditesha në se ai, aq sa hyjnizon Enver Hoxhën do të hyjnizonte edhe Sali Berishën me kushtin që ky I fundit t'I sillte Shqipërisë veç të mira dhe jo aq prapësi sa na panë sytë... Dhe kjo mund të ndodh vetëm me një njëri që në moshën dhjetëvjeçare ka parë të vritet baba i vet, një njeri i mirë që e ka dashur me shpirt popullin dhe vendin e vet. Një fëmijë që i pa dhe i njohu ata që i vranë të atin, kolaboracionistët që nuk e donin lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë. Një fëmijë që u rrit dhe u burrërua me ata që luftuan për çlirimin e vendit. U rrit dhe u burrërua duke u rreshtuar denjësisht me gjithë ata që kontribuan në rimëkëmbjen e ekonomisë, arsimit, kulturës dhe mirëqenies të popullit tonë. Është mëse e vërtetë që historia e popullit tonë heroik, ka ecur nëpër rrugë të përgjakura. Ato i gjen kudo në të gjitha trojet shqiptare. Një rrugë të tillë e gjen edhe në një qytet verilindor tonin. Është pikërisht ajo rrugicë ku ndodhej dhe "ndodhet" konaku ku u lind personazhi ynë. U lind aty, dhe si një gur i rëndë nuk lëvizi për gjatë gjithë jetës së tij aktive. Aty e mbertheu "geni", amaneti i babës dhe të gjithë atyre që ranë heroikisht për vatanin. Aty e mbërtheu dashuria dhe vullneti për ta parë qytetin dhe krahinën e vet sa më të begatë e të bukur. Në atë qytet dhe në atë krahinë, s'besoj se ka fushë të ekonomisë, të bujqësisë, të transportit, elektrifikimit e tj, ku të mos ketë mbetur e vulosur edhe djersa e mundi i këtij njeriu... Dhe vjen një ditë kur populli i shpërblen bijtë e vet të mbarë. Vjen një ditë kur Këshilli Bashkiak i këtij qyteti, me një "kolorit të larmishëm" kryen një akt jo shumë të zakontë për mjedisin politik shqiptar. Vendos unanimisht që personazhit tonë t'i akordojë titullin "Qytetar Nderi"-. Dhe ka vetëm një arsye: Atë nuk e shajnë dot as të majtët, as të djathtët. Ose më bukur dhe më e mundshme: Atë e duan edhe të majtët edhe të djathtët...Nderim i madh apo jo?! Por gjithëkush që do të gërmonte sado pak në biografinë e personazhit tone, nuk do të habitej nga kjo gjë. Nuk do të habitej kur të mësonte se dikur,"në kohën që shkoi" ai do të meritonte edhe nderime të tjera. Po përmend më kryesoret: Dy Urdhëra Pune të Klasit të Parë, njërin për elektrifikimin e Dibrës dhe tjetrin për furnizim me ujë të pijshëm të krejt rrethit. Urdhërin e Flamurit të Klasit Parë, për merita të shquara. Dhe këto tituj nuk ia dha atij as "partia" as "besnikëria" ndaj saj. Ato ia dha personaliteti i tij, ia dha përkushtimi, djersa dhe mundi i tij. Dhe diçka tjetër: Si mund të mos e duash një njeri që nuk njeh urrejtjen, por dashurinë ndaj njerëzve?! Si të mos e duash një njeri që ka luftuar dhe lufton kundër dizarmonive familjare dhe gjithë dasive mes shqiptarëve, këtë pionier të pajtimit të gjaqeve, me kontribute të çmuara në shërimin e kësaj plage të rëndë të shoqërisë shqiptare?! Nëse dikush që ka jetuar në Peshkopi apo në rrethinat e tij, dhe pse jo, edhe në rrethet fqinje, do t ë lexonte rreshtat e shkruara më sipër, do të thoshte menjëherë: Ky njeri quhet Bajram Stojku.

Tashmë është e qartë pse ky individ ka të drejtën morale të shfaqet publikisht. nëpërmjet një libri dhe ti drejtohet lexuesve pa kurrfarë droje apo kompleksi duke u thënë hapur: Kjo është familja ime, ky është qyteti im, kjo është krahina ime dhe kam të gjitha arsyet e kësaj bote të ndihem krenar që jam bir i tyre. Bukur apo jo?! Por unë kam zbuluar sekretin e vërtetë pse u shkrua ky libër nga një pasardhës i denjë i Stojkajve të Peshkopisë. Unë jam i bindur se ky njeri i mirë ka patur gjatë jetës së tij edhe dy pengje. Njeri peng, të cilin ai e kapërceu, ishte rindërtimi i sarajeve të ngritura me mund e djersë nga babë Alushi dhe nanë Hamideja, të djegura mizorisht nga bashkëpunëtorët e pushtueseve dhe gjermanët. Tjetri ishte një peng moral: Ai nuk do të mundte kursesi të linte "të digjej" nga koha një histori heroike e një familje atdhetare, e nderuar dhe e respektuar nga i gjithë komuniteti. Madje, për të mos u treguar "i ngushtë" apo "lokalist", dramën e familjes së tij, ai e përfshiu në një dramë më të madhe, atë të Peshkopisë dhe krahinës së Dibrës, me të gjitha familjet e njohura të saj. Dhe kjo përbën një vlerë tjetër të çmuar të librit. E pra, z.Bajram Stojku, tashmë e ka kapërcyer edhe pengun e dytë. Ai i la brezave jo vetëm një libër, por një tufë me dokumente. Gjithëkush që do të ketë fatin të lexoj librin, besoj se do të thotë se libri është vërtet i bukur. Zaten kështu janë të gjithë librat që shkruhen me dashuri dhe kanë brenda vërtetësi. Nuk mund ta mbyll pa bë ë edhe një koment të vogël, por sigurisht pa guxuar t'i shtoja as një fjalë të vetme parathënies të shkruar me dashuri dhe mjeshtëri artistike nga i respektuari Naim Plaku. Një perlë e vërtetë, për të cilën i transmetoj përgëzimet e mia. Dhe se fundi komenti që do të bëja lidhet me mbylljen e librit. Z. Stojku e ka mbyllur me një epilog. Për mua kjo përbën kapakun e florinjtë të krejt veprës. Është një copëz proze poetike e përkryer, që do ta kishin zili edhe shkrimtar ë të afirmuar. Dhe në fund për ta mbyllur nuk mund ta anashkaloj atë që ka thënë Xhelil Gjoni me rastin e 70 vjetorit të zotit Bajram Stojku, por kjo shkruhet me dëshirën e vetë të zotit Xhelil sigurisht dhe të Bajramit: "Më në fund edhe ti hyre në radhët e të moshuarve. Pra u "burrërove". Mbushe shtatëdhjet vjet. Edhe pak, edhe shumë. Pak, se njeriu dëshiron të jetojë sa ma gjatë dhe kështu 70 vjet nuk janë shumë. Prandaj të uroj të bëhesh 170. Shumë se është një jetë e tërë që ke kaluar me sakrifica, me punë të lodhshme por gjithë sodisfaksion. Ti nuk u rrite si i përkëdhelur. Ti u rrite në moshë, dhe si njeri sepse si gjithë brezat e 50 viteve punove si "spartan dhe jetove si skllav" në kuptimin më të mirë të kësaj fjale. Pa u lodhur, pa rënkuar në shi e në erë, ditë edhe natë, me gjumë e pa gjumë, i ngrënë dhe i pa ngrënë gjithnjë duke vënë interesat e përgjithshme mbi ato personale e familjare.

Dhe nuk mjaftonin këto, por të shoqëronte nga prapa edhe nofka e "mendjemadhit" që nuk sajdiste "udhëheqësit" mediokër të rrethit, që me megallomaninë dhe injorancën e tyre e lanë prapa këtë trevë të mrekullueshme e popull të talentuar. Prandaj të uroj të mbetesh i tillë deri në frymën e fundit; i qartë, kurajoz, i zgjuar, jashtë konjukturave që sajojnë partijzat si kërpurdhat pas shiut, për interesin e tyre, për të mbuluar pisllëqet që kanë bërë. Për këtë jam i bindur se i tillë do të mbetesh".

Në ditët që po mendoja të shkruaja këto rreshta, dikush nga miqtë e mi më pyeti nëse ka ndonjë libër, apo material të shkruar, thjeshtë për jetën e këtij personazhi dhe ku mund ta gjej? I thashë se është kollaj fare. Takoje dhe bisedo me të, se vetë Bajram Stojku është si një libër i hapur....

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Besa - virtyti ynë më i lashtë e sublim

Nga **PETRIT FETAHU**

Besa si fenomen suptil psikologjik dhe juridik është pjesë e trashigimisë së lashtë të kulturës sonë popullore të përcjellë e të transmetuar brez pas brezi si vlerë sublime shpirtërore si pjesë e mentalitetit të kombit tonë që i ka normëzuar marrëdhëniet morale dhe etike të çështjeve të ndryshme jetësore dhe shoqërore në një akt shumë të thjeshtë, por shumë të rëndësishëm.

Besa paraqet një aspekt thelbor moral, etik, edukativ, kulturor që me shekuj shqiptari e ka mbartur si komponent të pandashëm të etnopsikologjisë individuale, kolektive dhe kombëtare, që e mpleks dhe e manifeston edhe folklori si fenomen jetësor i përditshmërisë dhe i proçesit shoqëror e historik për të shprehur karakterin e fortë e të formuar, vetitë e tij si burrërinë, trimërinë, sinqeritetin, vendosmërinë dhe vlerat e tjera për t'i qëndruar konseguent një marrëveshtjeje për çështje të ndryshme midis dy palëve. Të gjitha raportet e veprimit të ndërsjelltë, të bashkëpunimit, të inisiativave janë përcaktuar, zgjidhur dhe realizuar përmes duarve të lëshuara e të shtrënguara me fjalët, "ta jap besën" që duhet ta përfillim e ta përmbushin të dy anët pa iu shmangur, i cili dakordim ishte zotim dhe obligim i secilit, saqë ishte ngritur në një institucion besimi normalizuar dhe kanunor me përgjegjsi të madhe për përmbajtjen me saktësi, si garancë e zbatimit, përndryshe do të injorohej dhe poshtërohej nga fisi e më gjërë.

Letërsia popullore përmban dhe apsorvon shumë shembuj të fjalës së dhënë që dëshmojnë për peshën e madhe të këtij akti e përbetimi që argumentojnë se ky popull "besën e konsideron kurorëzim të të gjithë virtyteve njerëzore, sinonim të vetë jetës së ndershme të individit, ndaj nuk ka fuqi më të madhe se detyra e domosdoshme për përmbushjen e saj".[1]

Baladat na bindin dhe na faktojnë se sa çmohet dhe nderohet besatari, ngase ai në sajë të asaj dhuntie arrin t'i sjellë autoritet, së pari vetvetes, familjes dhe fisit, ai siguron besim të tejkalojë shumë sprova ekonomike, por edhe të krijojë epërsi për prosperitet, të zejë pozitë të merituar dhe të respektuar në shoqëri. Besa ishte faktor relevant e dominues në përcaktimin e karakterit të personit, ndaj "fenomeni i besës i nxit dhe përcakton në drejtime kryesore veprimet e personazheve të baladave".[2]

Personazhet edhe kur pësojnë fatkeqsi me pasoja ttragjike nga të tjerët që e kanë mbajtur fjalën, siç e kemi në baladën e murosjej me nusen e vëllaut të vogël që kur merr vesht se do ta flijojnë në themelet për ngritjen e kalasë, ajo nuk e fajëson, akuzon dhe e ndërshkon të shoqin që nuk i tregon për marrëveshtjen midis tre vëllezërve se cila do ta sjell drekën do ta varrosin të gjallë në themelet, por mburret me veprën e tij, i jep përkrahje dhe e arsyeton.

Burrit! Burrit tem, thuej
me i thanë,
Se për besë burri më ka dhanë.[3]

Besëlidhësi kurrë nuk pendohet edhe kur pasojat për të janë fatale, përkundrazi mburret e ndjehet krenar pasi ka kryer një vepër madhore, por ai ngashërohet për besëthyesit që ka krye një vepër të pahijshme dhe të turpshme.

Keq me plasë të shoit i ka ra,
Hile vllaznit kah i kanë ba.[4]

Këtë gjendje indinjuese të vet e manifeston me qarje revoltuese që përmban atak ndaj atyre shmangësve të fjalës së thyer që u tregojnë nuseve të mos sjellin drekë muratorëve se do të murosen, ngase kanë bërë akt më poshtrues për vete dhe për të si vëlla i tyre.

Nuk po kaj, thot, për ni grue,
Po qaj vllajt vllajt mos me
i besue.[5]

Ky komponent obligues moral, etik, dhe i normalizuar kanunor dhe kombëtar, i pashmangshëm, shpirtëror ishte i rrënjosur në ndërgjegjen dhe vetëdijen si domosdoshmëri parësore, qoftë për hir të vetvetes, por edhe të fisit e të rrethit, ka zanafillë që në mendësinë dhe në rregullimin juridik të lashtë, që krijojnë marrëdhëniet e ndërsjellta të njerëzve në raportet sociale ekonomike, politike dhe në sfera të tjera, duke formuar arkëtipin, i cili bën gjithëka për të përmbushur gjer në fund besën, premtimin, që e kemi të potencuar dhe të argumentuar edhe në baladën me motivin e vëllaut të vdekur, Konstantinin, i cili i premton të motrës Dorentinë dhe së ëmës që do t'ia sjellë të bijën kur të dojë nga vendi i largët, vetëm të pranojë të martohet, saqë edhe vdekja e tij s'bëhet pengesë e pakalueshme për të realizuar zotimin e dhënë. Këtu është nëna ajo që insiston në vazhdimsinë e përcjelljes së edukatës së besës, ndaj kërkon me ngulm plotësimin e obligimit të tij që e mbart në varr, por që duhet ta ëojë e ta zbatojë gjer në fund. "Në këtë baladë është fjala e dhënë ajo që e dredh tokën dhe hap varret për të bërë të pamundurën: kthimin e njeriut përkohësisht në jetë sa për të përmbushur premtimin."[6]

Konstantin, o birthi i jem,
Ku ë besa që më dhe?...
Besa jote nënë dhe![7]

Trupi vdes, por besa është e pavdekshme, misioni i saj duhet patjetër të kryhet, që i bën pjesëmarrësit të kushtuar dhe të vendosur ndaj saj, njëkohësisht i bën të jenë të drejtë, të ndershëm, të besueshëm, të paluhatshëm ndaj vëllahut, motrës, gruas, mikut, fqiut, shokut, atdheut etj. në dobi të veprave të dobishme, për interesa të larta, të vlefshme që motivon dhe mundëson bindje të fortë për besim të ndërsjelltë dhe të pashmangshëm edhe midis më të afërmit. Besa krijonte preferencë dhe përparsi jetësore. Aga Ymeri në këngën homonime, kur largohet për në burg, kërkon nga gruaja e tij t'ia jep besën se do ta presë gjersa të kthehet.

"A m'ep besën, vashë,
se po më pret"?
"Eh! nandë vjet, tha,
unë të pritsha,
E fat vendit mos i qitsha."[8]

Mbajtja e besës është satisfaksion shpirtëror dhe obligim i madh, ndaj kur afrohet afati i zbatimit, permbushjes, ai është tepër i shqetësuar dhe i mbërzitur kur s'janë plotësuar kushtet dhe mundësitë nga arsyet objektive për t'i ndejtur konsuguent fjalës, ndaj Ymer Aga "bukë s'po han, as ujë s'po pin, qiftelisë nuk pi i bin", jo aq për të shoqen që do të martohet, por për premtimin, besën e dhënë se do të arrijë në kohë. "Në shumicën e varianteve besa bëhet përsëri faktor i rëndësishëm i motivacionit të kthimit të heroit që shënon pikën kulminante të strukturës kompozicionale të baladës."[9] Besëmbajtësi tërë përpjekjet dhe angazhimet të veprimeve i detyron kah realizimi dhe arritja e qëllimit të të mbajturit të fjalës, herë ai jep besë tjetër për ta shpëtuar të parën, ndaj edhe Ymer Aga i qet bijës së kralit "nji dorëzake se shkoj n'shpi dhe kthej prap". Këtë ua thot edhe shokëve.

Besën e zotit ja kam dhanë,
Se në hapsane kam me
u xanë.[10]

Akti i besnikërisë dhe i përpikërisë në shlyerjen e "detyrimit" të besës, ëmohet si vepër madhore morale – etike si nga ai që ia ka dhënë fjalën, ashtu edhe nga të tjerët prezent e përreth e më larg shkon nami i tij, siç vepron krali, i cili e shpërblen Ymer Agën duke e lëshuar të lirë përgjithmonë, pasi kthehet në kohën e caktuar, ashtu siç i kishte dhënë fjalën të bijës së tij dhe e lëvdon me fjalët: "Kenka burrë e gjithmonë kjoftë!"

Besa s'është privilegj, dhunti dhe krenari vetëm e mashkullit, por edhe e femrës, e cila në të zotohet dhe i rrin besnik gjer në fund, siç e dëshmojnë të gjitha variantat e këngëve kreshnike mbi Omerin ku "vajzat e maskuara në meshkuj u japin besën konakxhinjve se do të vijnë në dasma, jo si vëllamë, po si nuse. Këtë do ta realizojnë në tërësi, pavarësisht se fshihen në të."[11] Ata e mbajnë premtimin, sië thuhet në fjalët e tyre.

"Besën e zotit, tha, me ta dhanë.
Sot nji javë në dasëm kam me
t'ardhë."[12]

Besa ka pasur rol polidimensional në jetën shoqërore të shqiptarit, ndërsa efektin e vet e ka bërë edhe në atë politike, duke u vënë në funksion të realizimit të ideve patriotike, të përhapjes të frymës luftarake, të ngritjes së moralit trimëror e të unitetit të popullatës për të shporrë zaptuesit e huaj, pasi kur prisat i lëshonin dhe i shtërngonin duartë po betoheshin në besë për të formuar unitetit midis grupeve apo fraksioneve, ata bëheshin më të fortë, më të guximshëm dhe më të vendosur, askush më nuk guxonte të anashkalonte dhe të devijonte, të tradhëtonte idealin e përbashkët të lirisë. Pra, besa lidhte zemrat, lidhte fuqitë, shtonte besimin e ndërmjetmë duke u bërë faktor detirminant e relevant i lirisë për progres kombëtar në çdo aspekt, ndërsa ajo u vë në shërbim të bashkimit të forcave tona gjatë historisë, sië ka qenë Besëlidhja e Lezhës më 1444, Besëlidhja e Kurveleshit 1547, Besëlidhja e Prizrenit 1878, Besëlidhja e Dibrës etj. si kundër pushtuesve ashtu edhe ndaj dukurisë negative të hakmarrjes, si ajo e Dukagjinit, Mirditës etj.

Malet e Dibrës kishin
lidh' besë,
Kan' lidh' besë, o në din e iman,
Turqve Dibrën, mos me ja
dhanë.[13]

Fjala e premtuar dhe dora e shternguar, si fenomen të kohës, ishte segment thelbor dhe kryesor që përcaktonte karakterin e formuar pozitiv, sië thoshte populli "muri luan, burri s'luan„. Ajo ishte ligji moral dhe juridik që e aplikonin më shumë sfera të përditshmërisë, kur s'kishte gjykata. Ajo kishte hyrë edhe në raportet intime, kur djali deshte të shprehte sinqeritetin dhe besnikërinë ndaj vashës dhe për të fituar besimin e saj, ai i jepte besën, ashtu si në baladën "Ashik Imeri dhe Begzadja e Bardhë", ku Ashik Imeri i jep fjalën Begzadës ose do ta merr për grua ose do të vdes, duke i thënë:

Besën ezitit ja kam dhanë,
No marr tij Begzade, no kurr kan,
Ose dekun vetit po ja baj.[14]

Mirëpo e ëma e kundërshton këtë dashuri dhe për grua ia sjell të bijën e kralit, ndërsa ai nuk mund ta kthejë besën, ndaj ai vuri vetës thikën, njëkohësisht edhe Begzoja e Bardhë veproi në të njëjtën mënyrë e pas tyre edhe e ëma si fajtore e përgjegjëse e kobit familjar.

Tri varret rresht i paskan çilë,
Tri xhenazet n'varr i kanë shti.

Besa bëhët faktor domosdoshmërie në lidhjet e dashurisë midis djalit dhe vashës saqë nuk mund t'i shmangej as njeri as tjetra, ishte forcë konsuguente e tyre, edhe pse presionet e familjeve janë të vazhdueshme dhe këmbëngulse për të krijuar afrim sipas tekave të tyre, përsëri ata mbesin të pathyer që sjem edhe përfundimin tragjik duke qendruar gjer në fund fjalës së dhënë. Besa si fenomen suptil psikologjik dhe juridik është pjesë e trashigimisë së lashtë të kulturës sonë popullore të përcjellë e të transmetuar brez pas brezi si vlerë sublime shpirtërore si pjesë e mentalitetit të kombit tonë që i ka normëzuar marrëdhëniet morale dhe etike të çështjeve të ndryshme jetësore dhe shoqërore në një akt shumë të thjeshtë, por shumë të rëndësishëm.

Besa ishte obligim i madh përpara vetes e të tjerëve, ndërsa shkelja e saj ishte me pasoja të rënda, ngase i sjellte turp dhe i nënshtrohej dënimeve nga rrethi, si izolim, mospërfillje gjer në pushkatim. "Dhe, jo vetëm individi, por fshatra të tëra mund të zhdukeshin nga faqja e dheut, nëse ato shkelnin besën."[15]Ndaj ai që lëshonte dorën e bënte një marrëveshtje me fjalët "ta jap besën" duhej së pari të mendohej se a mund t'i përmbahej ngasej pastaj s'mund t'i shmangej, pasi poshtronte jo vetëm veten, por edhe fisin të tërë, ngase ato fjalë, ajo vepër indetifikonin pastërtinë dhe ndershmërinë e tyre, ndërsa fjala e urtë: "Shqiptari për fjalën, vret djalën", e argumenton bindshëm qendrimin konsuguent, të paluhatshëm dhe sakrifikues të tij në përmbushjen e këtij akti madhor.


> Pra, besa lidhte zemrat, lidhte fuqitë, shtonte besimin e ndërmjetmë duke u bërë faktor detirminant e relevant i lirisë për progres kombëtar në çdo aspekt, ndërsa ajo u vë në shërbim të bashkimit të forcave tona gjatë historisë, siç ka qenë Besëlidhja e Lezhës më 1444, Besëlidhja e Kurveleshit 1547, Besëlidhja e Prizrenit 1878, Besëlidhja e Dibrës etj...

1 Sadri Fetiu, Besa në baladën shqiptare, Gj. albanologjike, Prishtinë, 1980, f. 47
2 Sadri Fetiu, po aty, f. 48
3 D. Shala, Këngë popullore legjendare, EBTM, Prishtinë, 1972, f. 90
4 D. Shala, po aty, f. 83
5 Gjurmime albanologjike, "Ura e shenjtë", Prishtinë, 1971, f. 235
6 Ismail Kadare, Autobiografia e popullit në vargje, N. Frashëri "Tiranë", 1980, f. 7
7 D. Shala, po aty, f. 93
8 D. Shala, po aty, f. 93
9 S. Fetiu, po aty, f. 54
10 D. Shala, po aty, f. 110
11D. Shala, "Trimëria e femrës..." gjurmime albanologjikr, Prishtinë, 1972, f. 212
12 D. Shala, Këngë popullore legjendare, ETUM, Prishtinë, 1972, f. 164
13 IAP, Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare, Prishtinë, 1978, f. 9
14 D. Shala, Këngë popullore legjendare, Prishtinë, 1972, f. 144
15 I. Kadare, po aty, f. 22

Rruga e Arbërit nr. 91

fakte

- Kosova duhet të bëjë më shumë për demaskimin e Serbisë duke i përkthyer librat e botuara për dhunimet mizore të femrave shqiptare nga hordhitë serbe dhe duke i shpërndarë nëpër botë. Këto libra do të kryenin misionin më shumë se sa qindra diplomatë.



Faksimile e hartës së Enciklopedisë Ruse që tregon kufijtë realë të Serbisë në vitin 1817

- Duke e botuar disa herë hartën e vitit 1817, faksimile e enciklopedisë Ruse, dëshirojmë tu tregojmë atyre që nuk e dinë dhe tua rikujtojmë atyre që e dinë, se sa e vogël ka qenë Serbia në ato vite dhe se zgjerimi i kufijve të saj është bërë duke djegur më së shumti trojet shqiptare dhe duke vrarë më së shumti shqiptarët.

Favorizimi i Serbisë vrasëse dhe gjenocidale ndaj shqiptarëve

Nga **REXHEP TORTE**

Besoj se sot nuk ka shtet dhe komb në botë që është më i favorizuar, privilegjuar dhe përkëdhelur se sa Serbia dhe serbët. Terrori, gjenocidi dhe masakrat serbe tashmë një shekull po i përjeton Kombi Shqiptar. Ato u dëshmuan edhe me agresionin okupues serb ndaj Kosovës në vitin 1999. Asokohe me tytën e pushkëve dhe të tankeve u dëbuan afër 1 milion shqiptarë nga Kosova. Ky agresion serb shkrumboi tërë Kosovën duke djegur mijëra shtëpi, duke vrarë,masakruar e dhunuar mijëra shqiptarë mes tyre edhe fëmijë, pleq dhe gra shtatzëna, duke zhdukur edhe një mijë e tetëqind shqiptarë të cilët edhe sot e kësaj dite nuk janë gjetur. Përkundër të gjitha këtyre dëmeve e gjëmave edhe pas çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës, Serbia në vend që të kërkojë falje publike dhe të merr dënimin e merituar nga bota e civilizuar, ajo nëpërmjet instrumentalizimit të serbeve, sidomos në veri të Kosovës, jo vetëm që nuk po shfaq pendimin por ende deklarohet me aspiratat e saj të përsëritura ndaj Kosovës. Kushtëzimi i serbëve se nuk do të marrin pjesë në zgjedhjet vendore të Kosovës më tre nëntor pa u hequr simbolet e shtetit të Kosovës në materialet zgjedhore, kërkesa e tyre për krijimin e bashkësisë së komunave serbe dhe thyerja e kutive të votimit nga persona të maskuar serbë në ditën e votimit, dëshmon faktin se serbët janë komb i pa përmisueshëm. Përsëritja e zgjedhjeve më 17 nëntor me praninë e forcave të Euleksit, Kforit dhe të policisë të Kosovës pamundësuan forcat e errta serbe për ti prishur zgjedhjet. Kjo dëshmon se serbët megjithatë e njohin frikën. Kjo gjithnjë kur kemi parasysh se në Kosovë jetojnë 5% e serbëve duke patur standarde më të favorizuara për pakicat në botë. Kjo aq më tepër kur Serbia në vazhdimësi i shtyp dhe nuk ua jep të drejtat minimale shqiptarëve autoktonë që jetojnë në Kosovën Lindore ose siç i thonë ndryshe në luginën e Preshevës. Elita politike e Luginës së Preshevës më 23 nëntor 2013 shpalli publikisht vendimin se i ndërpret bisedimet e filluara me Qeverinë e Serbisë për shkak të obstruksioneve, dhunës dhe vrasjeve serbe, duke kërkuar mbështetje nga Shqipëria, Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare, që është edhe një dëshmi për kokëfortësinë serbe ndaj shqiptarëve.

Të shpresojmë se bashkësia ndërkombëtare dhe Brukseli kanë strategji afatgjatë sipas të cilës do ta detyrojnë Beogradin që ta pranojë pavarësinë e Kosovës dhe që të drejtat që i kërkon për serbët e Kosovës tua japë edhe shqiptarëve të Kosovës Lindore. Ndryshe Serbia dhe populli serb kurrë nuk korrigjohen dhe nuk do të demokratizohen.

Ekzistojnë shumë argumente të pa kontestueshme shqiptare kundër ultranacionalizmit serb.

KOSOVA DUHET T'I DEMASKOJË SERBËT

Nuk ka asnjë dokument historik që mund të dëshmojë se shqiptarët kanë okupuar qoftë edhe një metër të territorit të huaj. Përkundrazi serbët janë ata që kanë okupuar më shumë troje shqiptare. Këto janë të vërtetat për tua mbyllur gojën Serbisë, Rusisë e kujtdo tjetër dhe për tua hapur sytë atyre shteteve që u besojnë atyre.

Sa herë që Serbia të ngrejë pretendimet e saj të pabaza ndaj shtetit të Kosovës, ne shqiptarët kemi të drejtë dhe obligim moral e kombëtar t'i tregojmë Serbisë se ka qenë e vogël sa një gogël kur ka ardhur në shekullin e gjashtë nga karpatet dhe se është zmadhuar duke përgjakur, vrarë e djegur popuj e troje të huaja e më shumë ato shqiptare.

Betimi i xhandërmarisë serbe më 28 qershor të vitit 2012 në shënimin e 130 vjetorit të themelimit të saj, në ditën e Vidovdanit, fjalët kërcënuese ndaj Kosovës, përshkuar nga një frymë luftënxitëse e romantike i tregoi mbarë botës se Serbia me lazdrimet që po i bëhen nuk mbushet mend dhe nuk ka ndërmend të ndryshojë nga rruga e saj gjakatare e vrasëse.

Me shprehjet e betimit të xhandarmërisë serbe se, "Pa Kosovën nuk ekziston as populli im serb. Pa Kosovën nuk ekziston Serbia ime. Pa Kosovën nuk ekzistoj as unë. Popull serb, vëllezër e motra:Betohem para Zotit. Do të fitoj me nder apo do të vdes. Për nderin tim. Për origjinën time. Për familjen time. Për Serbinë time...", Serbia dhe serbët dëshmuan edhe njëherë ultranacionalizmin e tyre në dëm të shqiptarëve autoktonë të Kosovës.

Deklarata e Vuk Jeremiq, kur ishte ministër i jashtëm i Serbisë dhe njëherësh kryesues aktual njëvjeçar i Asamblesë së OKB- së dhënë për opinion më 13 korrik të vitit 2012 se, "Kosova mund të pranohet në OKB vetëm mbi trupin tim të vdekur", është dëshmi tjetër e primitivizmit serb edhe në rrafshin e kulturës të diplomacisë serbe që e njollos edhe atë ndërkombëtare.

Tomisllav Nikoliq, presidenti i sapozgjedhur i Serbisë, më 19 korrik nuk nguroi të deklarojë se, " nuk do të lejojmë që Kosova të bëhet anëtare e OKB-së".Por Tomisllav Nikoliq nuk mbaroi me kaq. Ai të nesërmen, përkatësisht më 20 korrik para mediave serbe nuk nguroi të deklarojë se, " po qe se Prishtina sulmon dhunshëm veriun e Kosovës, duhet ta ketë parasysh se edhe Serbia mund ta ndjek të njëjtën rrugë për ta kthyer Kosovën".

Këto deklarata të tij shprehin padyshim agresivitetin, mediokritetin dhe ultranacionalizmin serb karshi shtetit të ri të Kosovës. Aq më tepër ku sipas Pakos së Ahtisarit serbëve edhe pse nuk janë as dhjetë përqind në Kosovë, u garantohen të drejtat maksimale që nuk i ka asnjë pakicë në botë. Aq më tepër kur dihet se në veri të Kosovës janë të pranishme kontrabanda, kriminaliteti dhe forcat ilegale të sigurimit serb të mbështetura nga Beogradi, të cilat në vazhdimësi po e destabililizojnë situatën, e që nuk do t'i lejonte asnjë shtet tjetër sovran.

Aleksandër Vulin, ministër për Kosovën në vazhdimësi është duke deklaruar se Serbia nuk do ta njeh Kosovën.

Vrasja e përfaqësuesit të EULEKS-it nga Lituania më 19 shtator 2013 dhe deklarata e kryeministrit serb Ivica Daçiq gjatë vizitës së tij në Podgoricë një ditë më vonë dhe deklarata e tij atje se, "Pavarësia e Kosovës është e përkohshme dhe se Kosova Lindore është çështje tjetër, si edhe obstruksionet serbe para zgjedhjeve, janë dëshmi plotësuese për kokëfortësinë e tyre të pa drejtë ndaj Kosovës.

Kanë kaluar më shumë se 11 vite nga shpallja e pavarësisë së Kosovës Shtetit ri, të cilin gjer tani e kanë njohur afër 100 shtete të botës.

ARGUMENTET E KOSOVËS PËR TA DENIGRUAR SERBINË

E vërteta është gjithsesi në anën e shqiptarëve. Megjithatë Kosova dhe blloku shqiptar duhet të jenë më energjik në pasqyrimin sistematik të çështjes së Kosovës, sepse bota nuk i ka përjetuar në lëkurën e saj mizoritë serbe dhe mbamendja e saj edhe mund të zbehet shpejt. Të pavërtetat e turpshme sistematike të Serbisë dhe Rusisë ndaj Kosovës, tregojnë qartë se sa është dashur dhe duhet të punohet ndërkombëtarisht për të treguar se si Serbia e vogël është futur në Kosovën e madhe.

Të shumta janë argumentet e Kosovës për të zezat, masakrat dhe tmerret gjenocidale që serbët i kanë bërë ndaj popullit shqiptar. Dëshmitë e pamohueshme historike flasin për gjenocidet e viteve 1878, 1912, 1944 dhe 1999.

Të dhënat historike të pakontestueshme flasin qartë se Serbia ka qenë shtet në miniaturë si sanxhak i Beogradit, dhe se zgjerimi i saj është bërë gjithnjë nëpërmjet okupimeve të trojeve të huaja me vrasje e djegie, e më së shumti të trojeve shqiptare. Këto të dhëna historike i dëshmon edhe Faksimilia e hartës së Enciklopedisë Ruse të vitit 1817, ku shihen qartë kufijtë realë të Serbisë në periudhën e viteve 1804, 1810, 1812, 1815, 1820, 1867 që janë shënuar në brendinë e kësaj harte. Kufijtë e sotëm të Serbisë ku janë përfshirë trojet shqiptare janë arritur vetëm nëpërmjet ekspeditave të përgjakshme serbe ndaj shqiptarëve.

Në fshatin S... të Kosovës jeton një nënë shqiptare, si edhe mijëra nëna tjera shqiptare zemërplagosura, shpirti i të cilës do të mbetet gjithnjë i trishtuar. Jo pse në luftën e padrejtë që imponuan serbët në Kosovë, ia vranë burrin, djalin, ia përdhunuan para syve vajzën e re, por i bënë edhe gjëmën më të madhe që s'do ta kishte bë as soji i bishave më të tërbuara. I nxorën me hanxhar syçkat e djaloshit tre vjeçar dhe ashtu të përgjakura e të ngrohta e detyruan me forcë që t'i gëlltisë. Këtë ia bënë serbët nënës së urtë e të ndershme shqiptare, si edhe mijëra nënave tjera, të cilat gjithnjë patën në zemër nderin, bujarinë e fisnikërinë, e të cilat asnjëherë nuk dijtn as të fyejnë e as të ngucin kënd. Hordhitë ushtarake, policore dhe paramilitare, dogjën e vranë, prenë koka fëmijësh dhe përdhunuan mijëra gra e vajza shqiptare dhe detyruan të shpërngulen më shumë se një milion e gjysmë shqiptarë nga Kosova.

Kemi apeluar disa herë, te Shqipëria, Kosova,Liga Shqiptaro - Amerikane, Lidhja Shqiptare në Botë, apo te biznesmenët shqiptarë, që ta financojnë përkthimin në gjuhë të huaja, botimin dhe shpërndarjen sa më parë nëpër botë të librave rrenqethës dhe tepër argumentues të autoreve kosovare që dhunën serbe ndaj femrave shqiptare e kanë përshkruar në libra.

Apeli ynë mbetet që Libri "Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë" i autores Luljeta Selimi dhe dy librat e tjerë të botuara rishtas po nga autoret kosovare, të përkthyera tu dërgohen sa më parë Ban Ki Munit- kryetarit të OKB-së diplomatëve në OKB dhe tërë lidershipit botëror. Secili që do t'i lexonte këto libra, do të rrënqethej kur do të kuptonte se çfarë krimesh kanë bërë serbët edhe ndaj femrave shqiptare në Kosovë. Kjo me siguri do të ndihmonte shumë që të kuptonin dhe ta forconin bindjen e tyre për të qenë në anën e shtetit të ri të Kosovës, në anën e të vërtetës, në anën e shqiptarëve.

Ja disa shembuj nga libri i Luljeta Selimit, " Ma pushkatuan nënën e vëllanë, kurse mua më dhunuan dhe trupin tim e masakruan për së gjalli me cigare". Një nga mjeket deklaron se, "Vajzës së dhunuar i ishte shqyer mitra dhe se në organet gjenitale i kishin futur rërë, këmbët i kishte të gërvishtura dhe mes dy gjinjëve me majën e thikës kishte të vizatuar kryqin serb". Ose rrëfimet e tjera," Fëmijët vajtonin mbi trupin e përgjakur të babait të tyre të vrarë, e mua më çnderonin vetëm disa metra larg tij"," Pasi ma vranë djalin, mua më çnderuan disa ditë me radhë", "Djalit dy vjeçar ia prenë veshin dhe tre gishtërinj, e pastaj më dhunuan", "Më dhunuan para syve të nënës", "Më dhunuan e ma prenë gjirin", "Cigaren e ndezur e fiki në gjinjtë e mi", "Me thikë shkruan fjalë mbi trupin tim, "Më detyronin t'i shiqoja femrat që po i dhunonin me radhë", "Pasi më dhunuan, m'i hoqën thonjtë me dana", "Motrën e mbytën me kundak të pushkës", "14 vjeçarja u dhunua në borë", "Pasi e dhunuan 13-vjeçaren e hudhën në pus", "Më çnderuan para syve të babait dhe nënës", "Në muajin e tetë të shtatzanisë më përdhunoi para vjehrrës dhe burrit, e pastaj më goditi në gjoks e në bark dhe linda fëminë e vdekur", " Më dhunuan dhe në krah ma vizatuan kryqin serb", "Pasi i çnderuan tri vajza, ua prenë organet gjenitale"....

Këto janë disa sekuenca të mizorive serbe gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë, duke mos harruar mijëra e mijëra të vrarët, djegiet, varrezat masive dhe afër 1800 të zhdukurit, për të kuptuar më mirë se çfarë mizorishë kanë kryer ata edhe në gjenocidet më të hershme ndaj shqiptarëve. Kështu është zgjeruar Serbia në dëm të territoreve shqiptare. Ministrat e diplomatët shqiptarë le t'i vazhdojnë takimet dhe lobimet për Kosovën, por gjithsesi gjatë takimeve nëpër botë është më se e domosdoshme që bashkëbiseduesve të tyre tu lënë edhe nga një libër të përkthyer të autoreve kosovare për dhunimet serbe në Kosovë. Kjo me siguri do të shërbente si argument i fuqishëm që të huajt t'i kuptojnë më së miri barbaritë e ushtrisë dhe policisë serbe ndaj popullatës së pafajshme shqiptare në Kosovë.

Nuk ka asnjë dokument historik që mund të dëshmojë se shqiptarët kanë okupuar qoftë edhe një metër të territorit të huaj. Përkundrazi serbët janë ata që kanë okupuar shumë troje shqiptare. Këto janë të vërtetat për tia mbyllur gojën Serbisë dhe për tua hapur sytë atyre që u besojnë gënjeshtrave serbe.

Serbia i ngjan një gjarpëri helmues, të cilit po nuk ia shtype mirë kokën, ai sërish ngjallet për të kafshuar.

portret

Besniku prej vitesh është bërë mësues i mësuesve, duke dalë si autor i katër librave metodikë për gjuhën shqipe dhe si bashkautor i një libri për teknikën e recitimit.

Arritje mbresëlënëse të mësuesit Besnik Rama

Nga **SHEMSI MANJANI***

Në mesin e viteve '70, pranimi i nxënësve në shkollat e mesme pedagogjike bëhej me konkurs. Mësues të këtyre shkollave vinin nëpër rrethe dhe përzgjidhnin nxënësit më të mirë, nga ata që konkurronin. Ishte fundi i korrikut 1975, kur tre mësues të shkollës së mesme pedagogjike "Luigj Gurakuqi" Elbasan erdhën në Peshkopi për të përzgjedhur katër nxënës nga rrethi ynë. Unë atëherë kryeja detyrën e shefit të arsimit dhe të kulturës. Në përfundim të konkursit, kryeinspektori më njoftoi se në krye të katër nxënësve të përzgjedhur, mes 20 konkurrentëve, ishte një djalë nga Radoveshi i Gollobordës. Dhashë porosi që të takoja prindin dhe djalin fitues, por më thanë se ai djalë kishte ardhur i pashoqëruar dhe ishte larguar menjëherë pas konkursit. Vite më pas, kur shërbeja si kryeredaktor i gazetës "Ushtima e maleve", më tërhiqnin vëmendjen shkrimet e mësuesit Besnik Rama, djali të cilin nuk arrita ta njoh në korrikun e vitit 1975. Artikujt që sillte ky mësues, ishin premtues, trajtonin tematika të ndryshme, shkruar me kulturë e nivel si prej profesionisti. Unë ndieja kënaqësi që gazeta jonë kishte një bashkëpunëtor si Besniku.


Në fakt, portreti i Besnikut spikati në fushën së cilës ai i ishte përkushtuar, në arsim. Unë ruajta njohjen dhe miqësinë me të dhe sot, nga pozitat e mësuesit pensionist, guxoj e shkruaj me krenari për këtë djalë dibran, që ka arritur të bëhet një intelektual me zë. Intelektuali Besnik Rama, me përkushtimin që e karakterizon, ka arritur të ngjisë shkallët e karrierës nga mësues e drejtor shkolle në zonën e Gollobordës, në specialist në Ministrinë e Arsimit e të Sportit, vetëm me vullnet, me punë serioze e profesionalizëm.

Gjithnjë kërkues ndaj vetes, Besniku ka rritur kompetencat e tij dhe prej vitesh është bërë mësues i mësuesve, duke dalë si autor i katër librave metodikë për gjuhën shqipe dhe si bashkautor i një libri për teknikën e recitimit.

Këto botime, librat "Maturant eja në ese..." dhe "Provimi i lirimit", si dhe mbi 20 artikuj pedagogjikë e psikosocialë të publikuar në organe qendrore, si "Revista pedagogjike", gazeta "Mësuesi", buletine të Institutit të Studimeve Pedagogjike (sot Instituti i Zhvillimit të Arsimit), e kanë bërë Besnikun të njohur në të gjitha mjediset shkollore të vendit, ndaj me të drejtë, mësuesit, kudo që i takon, e quajnë mikun e tyre.


Duke u marrë vazhdimisht me studime, Besniku ka thelluar punën e tij kërkimore shkencore dhe ka referuar në mbi 10 konferenca e seminare kombëtare e ndërkombëtare, duke pasur objekt hulumtimesh mësimdhënien e të nxënit në përgjithësi, atë të gjuhës shqipe e të letërsisë në veçanti, strategjitë, metodat e teknikat bashkëkohore, zhvillimin profesional të mësuesve, zhvillimin e kurrikulës dhe të mësimit në shkollat shqipe të mësimit plotësues në diasporë etj. Një përvojë më vete për Besnikun përbën puna mbi 10-vjeçare në Ministri të Arsimit. Duke marrë pjesë në trajnime, në komisione të ndryshme lëndore, në borde e grupe pune, ai ka dhënë ndihmesën e tij prej specialisti të kualifikuar.

Edhe për kaq sa përshkrova shkurtimisht, mendoj se do të përligjja shkrimin tim për Besnikun. Por kam një arsye më shumë që po paraqes para lexuesit studiuesin Besnik Rama, sepse kohët e fundit ai arriti të mbrojë gradën "Doktor i shkencave", duke u vlerësuar nga juria "Shumë mirë" (98 pikë). Studimi disavjeçar i Besnikut përbën një punim mbi 350 faqesh për mësimdhënien e gjuhës shqipe në një vështrim bashkëkohor. Punimi



Në foto: Besnik Rama në zyrën e punës

> Punimi është interesant dhe njëherësh i komplikuar, nëse pranojmë që kërkimi është bërë aty ku kryqëzohet mësimdhënia e përditshme e gjuhës amtare me politikat arsimore që projektojnë dhe mundësojnë cilësinë në zhvillimin e kësaj lënde disiplinore ...



Punimi i studiuesit B. Rama, një punim i realizuar me cilësi, me seriozitet, me kujdes dhe me kërkesa shkencore.

i studiuesit B. Rama, një punim i realizuar me cilësi, me seriozitet, me kujdes dhe me kërkesa shkencore, i shtohet fondit të punimeve të doktoratave me vlera dhe me prurje të arrira në gjuhësi.

Autori i punimit, me përvojë shumë të mirë shkencore, pedagogjike e botuese, në këtë punim është në një truall që e njeh mirë, është "në shtëpinë e tij". Studimi ka marrë përsipër të trajtojë, dhe trajton, një sërë problematikash me synimin kryesor për të evidentuar "zhvillimin historik e bashkëkohor të mësimit të gjuhës shqipe, traditat e përvojat më të mira në këtë fushë, si dhe hapësirat e mundësitë për ngritjen e nivelit të mësimdhënies duke synuar realizimin e kërkesave të sotme, në mënyrë që nxënësi të zotërojë kompetencat gjuhësore për të komunikuar e për t'u shprehur qartë, rrjedhshëm e bukur me gojë e me shkrin në shumëllojshmëri situatash e nevojash vetjake e më gjerë". Pasi përfundon së lexuari punimin e Besnikut, vëren me kënaqësi se ky synim është realizuar me sukses.

Punimi ka informacion të shumtë që vjen i përshkallëzuar, duke ndjekur përgjithësisht një renditje historike, të lidhur ngushtë me zhvillimet e shoqërisë shqiptare e të arsimit në Shqipëri, 150 vitet e fundit. Kjo ka mundësuar që të bëhen edhe përqasje, krahasime dhe ndjekje të zhvillimeve e të përmirësimeve nga pozita përgjithësimi, për të kaluar te vështrimi bashkëkohor i mësimdhënies së gjuhës shqipe.

Punimi, edhe pse përqendrohet apo organizohet rreth temës bosht "Mësimdhënia e gjuhës shqipe në një vështrim bashkëkohor", ka lëndë të shumëfishtë, madje enciklopedike për shumë zëra e fusha, qoftë kur shihen figura me peshë në historinë e arsimit e të shkollës shqipe, qoftë kur shihen ngjarje me peshë përcaktuese në historinë e kombit tonë, por edhe të gjuhës shqipe, lidhur pazgjidhshmërisht me procesin e përvetësimit e të nxënies së saj.

Bie dukshëm në sy që studiuesi ka punuar në dy pista njëherësh: si kërkues dhe si qytetar i dashuruar me objektin, përndryshe nuk do të kishte një objekt kaq të zgjeruar në kërkimin e vet.

Jashtë objektit të kërkimit nuk mbetet pothuajse asgjë, duke dashur të bëjë një përkim shterues, deri tek thekset specifike të programeve nga cikli në cikël dhe brenda ciklit, te metodologjitë që bëjnë të suksesshëm të nxënit e gjuhës shqipe, si kjo lëndë mund të nxisë dhe të ushqejë mendim dhe individualitet të pavarur te fëmijët.

Analiza e pasur përshkruese, krahasuese dhe vlerësuese është bazuar në shqyrtimin e 92 teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, në dhjetëra plane, programe mësimore, tekste didaktike, raporte vlerësimi kombëtare e ndërkombëtare, si dhe në mbi 150 teste provimesh lirimi e mature dhe ese etj.

Në studim trajtohen probleme të pashqyrtuara në këtë gjerësi e thellësi, si: qëllimi dhe synimet e mësimit të gjuhës shqipe ndër dhjetëvjeçarë (jo vetëm përvoja dhe dukuri të shkollës sonë, por dhe të vendeve fqinje e më gjerë), qasje vlerësuese për formimin gjuhësor të nxënësve përmes punëve me shkrim, zhvillimi i kurrikulës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit etj. Në të gjitha rastet nuk mungojnë qëndrimet dhe mendimet e autorit të studimit.

Një vështrim përmbledhës u është bërë të gjitha llojeve, formave dhe natyrave të punëve me shkrim, që nga hartimet e diktimet deri te punët me shkrim dhe eseja aq e vlerësuar kohët e fundit si niveli më i lartë i punës së pavarur me shkrim.

Një qasje vlerësuese e gjerë dhe e pasur i është bërë esesë në Maturën Shtetërore, për vetë peshën specifike që zë kjo lloj pune me shkrim në testin e provimit të detyruar "Gjuhë shqipe dhe letërsi". Analiza që u bëhet vendit dhe përmbajtjes së esesë në maturë, arritjeve dhe treguesve konkretë, që janë vjelë edhe në raporte zyrtare dhe përvoja të ndryshme nga vendi, rajoni, Europa e më gjerë, ka mundësuar konceptimin e disa përfundimeve me synim kapërcimin e mangësive që vërehen në punimet e nxënësve maturantë dhe në testet e provimit.

Studimi vlerëson kurrikulën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në kontekst bashkëkohor, duke u përqendruar në veçanti në konceptimet e reja për standardet, në sfidat e reformës "Altertekst" dhe në zhvillime në kuadër të kësaj reforme, në nevojën për ndryshime dhe në kërkesat për qasje e dukuri të reja.

Objekt studimi janë rezultate dhe arritje në prerje nivelesh: vlerësimi kombëtar i arritjeve të klasës IV fillore dhe i arritjeve në provimet e lirimit, përfaqësimi i Shqipërisë në PISA, Matura Shtetërore në vite etj.

Në studim i kushtohet një kapitull mësimit të gjuhës shqipe në diasporë, ku trajtohen: kurrikula e shkollave shqipe të mësimit plotësues, zhvillime aktuale dhe perspektiva, veçori të punës së mësuesit në klasat me fëmijë emigrantë etj., si dhe jepen udhëzime metodologjike.

Literatura e përdorur dhe burimet e informacionit janë pikë e fortë e studiuesit Besnik Rama, por më shumë se kaq, është aftësia e tij për të gjetur të veçantën dhe për të bërë analiza e përgjithësime.

Punimi është interesant dhe njëherësh i komplikuar, nëse pranojmë që kërkimi është bërë aty ku kryqëzohet mësimdhënia e përditshme e gjuhës amtare me politikat arsimore që projektojnë dhe mundësojnë cilësinë në zhvillimin e kësaj lënde disiplinore përcaktuese në formimin e përgjithshëm dhe individual të nxënësit.

Jam i sigurt se studiuesi Besnik Rama do të thellojë më tej arritjet e tij si hulumtues dhe specialist arsimi.

** Veteran i arsimit, Ish-mësues, drejtues shkollash dhe shef i seksionit të arsim-kulturës, Dibër*

Rruga e Arbërit

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

Redaksia.

Rruga e Arbërit nr. 91

botime

Ymer Keta, me librin "Heronjtë e nëntokës", vjen te lexuesi si një krijues i pjekur, me një stil të veçantë dhe identitet në të shkruar.

"Heronjtë e nëntokës", një histori vuajtjesh dhe sakrificash

Nga **QAZIM PREJSI**

Si një vullkan, në krijimtarinë e tij, autori Ymer Keta vjen para lexuesit me librin " Heronjtë e Nëntokës". Duke lexuar këtë libër, kushdo bindet se kemi të bëjmë me një krijues të suksesshëm, jo thjeshtë me një shkrues të zakonshëm. Ai përshkruan bukur e rrjedhimisht dhe artistikisht, me shumë pasion e dije, shtëpinë e minatorëve, ku ai ka kaluar një pjesë të jetës së tij.


Sapo mora në dorë librin "Heronjtë e nëntokës" s'më hiqej nga dora. Ky libër, ka kaq shumë emra, sa mbase asnjë libër tjetër ! Është si një kronikë heroike, ku nuk mund të mos përmendet nga minatori më i thjeshtë deri tek "gjenitë e minierave", që personazhet e këtij libri, u bënë miti i minierës, të ngjashëm tashmë me personazhet e letërsisë e të historisë.

I veshur me kostum minatori djaloshi bulqizak që sapo zbriti nga mali i bardhë (fshati Dushaj) u ngjit për të hyrë në galeritë e nëndheshme të Malit të Duriçit.

Libri i "Heronjëve të nëntokës" bën fjalë për legjenda të kohëve moderne dhe kjo ta përforcon idenë se miniera në vetvete është ende një epokë e pashkruar ; edhe për faktin se ishte sipërmarrja shqiptare më e madhe e shek. XX; edhe për atë se punëtoria shqiptare u krijua së pari në nëntokë, në Rubik, Selenicë, Alarup, Bulqizë, Kurbnesh e në shumë miniera të tjera; por dhe se vetëm në këtë vend, mesa dimë ka patur dhe miniera-burg apo burg-miniera si në Bulqizë, Batër, Spaç, Qafë-Bari e Tërnovë, ku përdorej një gjuhë eufemike, me"punëtorë të lire"dhe"punëtorë të detyruar",që atje thellë në zgafellat e nëntokës futeshin për të nxjerrë krom, bakër epirit, si dhe për t'u riedukuar .

Duke e pare minierën si një kaleidoskop, përmes ngjyrave dhe dritë-hijeve të saj, pasqyrave ku përthyhen reflekset e një bote nga më vitalet e këtij rruzulli, ku dinjiteti peshonte më shumë se gjithçka e ku kotësitë ishin të papranueshme, ne kuptojmë se ata njerëz që mësuan në teknikume dhe auditore universitare mjeshtrinë, artin dhe projektin e minierës, kishin një ëndërr që besonin fort, se ai mineral i thellësive të nëntokës, që ata kishin marrë për mision ta nxirrnin mbi tokë, do t'i bënte të pasur. Mirëpo miniera ia la prap legjendën e vjetër të mbijetesës, edhe pse u ndërtuan qyteza malesh prej saj, edhe pse pati një lëvizje dhe një qytetërim të caktuar.

Libri " Heronjtë e Nëntokës" është bota minatore në lëvizje, brenda dhe sipër tokës, me aq shumë humanizëm, ku njerëzit e nëntokës, këtu të humbasin dhe aty shfaqen përsëri, nëpër faqet e librit dhe nëpër zgafellat e nëntokës, në puse, galeri, traverbanke, dishenteri, nënkate, buzë shembjeve, në frontet e kërkimit e të prodhimit, me martelin emblematik në dorë fillimisht në kraharor pastaj në mbajtëse.



Ata minatorë që në vitin 1948, lanë Rubikun dhe iu drejtuan Malit të Duriçit i pasuan dhe mijëra të tjerë në 5-6 dekada. Prandaj dhe homazhi për të rënët është aq i thellë, dhënë përmes episodesh të qëmtuara me kujdes nga autori.

Autorit i është dashur të trajtojë në veprën e tij letrare aktivitetin e heronjve të shpallur e të pa shpallur, problematikat e vështira e të dhimbshme në punën e minatorit, zjarrmëtarit, minatorit, armatorit, shinashtruesit, brigadierit, teknikut, normistit dhe të inxhinierit, studime të cilat zakonisht bëhen me grup autorësh. Megjithatë autori ia ka dale me sukses, duke dhënë një galeri prej qindra personazhesh, në botën e tyre të brendshme, me psikologjinë dhe botën e tyre. Kjo vepër përfshin më shumë se kaq.

Është për t'u theksuar se autori për të realizuar objektivin e tij, ka rrëmuar në arkiva, edhe pse historiku i minierës dhe libri i aksidenteve është zhdukur, ka bërë të pa mundurën duke shkuar në të gjithë fshatrat e zonës së Dibrës e të Matit duke marrë kontakt me të afërmit e të rënëve, për të siguruar kohën e aksidentit, ndonjë foto, ku në raste të shkëputura ka vënë në libër dhe foto të kohës së shërbimit ushtarak. Veç sa sipër për t'i dhënë lexuesit një vepër sa me të larmishme e të bukur historiko-letrare, është treguar dhe një vëzhgues i pasionuar,

> Në memorien e lexuesit si në kaltërsinë qiellore llamburin lapidari i 11 heronjve në Minierën e Batrës, ku janë shkruar emrat: Avdyl Vërlaku, Dilaver e Neshit Rupla, Emin Përshaku, Munir Nurçia, Myslim Mazari, Hysen Toska, Skender Tomja, Subi Kadria e Shaban Hoxha.

ka hulumtuar e intervistuar dhjetëra ish minatorë, specialist të industrisë së kromit, si inxhinier,brigadier, drejtues të cilët janë pasqyruar mjaft mire në vepër duke i dhënë asaj refleksione dinamike të rralla.

Nuk mund t'i shpëtonte autorit puna e përkushtimi i drejtuesve, i specialistëve, ku edhe tekniku bëhet "inxhinier" me kualifikim e punë shumëvjeçare. Autori tregon kujdes edhe tek shpirti novator i punonjësve, që me punën e tyre ndihmuan prodhimin e kromit dhe evadimin e tij. Miniera e kromit u bë një shkollë e madhe dhe fidanishtja e ku furnizoi me kuadro e specialist të zot, shumë miniera që u hapën më pas.

Në të gjithë veprimtarinë e tij autori, nga faqja në faqe të këtij libri ndjehet përkushtimi i tij, pulsi i jetës, ritmika e prodhimit, si dhe pengesat e shkaqet e frenimit. Ai si gjithnjë, nuk nguron të fshikullojë me forcën e penës, të fjalës e të vargut, fenomenet negative, pengesat ,politikat e gabuara që kanë rënduar mbi minatorët e familjet e tyre. Edhe në këtë vepër, autori paraqitet si një publicist i aftë,që din të ndjekë dhe analizoje ngjarjet, situatat, dhe t'ia japë lexuesit me art e realizëm. Atij nuk i ka shpëtuar dhe gjendja e qytetit të bulqizës pas vitit 1991, kur sistemi i kaluar vajti në "muze" ndryshimi solli situata të rënda e tronditëse, atë çka do të thosha Bulqiza nuk e meritonte, këtë krizë. Ai qytet dikur dhuronte punë e jetë për të gjithë.

Autori flet me nota realiste, flet për risitë. Ne na takon të jemi vlerësues e jo mohues e cmirëzinj. Ai në këtë vepër prezantohet një intelektual i mirëkompletuar me vizion të qartë, si luftëtar i fjalës së lirë. Këtë e ka treguar edhe në qëndrimin e tij në punë, por edhe në idetë e tij në veprat letrare. Midis konformistit dhe luftëtarit për të vërtetën, zgjodhi këtë të dytën, duke dhënë shembullin e tij dhe për intelektualët e tjerë. Ymer Keta i takon brezit të intelektualëve të viteve 1960-1990. Me punë e sakrifica si krijues, e ka justifikuar veten si i suksesshëm.

Në këtë vepër pasqyrohen ngjarje të shumta, porse ai, ka ditur të përzgjedhë ata më tipiket, më mbresëlenësët, më rrënqethset e më frymëzueset. Kështu ai ndalet në mënyrë të veçantë në dy nga ngjarjet më tronditëse që ndodhën në ekipin gjeologjik të Batrës ku 11 persona humbën jetën nga orteku i borës, si dhe në "tragjedinë njerëzore" fund Janarin e vitit 1979 ku humbën jatën 9 minatorë nga radhët e atyre që vuanin dënimin në Zonën "D" të Minierës Bulqizë.

Gjithashtu përshkruan dhe sakrificat e kolektivit ushtarak në Repartin 301 Bulqizë,për të shpëtuar të dënuarit, ku nën drejtimin e Komandantit të repartit Mark Zefi e të kolektivit oficer të këtij reparti si Jonuz Llorja, Abdulla Dërvishi e shumë të tjerë, apo të dënuarit Aqif Buci, që bënë të pamundurën për shpëtimin e jetëve të dënuarve që punonin në galeritë e asaj miniere atë ditë në turnin e parë. Ishte një ndodhi e veçantë që të dënuarit që ndërruan jetë në atë incident, u varrosën me nderime e respekt në varrezat publike të qytetit Bulqizë, të shoqëruar nga familjarët e të afërmit e tyre si dhe ish minatorë e banorë të qytetit Bulqizë. Me inicimin e Komandantit të këtij reparti, disa të dënuarve u ul masa e dënimit, ku u liruan para kohe. Janë këto ngjarje më tronditëse, por dhe më kuptimplote përsa i përket humanizmit dhe solidaritetit si dhe një prozhektor i pa shuar në jetë të jetëve që ndodhën në minierat e Kromit Bulqizë e Batër,që do frymëzojnë gjeneratat e reja të Shqipërisë për shpirt sakrifice,përkushtim dhe obligim për progresin e Shqipërisë dhe begatinë e popullit shqiptarë.

Në memorien e lexuesit si në kaltërsinë qiellore llamburin lapidari i 11 heronjve në Minierën e Batrës, ku janë shkruar emrat: Avdyl Vërlaku, Dilaver e Neshit Rupla, Emin Përshaku, Munir Nurçia, Myslim Mazari, Hysen Toska, Skender Tomja, Subi Kadria e Shaban Hoxha. Këtu autori ndalon dhe përshkruan me detaje të holla dhe për repartet e riedukimit për burgun e Bulqizës e të Batrës, për këtë "ferr të heshtur".

Autori shpjegon se njeriu me mendje të kthjellët në vend që të shkrihej e të tretej në ato mijëra njerëz që vuanin dënimin në këto burgje, rrëshqiste neveritshëm mendimi: nën parullën e sigurisë e jo të ngrinte flamurin e paqes e të mirësisë, ngrinte masën e ndëshkimit, arrinin deri aty sa të qëllonin mbi ta pa paralajmërim.." gjoja se po zbatonin rregulloret ushtarake, harronin se dhe ata ishin shqiptarë..." Ata të dënuar për krime të ndryshme donin vetëm një gjë: "... të rehatonin gjymtyrët e lodhura në ato fjetore të akullta gjatë dimrit dhe mbyste nga vapa e nxehtë gjatë verës.

Prof.dr. Artan Fuga, mbështetje të fuqishme për Rrugën e Arbrit

(Vijon nga faqja 1)

Inicuesi i peticionit, Dr. Gëzim Alpion, tha për gazetën Rruga e Arbërit se tani jemi në fund të fazës së parë përmbyllëse, atë të dorëzimit të peticionit te qeveria shqiptare, por peticioni nuk do të mbarojë deri sa të ndërtohet edhe metri i fundit.

"Ne do të përcjellim te organet vendimmarrëse vendosmërinë tonë si anëtarë aktivë të shoqërisë civile për të ndjekur me rigorozitetprogresin e Qeverisë për të mbajtur premtimin elektoral për ndërtimin e Rrugës së Arbrit si dhe menaxhimin me efikasitet të fondeve që do të akordojë Qeveria për këtë projekt, në mënyrë që ato të mos keqmenaxhohen, siç ka ndodhur deri më tani me këtë projekt", thotë Alpion.

> "Ne do të përcjellim te organet vendimmarrëse vendosmërinë tonë si anëtarë aktivë të shoqërisë civile për të ndjekur me rigorozitetprogresin e Qeverisë për të mbajtur premtimin elektoral për ndërtimin e Rrugës së Arbrit si dhe menaxhimin me efikasitet të fondeve që do të akordojë Qeveria për këtë projekt, në mënyrë që ato të mos keqmenaxhohen, siç ka ndodhur deri më tani me këtë projekt"

Në takimet me qeverinë dhe organet e tjera vendimmarrëse, si dhe në bisedat që do të realizojmë me ente mediatike në Tiranë dhe jashtë Shqipërisë, ne do kërkojmë de-politizimin e çështjes së ndërtimin të Rrugës së Arbrit, në mënyrë që theksi të vihet në rëndësinë e këtij projekti në planin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Ne kemi ndjekur me interes prononcimet që Kryeministri i Shqipërisë dhe drejtues të tjerë të mazhorancës, si gjatë edhe pas zgjedhjeve të qershorit, kanë bërë në lidhje me rëndësinë strategjike që ndërtimi i Rrugës ka për ekonominë e vendit dhe përmirësimin e infrastrukturës midis Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës dhe Bullgarisë, duke mundësuar integrimin e mëtejshëm të kësaj pjese të Ballkanit në Evropë."

Ne do ta shfrytëzojmë takimin me kryeministrin e Shqipërisë, thotë Alpion, si rast të shkëlqyer për një dialog konstruktiv mes qeverisë dhe përfaqësuesve të intelektualëve dibranë. Në takim ne do të kemi mundësinë të diskutojmë edhe mbi disa çështje që lidhen me ecurinë e deritanishme të punimeve, si dhe me problematikën e shfaqur.

"Asnjë nga intelektualët dibranë që do të marrin pjesë në takimin me kryeministrin e Shqipërisë nuk ka angazhim politik, nuk përfaqëson ndonjë parti politike dhe nuk synojnë të bëhen pjesë e asnjë agjende politike. Ata do të çojnë zërin e Dibrës dhe dibranëve të thjeshtë në qeveri", thotë Alpion për gazetën "Rruga e Arbërit".

Korresp. Rr.A.

135 vjet më parë

Kuvendet e Dibrës në themelet e Autonomisë

Nga **ZABIT LLESHI**

Mbarimi i luftës Ruso – Turke (1877 – 1888) me traktatin e Shën Stefanit tregoi se perandoria Osmane nuk ishte më e aftë të ruante kufijtë e Shqipërisë që shtriheshin në periferinë e saj. Sipas marrëveshjes Rusia i shkëputse Turqisë 350 mijë km2 , në Ballkan 280 mijë km2, shtohej një shtet i ri, Bullgaria, nga deti i zi deri në Voskopojë, e luginën e Drinit në Dibër (Dibër e Epërme, e Poshtme, Gollobordë, deri tek ura e Çerenecit). Serbia merrte një pjesë të Kosovës, ndërsa Mali i Zi Shqipërinë veriore. Rusia nëpërmjet "Bullgarisë së Madhe" përpiqej të realizonte hegjemoninë e saj në gadishullin e Ballkanit.


Abdyl Frashëri do të shkruante se "Cari nuk do të ndalej vetëm me këtë copëtim të trojeve Shqiptare" 1. Shqipëria tashmë e copëtuar kalonte nga zgjedha Turke në një zgjedhë tjetër të re akoma më të egër, prandaj filloi një lëvizje e gjerë proteste në të gjitha trevat Shqiptare duke përfshirë edhe Dibrën që padyshim ishte një shprehje e zemërimit të thellë të masave popullore për këto padrejtësi në dëm të kombit Shqiptar, që i bënin qarqet shoviniste të Ballkanit me ndihmën e Fuqive të Mëdha. Zemërimi i Dibranëve u shpreh qartazi edhe në memorandumin drejtuar fuqive të mëdha, nga ku kundërshtohej me forcë vendimi i Shën Stefanit dhe merrej angazhim se do të mbrohej me çdo kusht çdo pëllëmbë tokë Shqiptare.

Krijimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me 10 qershor 1878, pjesëmarrja, diskutimet, Programet e vendimet ngjallën optimizëm dhe shpresë në mbrojtje të çështjes Shqiptare. Përfaqësuesit e Dibrës mbështetën fuqimisht Abdyl Frashërin i cili do të krijonte lidhje e bashkëpunim duke e kthyer Dibrën në një nga trevat më të rëndësishme të zbatimit të vendimeve të Lidhjes së Prizrenit e të çështjes kombëtare.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit shënoi një hop cilësor në lëvizjen kombëtare të popullit Shqiptar. Ajo i dha impulse të reja luftës kundër perandorisë Osmane, "në të gjitha drejtimet duke i dhënë lëvizjes në Dibër një karakter më të organizuar, më kompakt e më masiv, me detyra e objektiva më të qarta" 2.

Më 13 qershor 1878 tre ditë pas formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u mblodh në Berlin të Gjermanisë, kongresi i Berlinit. Ai mori në shqyrtim marrëveshjen e paqes midis Rusisë dhe Perandorisë Osmane. Monarkitë Ballkanike: Rumania, Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria kërkuan nga fuqitë e mëdha pretendimet territoriale ndaj tokave të banuara nga Shqiptarët. Kryeministri Serb Ristiç "kërkonte ndër të tjera edhe krahinën e Kosovës e cila ndonëse banohej në shumicën dërmuese nga Shqiptarët ishte sipas tij e mbushur me "Kujtime historike serbe" 3. Mali i Zi kërkonte Shkodrën dhe vise të tjera të Shqipërisë së Veriut. Greqia nëpërmjet ministrit të saj të jashtëm Delijanis paraqiti në kongresin e Berlinit kërkesën që përveç Kretës, Thesalisë dhe Maqedonisë jugore të merrte Epirin deri në lumenjtë Vjosë e Aliakmon duke përfshirë Vlorën, Tepelenën, Përmetin e Konicën. Territoret Shqiptare po rrezikoheshin prandaj detyre e ngutshme e Lidhjes së Prizërenit ishte mbrojtja e atdheut të bashkuar. Komitetit Qendror i Lidhjes më 5 gusht 1878 mori disa vendime:

- Të bashkohen të gjitha forcat e degëve të Lidhjes së Manastirit, Dibrës, Prizrenit për të formuar "Komitetin e Mbrojtjes së Atdheut që do të Komandonte forcat e bashkuara për mbrojtjen e viseve të Shqipërisë gjeopolitike në të gjithë hapsirën e kufirit Shqiptar" 4. Nën udhëheqjen e Iljaz Pashës, dibranët iu





Vendimet e kuvendit të Dibrës (1 nëntorit 1878) në jug të Shqipërisë u pritën kudo me entuziazëm dhe masat e popullsisë u treguan të gatshme bashkë me kryetarët e degëve të lidhjes për të nënshkruar mandatet e përfaqësimit të delegateve, i shkruante Abdyl Frashëri, Iljaz Pashë Dibrës.

bashkuan thirrjes së lidhjes të gatshëm të shkojnë vullnetarë sipas nevojave që do të paraqiteshin.

Janë të njohura heroizmat e Dibranëve në mbrojtje të Nishit, Gjakovës, Plavës e Gucisë, Hotit e Grudës gjë që shqetësoi fuqitë e mëdha dhe monarkitë Ballkanike të cilat nga njëra anë kërkonin dobësimin e Perandorisë Osmane nga ana tjetër kërkonin zbatimin e traktatit të kongresit të Berlinit prej Perandorisë Osmane.

Shumë kuvende ka organizuar Dibra në mbështetje të Lidhjes, si ai i Qernanicës (korrik 1878, 14 tetor 1878, 20 tetor 1878) që i paraprinë 1 nëntorit 1878, rezuluta e të cilit shënon pikën kulmore të luftës për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë. Këto ngjarje sollën në vëmëndje Dibrën, ajo jo vetëm që u bë problem Ballkanik dhe Europian por jehona e saj i kaloi kufijtë e Shqipërisë duke u bërë një pengesë serioze në realizimin e vendimeve të kongresit të Berlinit.

Dibra i hapi horizonte të reja Lidhjes. Vetë ideologu i saj Abdyl Frashëri u paraprinte ngjarjeve me udhëzime në shtyp, nëpërmjet deklaratave orjentimeve, tubimeve etj.

Më 14 tetor 1878 krerët e qytetit, malësisë dhe fushës së Dibrës të udhëhequr nga Iljaz Pasha, Hasan Zajmi, Ismail Markja, Hysen Kuçi, Hasan Moglica, Sheh Sula, Sheh Rexhepi (I Vleshës), Ahmet Karasani, Isuf Doda, Bajram Buci, Seit Daci, Halil Cami, Xhemal Qoku, Mustafa (Tush) Lleshi etj, u mbodhën në kuvendin e Dibrës për të shprehur vullnetin dhe forcuar unitetin për kundërshtimet ndaj vendimeve të kongresit të Berlinit. Konkretizimi i kësaj rezolute filloi me largimin e Mytesarifit nga qyteti i Dibrës së Madhe, si dhe u vendos zbatimi i menjëhershëm i të gjitha detyrave që shtroi Kuvendi i 14 Tetorit. Rezuluta ishte sintezë e platformës së Abdyl Frashërit parshtruar në artikullin e gazetës "Terkuman-i Sark" (Datë 28 shtator 1878) 5 dhe konkretisht:

1. Të bashkohen të gjitha viset Shqiptare në një vilajet,
2. Të gjithë nënpunësit e këtij vilajeti të dinë gjuhën shqipe,
3. Të përhapet arsimi dhe shkolla ku të mësohet gjuha Shqipe,
4. Të përmirësohet gjëndja e brëndëshme e vilajetit me reforma që duhet të miratohen nga kuvendi i përgjithshëm i vilajetit,
5. Të caktohet një sasi e buxhetit e cila të përdoret për arsim dhe vepra publike.

Shqiptarët "edhe pse nuk donin ende të shkëputeshin nga perandoria Osmane nuk ishin larg për ti dhënë Shqipërisë një autonomi të plotë në ato masë që kongresi i Berlinit i dha Bullgarisë"6. Abdyl Frashëri në tetor të vitit 1878 erdhi në Dibër, në Bllacë dhe bisedoi me Isuf Tashën e Hysen Skarrën, në Zerqan me Sheh Sulën, në kuvendin e Shupënzës më 28 tetor 1878 shtroi problemin e mobilizimit dhe përgjigjes me luftë jo vetëm portës së lartë por edhe vendimeve skllavëruese të kongresit të Berlinit; Të bëjmë edhe përpjekje për të mësuar dhe të hapen shkolla Shqipe. Mustafa (Tush) Lleshi mbështeti Abdyl Frashërin në emër të malësorëve për hapjen e shkollave Shqipe dhe forcimmin e rradhëve të lidhjes për Dibrën. Të njëjtën mbështetje mori edhe nga Sheh Sula, Sheh Rexhepi (I Vleshës), etj. Natyrisht Abdyl Frashëri në këto kuvende e takime sqaroi mjaft elementë ndër to dhe patriotë që në ndonjë rast shfaqnin edhe nostalgji për perandorinë Osmane, hezitimit që shfaqej për shkollat Shqipe pasojë e sundimit 5 shekullor të perandorisë Osmane.

Më 31 tetor 1878 komiteti ndërkrahinor i lidhjes Shqiptare për vilajetin e Janinës miratoi rezulutën me përmbajtje të njëjtë me atë të Dibrës të 14 tetorit 1878, sepse të dyja ishin frymëzuar nga i njëjti burim, platforma e Komitetit Qendror të Stambollit botuar më 28 shtator në Terkuman-i Sark.

Kuvendi tjetër i Dibrës mbledhur më 1 nëntor 1878 i cili miratoi rezulutën e Dibrës (14 tetor 1878) dhe Janinës (31 tetor 1878) është një ngjarje me rëndësi kombëtare për vendimet që mori. Si përfaqësues i lidhjes për jugun (Toskërinë) ishte vetë Abdyl Frashëri, ndërsa për veriun Iljaz Pashë Dibra. Kërkesat që shtronin rezolutat pasi të miratoheshin nga përfaqësuesit më të denjë të popullit (degët e lidhjes) brënda muajit, 8 përfaqesues nga veriu dhe 6 nga jugu ti doreëzoheshin Portës së Lartë në Stamboll.

Vendimet e kuvendit të Dibrës (1 nëntorit 1878) në jug të Shqipërisë u pritën kudo me entusiazëm dhe masat e popullsisë u treguan të gatshme bashkë me kryetarët e degëve të lidhjes për të nënshkruar mandatet e përfaqësimit të delegateve, i shkruante Abdyl Frashëri, Iljaz Pashë Dibrës. Mision më të vështirë pati Iljaz Pashë Dibra sepse ju desh më shumë kohë (dy muaj) të thyejë rezistencën e Mustafa Pashë Tetovës, pjesmarrjen e të cilit në delagacionin e lidhjes Shqiptare e quante të domosdoshme. Në fund të janarit kur gjithçka ishte gati doli më urgjente mbrojtja e çështjes së Çamërisë e cila ishte në rrezik të aneksohej nga Greqia.

Kuvendet e tetorit 1878 që dolën me rezolutat e Dibrës dhe atë të Janinës patën rëndësi dhe hynë në histori si lëvizje mbarë kombëtare. Ato hodhën themelet për autonominë. Luftën e lidhjes dhe vetë platformën e saj u detyruan ta njohin fuqitë e mëdha dhe vetë Porta e Lartë. Zhvillimi i ngjarjeve në Dibër dhe në viset e tjera shtynë për dy vjet zbatimin e vendimeve të kongresit të Berlinit si dhe detyroi Perandorinë Osmane të mendonte fillimisht për tu dhënë autonominë vilajeteve veç e veç por që nuk u pranua nga udhëheqësit e lidhjes Shqiptare.

1.Abdyl Frashëri "Messager de Viene" Nr: 17, Vienë 26 prill 1878 fq 4
2. Xhelal Gjeçovi "Dibra dhe Dibranët, fq 217
3. Kristo Frashëri "Lidhja Shqiptare e Prizrenit" fq 24
4. Mehmet Pirraku "Mydeniz Imer Prizreni" Prishtinë 2002, fq 93
5. Abdyl Frashëri "Tercuman-i Sark" Nr:148 Istambul 27 shtator 1878
6.Abdyl Frashëri "Messager de Viene", Vienë 24 tetor 1878

Rruga e Arbërit nr. 91

studim

Kontributi i çidhnakëve për pavarësi

(Vijon nga numri i kaluar)

Kënga: -
Hasan Shini si t'ja bëjmë
N'kulla t'maja do luftojm.

Pas ketyre luftimeve fshati Brest i Eper u perfshi si pjese Etno-kulturore ne Krahinen e Cidhnës.

Më 1877 filloi lufta ruso-turke. Turqisë si humbëse ju imponua traktati i Shën Stefanit, sipas të cilit Shqipëria veriore e verilindore, copëtohej midis Serbisë, Malit të Zi e Bullgarisë.

Për merita në luftën ruso-turke Iljas Qoku (Dibra) mori titullin Pashë dhe u bë anëtar i Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të drejtave kombëtare" që u formua në Stamboll në dhjetor 1877.

Për kundërshtimin e traktati të Shën Stefanit, nën drejtimin e Iljas Pashë Qokut, në prill 1878 u mblodh Kuvendi i Dibrës.

Në korrik 1878 u mbajt Kuvendi i Prizrenit dhe u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit me kryetar Iljas Pashë Qokun.

Në korrik 1878 dibranet u mblodhen në fushën e Qernanicës dhe u solidarizuan me kuvendin e Prizrenit ku merrte pjesë edhe Abdyl Frashëri.

3000 vullnetarë dibranë morën pjesë në ushtrinë e Lidhjes. Nga dibranët më 14 tetor 1878 u miratua një rezolutë e hartuar mbi parimet e programit të Komitetit të Stambollit në formen e 5 pikave:

1) Viset shqiptare të bashkohen në 1 (vilajet)
2) Nënpunësit të dijnë gjuhën shqipe
3) Të mësohet në shkolla gjuha shqipe
4) Të caktohet një buxhet për arsimin dhe punët botore në vend.
5) Reformat të ushtrohen nga kuvendi i përgjithshëm i vilajetit.

Nga Çidhna nënshkruan Llan Kaloshi, Zenel Bitri.

Më 20 tetor 1880 u hap Kongresi i Dibrës me 300 delegatë të shoqëruar nga 5000 veta. Përfaqësoheshin shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë e Dibrës, midis tyre 7 pashallarë shqiptarë. Më të shquarit ishin Ali Pash Gucia, Esat Pash Dërralla dhe Abdyl Frashëri që përfaqësonte Janinën si deputet.

Kuvendi miratoi 2 rezoluta, krahu i moderuar me 150 vota, dhe krahu radikal 120 vota ku bënin pjesë (Iljas pashë Dibra, Abdyl Frashëri, Ali Pashë Gucia, Omer Prizreni, Sulejman Vokshi, Esat Pashë Dërralla).

Janar 1881 Radikalët morën vendimin për të zbatuar në mënyrë revolucionare krijimin e Vilajetit autonom shqiptar, qendra e lidhjes kaloi përsëri në Prizren.

U krijua qeveria e përkohshme me kryetar Ymer Prizrenin.

- Abdyl Frashëri – Ministër i Jashtëm
- Sulejman Vokshi – Ministër i Mbrojtjes

Abdyl Frashëri u nis për në Dibër për të përhapur flakën e revolucionit por gjeti mbështetje vetëm në Dibrën e Poshtme, ndërsa në Dibër të Epërme nuk u përkrah, madje ju bë dhe një atentat pa sukses, dhe më pas u përcoll nga një mori qytetarësh për në Mat.

Porta e lartë dërgoi ushtrinë e Dervish Pashës i cili hyri në Prizren më 22 prill 1881. Qeveria e Lidhjes u shpërbë.

Lufta për shkrimin shqip në Dibër u bë së pari nga Seid Najdeni (Hoxhë Voka) i diplomuar në merdrese në Stamboll (1893), nxënës i flaktë i Naimit dhe Samiut (1894), idealist dhe bashkëpunëtor i Ismail Qemalit.

Ndihmohej nga Josif Bageri që banonte në Sofje, dhe e furnizonte Seidin me libra.

Më 1895 hapin në Shehër një shkollë të fshehtë shqipe.

Më 1897, Komiteti i Stambollit i frymëzuar nga Sami Frashëri shpalli programin autonomist duke kërkuar përtëritjen e Lidhjes së Prizrenit.

Për të kundërshtuar synimet bullgare për Dibrën formohen çetat e Tahir Tolës, Bilal Ballancës etj. dhe dibranet zhvilluan luftime të përgjakshme.



Anëtarë të shoqatës në kalanë e Krujës

- Më 27 shkurt 1899 – Mblidhet Kuvendi i Madh i Dibrës, vendimet qenë më të avancuara se ato të Pejës, nga Çidhna firmëtar i kuvendit ishte Hasan Kaloshi.
- Gazeta "Drita" e Manastirit 26 janar 1912 i përgëzonte dibranët për këtë rezistencë patriotike.
- Më 19 gusht arriti në Dibër telegrami i Hasan Prishtinës që njoftonte se kërkesat e shqiptarëve ishin pranuar nga Stambolli kryengritësit të kthehen në shtëpitë e tyre.

Më 23 janar 1899 formohet me kërkesën e Haxhi Zekës – Lidhja e Pejës.

Më 27 shkurt 1899 – Mblidhet Kuvendi i Madh i Dibrës, vendimet qenë më të avancuara se ato të Pejës, nga Çidhna firmëtar i kuvendit ishte Hasan Kaloshi. Kujtojme me kete raste edhe shprehjen lapidare të patriotit me emër Llan Kaloshi i cili mbi kalin e bardhë ne moshen 100 vjeçare merr pjesë si komandant në luftën e Shkodrës, kur e liruan nga burgu me urdhër të Sulltanit i detyruar nga pengmarrja e 2 klerikeve ortodoks prej djalit të tij Hasan Kaloshi, i thanë të thoshte rroftë Sulltani. Ai u u pergjigj: "Rroftë Hasani, se për Sulltanin unë do kalbesha në burg".

Në kuvend u zgjodh edhe Komiteti i Beslidhjes që u vesh në funksione pushteti dhe vuri në dispozicion të Pejës 15000 veta, që të vareshin nga Peja e jo nga Stambolli, dhe 30-50% e taksave t'i paguheshin komitetit. U vendos gjithashtu edhe hapja e 5 (pese) shkollave shqipe nga vetë dibranët.

Ngritja e lëvizjes për autonomi në Dibër 1899 , përkoj me botimin e traktatit politik të Sami Frashërit "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?" që doli në mars 1899.

23 korrik 1909 mblidhet në Dibër një Kongres që njihet si kongresi xhonturk, por vendimet që u morën aty nuk u përputhën me interesat politike xhonturke , ai dështoi nga qëndrimi i patriotëve dibran.

Dibranët kërkuan alfabetin kombëtar latin jo alfabetin arab.

Selman Alia shkon në ndihmë të Kosovës, kundër ushtrisë së Xhavit Pashës.

Në pranverën 1910 dibranët mblidhen 2000 vetë të armatosur në Kuvend te Gjurra e Maxhicës nga Malet dhe Topalltia. Kërkuan arsimin shqip dhe rrëmbyen armët kundër Shefqet Turgut Pashës.

U ngarkuan Josif Karasani, Baftjar Doda dhe Selman Alia , tre krerët e Dibrës së Poshtme që të hynin në lidhje me udhëheqjen e Kosovës për rezistencë të përbashkët.

U nisën menjëherë në Lumë ku lidhën besën me parin e Lumës, dhe kur arritën në Kosovë ekspedita turke kishte filluar. Takimi u bë në Kaçanik, por filluan menjëherë luftimet në të cilat edhe delegatët dibranë morën pjesë në luftimet e zhvilluara në Kaçanik, Çernaleve... dhe Ferizaj. Ekspedita turke ju drejtua Shkodrës, Elbasanit, Lumës dhe Dibrës.

16 qershor 1910 ushtria turke pas luftërash të rrepta në Lumë, Dardhë, Çidhën, Peshkopi etj. Me pas hyri në Shehër, Bastisën vendin dhe mbyllën shkollat.

Shefqet Dergut Pasha erdhi vetë në Dibër dhe i kërcënoi krerët e maleve. Ndërsa Avdi Ndreu, Aziz Xheka etj., u dorëzuan.

Haziz Xheka dhe Sulë Alija u varën, të tjerët u torturuan dhe u internuan në Manastir.

U vendosën pas luftimesh disa karakolle, në Zerqan, Ostren, Homesh, Arras e gjetkë. Por malet as nuk paguan taksa, as nuk u çarmatosën, as nuk dhanë nizamë. Ata qëndruan në male me armë në dorë. Në verën e vitit 1910 sipas gazetës "Shqipëria" kishte në malet e Dibrës më shumë se 2000 luftetar maleve! (Shqipëria, Stamboll, 25 vjeshtë e parë 1910, K. Frashëri. "Historia e Dibrës", f. 327).

Në fund të vitit 1911 patriotët e Dibrës i përsëriten me një forcë akoma më të madhe kërkesat e tyre ndaj Portës. Qeveria turke dërgoi në janar 1912 inspektorin e arsimit Hamdi Beun, për t'i bindur për shkollat turke dibranët. Por dibranët rreth 500 vetë të mbledhur u shprehën në mënyrë kategorike për shkollat e shkrimin shqip me alfabetin latin.

Gazeta "Drita" e Manastirit 26 janar 1912 i përgëzonte dibranët për këtë rezistencë patriotike.

Për të shtypur qëndrimin e dibranëve qeveria Stambollit liroi nga burgu Elez Isufin dhe Selman Alinë, të cilët kaluan menjëherë në arrati duke qëndruar në male, ku nën kryesinë e Selman Alisë meqënse SELMANI ishte më me emër për kohën, dhe me mbështetjen e Elez Isufit u përgatit kryengritja e Arrasit kundër turqve, e cila filloi më 26-27 mars 1912. Ky qe edhe fillimi i vertet i kryengritjes së përgjithshme kundër Turqeve me 1912, e jo ne KOSOVE sic thuhet deri tani ne historiografin shqiptare, por në krahinen e Cidhnës ne fshatin ARRAS te DIBRES se Poshteme, udhehequr nga biri i ÇIDHNES patrioti i shquar SELMAN ALIA. Historia përsëritet, jo rastësisht edhe kryengritja e përgjithshme do fillonte atje ku rezisteca kundër pushtuseve turq kishte vazhduar thuajse pa nderprerje, edhe pas vdekjes se trimit dhe birit te saj legjendar Skëndërbeu. Në vendlindjen e Gjergj Kastriotit ishte mbajtur e gjalle ndër breza fryma e lirisë.

Me 26 Mars nga kryengritësit nëpërmjet oficerit Shaban Lusha ju dërgua ultimatumi turqve që ndodheshin në Karakoll, në Çukun e Lushës, të largohen nga territori i maleve brenda 24 orëve. Komandanti turk i alarmuar, pas largimit të Shaban Lushës jo më shumë se 100m nga garnizoni, qëllon në befasi e pabesi mbi Shaban Lushën, i cili u shpëtoi plumbave. Kjo mjaftoi për fillimin e kryengritjes, e cila u zhvillua e rrufeshme dhe shumë e ashpër me forcat turke, pati mjaft të vrarë e të plagosur. Turqit u detyruan të largohen nga territori i maleve të Çidhnës, Dardhës e Reçit që me dt. 27 shkurt 1912, për të mos u kthyen më në këto zona. Kryengritja u përhap edhe në malet e tjera të Dibrës e më pas edhe në Kosovë.

Në maj 1912 Komitetit Nacional i Dibrës, formoi çetat kryengritëse gati në gjithë Dibrën. Në Çidhën, (Selman Alia) dhe krerët e tjerë në malet e tjera. Me kryengritje spastruan gjatë qershorit nga karakollet e xhandarmërisë gjithë viset në perëndim të Drinit, më 18 korrik çlirohet Peshkopia, ndërsa më 22 korrik, kosovarët çlirojnë Prishtinën. Një delegacion i patrioteve Dibran, i dalë nga Kuvendi i madh që u mblodh në fund të korrikut tek Plepi i Egër (Maqellarë), u nis për në KOSOVE për bisedimet shqiptaro-turke. Më 6 gusht u takuan në Ferizaj me Hasan Prishtinën, Bajram Currin e Isa Boletinin etj. Meqë bisedimet kishin dështuar, ata morën pjesë në luftimet për çlirimin e Shkupit më 12 gusht 1912.

Qeveria turke kërkoj rifillimin e bisedimeve që përfunduan me 18 gusht 1912, me marrëveshjen e nënshkruar me kryengritësit.

Më 19 gusht arriti në Dibër telegrami i Hasan Prishtinës që njoftonte se kërkesat e shqiptarëve ishin pranuar nga Stambolli kryengritësit të kthehen në shtëpitë e tyre.

Pas 2 muajsh, më 8 tetor 1912, Mali i Zi i shpalli luftë Turqisë më 18 tetor fillohej lufta Ballkanike me hyrjen në luftë edhe të Serbisë e Bullgarisë si aleate, një vit më vonë fillon luftën edhe Greqia.

Ushtria turke u thye, shtetet ballkanike deklarojnë hapur qëllimet e tyre për copëtimin e tokave shqiptare.

Më 19 nëntor 1912 ushtritë serbe sulmuan Dibrën në Kolosjan, që përfundoi me fitoren e malësorëve. Ne luftimet e ashpra që u zhvilluan me forcat Serbe morën pjesë edhe forcat e udhëhequra nga Elez Isufi me Rec e Dardhe dhe shumë luftetar Çidhnak nga fshatrat e zonës fushore të cilat u kthyen nga Mati për në Kolosjan, duke u shkëputur keshtu nga forcat e tjera dibrane që po shkonin në ndihmë të Shkodrës.

Më 20 nëntor dibranët caktuan delegat për kuvendin e Vlorës Haxhi Vehbi Dibrën (Agollin) ndërsa Dibra e Poshtme caktoi Sherif Longun, ndërsa Dibra e Epër Dervish Himën, kurse nga Ohri u caktua Hamdi Ohri (Qoku) djali i Iljas Pashë Qokut.

Mbi 2000 burra të armatosur nga krahina e Çidhnës nën komandën e Selman Alisë, Llan Kaloshit, Shaban Lushës e Elez Isufit u nisën për të ndihmuar Shkodrën, kundër sulmit Serbo-Malazes, (por Elezi kthehet në Mat për tu dalë perpara forcave Serbe në Kolosjan, nga që mori lajmin se serbët po vrisnin foshnjat në luftimet që kishin filluar në Lumë). Krahas Çidhnakëve për në Shkodër u nisën edhe 2000 forca të tjera nga malet e Dibrës, gjithsesi 4000 luftëtarë dibranë morën pjesë në luftimet heroike per 7 muaj në rrethimin e Shkodres. Edhe sot në fushën e Berdicës në Shkodër janë varret e 170 Dibraneve, pa llogaritur të rënët e tjerë në malin e Taraboshit.

→

←

Mbi telat me gjemba që rrethonin kampin Serbo – Malazes ra herokisht në luftime edhe komandanti Shaban Lusha duke u bërë simbol i trimërisë dhe heroizmit.

Dibranët u angazhuan edhe në luftimet që zhvilloheshin për mbrojtjen e Janinës nga sulmi grekë e bullgar, bile nga Çidhnaket ka patur luftëtar edhe në luftimet që zhvilloheshin në Himarë të Vlorës gjithashtu kunder forcave Greke që përpiqeshin të pengonin shpalljen e Pavarësis.

Pra dibranët shkruan faqe të shkëlqyera heroizmi që pena e historianëve akoma nuk e ka përshkruar, të ndarë në 3 fronte për mbrojtjen e trojeve shqiptare. Kjo luftë titanike e tyre për mbrojtjen e trojeve nga serbët, grekët, malazezët e bullgarët bëri të mundur edhe pengimin e trupave serbe për të pushtuar Durrësin, që synonin ta pushtonin para mbërritjes së Ismail Qemalit, Ky qe shqetësimi kryesor i plakut para nisjes nga Trieste për në Durrës, nëse do arrinte në kohë para serbëve për të shpallur pavaresinë e Shqipëris (I. Konomi libri Pavarësia).

Më 21 nëntor 1912, Ismail Qemali zbriti në Durrës ku u prit ftohtë. Po më 21 nëntor nga Dibra u nis për në Vlorë Isa Boletini me 200 veta.

Më 23 nëntor, Ismail Qemali i shoqëruar nga dibrani tjetër Dom Nikoll Kaçorri nga Lura, si përfaqësues i shqiptarëve katolikë nën urdhrin e Arqipeshkvit të Durrësit, Abdi e Murat Toptani, Mustafa Merlika, Qemal Karaosmani i ardhur ... nga Berati etj, rreth 40-50 veta, u nisën për në Vlorë meqë në Durres nuk ishin kushtet e përshtatshme për ta shpallur pavarsin...

Grekërit nuk mundën të pushtonin Vlorën, megjithëse kishin bllokuar detin, sepse kjo krijonte përplasje të fortë me Italinë dhe Austrinë.

Qytetin e Vlorës që një javë më parë ndodhej në të pritjen e tij të zakonshme, me mbërritjen e delegatëve e pushtoi entuziazmi. Pesimizmi i një jave më parë përshkruhej nga konsulli Italian. Domeniko de Fecendis në një letër për ministrin e tij të jashtëm "Kushtet modeste të kulturës, rrethanat mjaft të veshtira ekonomike, kushtet e papërshkrueshme sociale, i heqin këtij populli madje edhe forcën për të reaguar, për të kërkuar diçka më shumë se sa buka e përditshme" (I. Konomi "Pavarësia", f. 202). Prandaj edhe Italia nuk kishte besim tek personaliteti i Ismail Qemalit.

Më 27 nëntor lufta vazhdonte me grekët edhe në Janinë, ndërsa më 28 nëntor serbët hyjnë në Durrës.

Po me 28 nëntor në sarajet e Vlorajve, delegatët nga viset shqiptare mbi 40 veta nga paria shqiptare mblidhen në orën 16:00 pasdite në sallën e madhe të Selamllëkut dhe morën vendimin historik për shpalljen e Pavarësisë.

Pas fjalës së Ismail Qemalit e disa diskutimeve në çastin solemn sekretari i mbledhjes Luigj Gurakuqi lexoi rezolutën e themelimit të shtetit shqiptar.

Në Vlon më 15/28 të vjeshtës së tretë 13281912. Pas fjalëve që tha z. Kryetari Ismail Kemal Beu, me të cilën tregoi rrezikun e madh në të cilin ndodhet sot Shqipëria, më sot Shqiperia të bahet në vete, e lirë dhe e mosvarme.

Fjalët ishin në shqip dhe turqisht

Deklarata kishte më pak se 60 fjalë.

Ismail qemali po nënshkruante aktin e pavarësis, akt i cili vetëm pak muaj më parë do të kishte habitur shumë njerëz, sepse vetë ai kishte luftuar deri në fund për ruajtjen e Perandorisë... (Ilir Konomi "Pavarësia" f.221).

Ismail Qemali u ngarkua nga kuvendi të formohej qeveria.

Haxhi Vebi Dibra u caktua kryetari i Senatit dhe Dom Nikoll Kaçorri n/kryetar i qeverisë.

Lufta e Shkodrës vazhdonte, çidhnakët dhe dibranët për 7 muaj rresht shkruan faqe heroizmi e lavdie për mbrojtjen e qytetit nga serbo-malazezët, nuk kishin bukë e as ushqime, por me luftimet heroike në Shkodër ata qenë ushtria e parë Shqiptare që luftuan jo vetëm per mbrojtjen e Shkodres por i dolen zot më armët dhe gjakun e tyre pavarësis së shpallur nga plaku i Vlores me 28 Nentor.

Më 1 prill 1913 Ismail Qemali me Luigj Gurakuqin e Isa Boletinin u nisën për në Londër ku mbahej Konferenca e Ambasadorëve...

Më 21 prill 1913 Esat Pasha ua dorëzoi Shkodrën Malazezëve, kjo e tronditi Ismail Qemalin.

Më 20 maj 1913 Konferenca e Londrës arriti në parim një marrëveshje që Shqipëria të ishte e pavarur dhe të drejtohej nga një princ evropian i krishterë. Derisa të arrinte Princi, vendi do të drejtohej nga një Komision Ndërkombëtar i Kontrollit i cili do të ndihmonte kreun e shtetit të qeveriste për një periudhë 10-vjeçare (I. Konomi "Pavarësia", f. 243).

Më 29 korrik 1913 u caktuan 6 fuqitë e mëdha për të garantuar pavarësinë e Shqiperis, administrata civile do të drejtohej nga komisioni i kontrollit për 6 vjet, xhandarmëria do të komandohej nga oficerë holandez. Kosova, Peja, Prizreni, Dibra e Çamëria mbetën jashtë teritoreve shqiptare.

Në tetor 1913 arriti Komisioni i Kontrollit që nuk përfilli qeverinë e Vlorës dhe as qeverin e tradhtarit Esat Pashë Toptani.

Më 22 janar 1914 nën trysninë e Komisionit të Kontrollit Ismail Qemali dha dorëheqjen dhe u largua nga Shqipëria. Vdiq në Itali, janar 1919 i helmuar në Perugia me kafe.

Serbia synonte "vijën strategjike" sipas një marrëveshje të fshehtë të lidhur në Tiranë më 1914 dhe në Beograd më 1915 me Esat Pashën. Ushtritë serbo-malazeze pushtojnë tokat shqiptare pas 1 viti, por shpejt thyhen keq nga ushtria austro-hungareze që në janar 1916 pushtoi Shqipërinë. Banorët e Lurës dhe të fshatrave të Çidhnës, Gryk- Noka etj, në korrik 1916 masakrohen nga austriakët tek kisha e Lurës. Krerët që kundërshtonin u dërguan në internim disa prej tyre masakrohen në Zhurë të Prizrenit, midis tyre edhe Taf Tola që dhe sot është pa varr.

Me traktatin e fshehtë të Londrës të datës 26 prill 1915 fuqitë e Antantës, copëtonin territoret shqiptare. Gjatë Luftës së Parë Botërore forcat serbe ripushtuan territoret e vijës strategjike. Shteti shqiptar i krijuar më 1913 nuk ishte njohur de jure dhe de fakto ne "vijën strategjike" nga fuqitë e tjera.

Dibra u pushtua nga Serbia, ajo kërkonte 'vijen strategjike' me kufirin në Qafë Buall, Qafë Bene dhe Qafe Gelqere e Lanë Lure. Dibranët



Anëtarë të shoqatës në kalanë e Krujës

©Fotot janë marrë nga faqja në FB e shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët"

Shoqata atdhetare "Çidhna dhe Kastriotët" zgjedh kryetarin e ri në Krujë

Më datë 28 nëntor 2013, shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" organizoi një aktivitet me një grup veprimtarësh të saj në Krujë. Aktiviteti u organizua nga kryesia e shoqatës, në përkujtim të 28 Nëntorit 1443, që përkon me 570 Vjetorin e ngritjes së flamurit nga Gjergj Kastriot Skënderbeu, i cili i shoqëruar nga 300 kalorës dibranë çliroi Krujën. Më 28 Nëntor 1443 Skënderbeu i siguroi pavarësinë e parë shqiptarëve nga Perandoria Osmane, pavarësi e cila u konsolidua për 25 vjet rresht.

Pjesëmarrësit në këtë aktivitet vizituan muzeun e heroit kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" ku u njohën me veprimtarinë e heroit dhe të bashkëluftëtarëve të tij për mbrojtjen e trojeve arbërore e më gjerë.

Në fund kryesia e shoqatës në prani të kryetarit të nderit zotit Mustafa Tola dhe anëtarëve themelues zhvilluan një mbledhje, e cila për nga simbolika që përcjell festa e 28-nëntorit, ishte e veçantë.

Pasi u analizua një veprimtari e shoqatës deri më tani, u bënë edhe zgjedhjet e reja të kryetarit të shoqatës. Në bazë të statutit, i cili përcakton kalimin me rotacion të kryetarit të shoqatës, zoti Ali Hoxha, kryetari aktual i shoqatës, i dorëzoi detyrën nënkryetarit zotit Muhamet Bitri, i cili do të jetë për dy vite në vazhdim Kryetari i ri i shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët".

Hajredin Toca

Sekretari i shoqatës

Në bazë të statutit, i cili përcakton kalimin me rotacion të kryetarit të shoqatës, zoti Ali Hoxha, kryetari aktual i shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", i dorëzoi detyrën nënkryetarit zotit Muhamet Bitri, i cili do të jetë për dy vite në vazhdim kryetari i ri i kësaj shoqate.

organizojnë Kryengritjen e madhe atë të 22 shtatorit të vitit 1913 e cila gjithashtu e pati fillimin e vet në Fushën e Çidhnës. Pas kthimit nga lufta e Shkodrës, Çidhnakët qëndruan kryesisht në male bashkë me Selman Alin dhe u morën me pregatitjet per kryengritje. Po ne Krahinën e Çidhnës patën fillimin e veta edhe kryengritjet e viteve 1918, dhe ajo e gushtit te vitit 1920 kunder Serbeve me 5 të shtënat e patriotit Riza lusha nga Arrasi, me komandant të përgjithshëm Elez Isufin që u caktua nga Qeveria e Arrasit, e cila u formua me 15 Korrik në shtëpinë e Riza Lushës dhe u mbajt për 2 muaj me shpenzimet e tij.

Më 17 dhjetor 1920 Shqipëria u pranua anëtare e Lidhjes së Kombeve me mbrojtën e shkëlqyer që i bëri Fan Noli çështjes shqiptare para lidhjes së kombeve me dt. 12 tetor 1920.

Gazetari i mirenjohur z.Abdurrahim Ashiku, duke njohur mire dhe studjuar në dokumente historin e kesaj treve dhe origjinën Çidhnake të Kastrioteve, ka propozuar teë ngrihet një Përmendore Lavdie për historin e Dibrës dhe vendlindjen e Skënderbeut, në kodrën dominuse mbi Thekanush, diku në Suke të Arrasit, për ta bërë atë një vend pelegrinazhi për vendasit dhe turistët e huaj, që duan të dijnë dicka më shumë për historin e Shqipërisë dhe lavdin e të madhit Skënderbe. Gjithashtu edhe Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" po bën perpjekjet e saj që aty të ngrihet një lapidar për betejën e Torvjollit, dhe një obelisk per dy masakrat më të mdha që janë kryer në historin tonë kombëtare, ajo e mbretit Maqedon PERSEU mbi banorët e OENES dhe ajo e njohur në histori me emrin Masakra e ÇIDHNES, kryer nga Sulltan Mehmeti II ne vitin 1466. Gjithashtu propozojmë që Bashkia e Krujes dhe Qeveria të perkujtojnë ngritjen e flamurit kuqezi nga Skenderbeu 570 vjet më parë në Krujën legjendare, si Nëntori i Parë i lirisë, 28 Nëntorin e vitit 1443. Një vit pasi përkujtuam me madhështi 100 vjetorin e Pavarësis, Nëntorin e Dytë 28 Nëntorin e vitit 1912, ditën kur plaku Ismail Qemali, ringriti në Vlorën Heroike flamurin e Kastriotëve dhe shpalli Pavarësin e Shqipëris.

** Mustafa Tola - Studiues. Kumtesa u mbajt me shkurtime në sesionin shkencor që u zhvillua nga Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" në Akademin e Shkencave më 28 Nentor 2012.*

TENDER ANNOUNCEMENT

ALCDF (Albanian Local Capacity Development Foundation) is implementing the project "To improve management of the National Park Lura and Natural Park Korab-Koritnik (Albania) & National Parks Mavrovo and Pelister (Macedonia)" financed by European Commission under IPA/CBC (Albania and Macedonia).

The subject of this tender is procurement, delivery, installation and configuration of the core hardware and software elements and associated implementation services for establishing enterprise GIS platform, according the needs.

For full details of the tendering procedures an ToR, please refer to the webpage www.prexalbania.com, you can also contact ALCDF (Albanian Local Capacity Development Foundation) office , Ms. Lindita Manga, Address: Rr. Pjeter Bogdani, 23/1, Tirana, Albania, Tel/Fax N° : + 355 42240751,E-mail: lmanga@alcdf.org .

Rruga e Arbërit nr. 91

portret

Riza Tefiku ishte i biri i Hoxhë Mehmet Tefikut nga Dibra e Epërme. Për origjinën e kësaj familje, traditat gojore përmendin se ishte nga fshati Erebarë i Komunës së Maqellarës dhe prej këtej, duket se kjo familje u largua dhe u vendos me banim në qytetin e Dibrës Madhe...

Riza Tefik Dibrani

Nga **XHELAL ROÇI**

Shekulli i nëntëmbëdhjetë ishte për popullin shqiptar, shekulli i madh i zgjimit të tij kombëtar. Idetë çlirimtare të Rilindjes Kombëtare, ndjenjat e fuqishme patriotike të popullit tonë gjetën shprehjen më të lartë në lëvizjen e madhe të shqiptarëve në Prizren krijuar në muajin qershor 1878. Ata u kurorëzuan më në fund me shpalljen e pavarësisë në Vlorë, më 28 nëntor 1912. Pikërisht në kohën kur lëvizja për çlirim kombëtar e shoqëror kishte marrë hov të papërmbajtur, në vitin 1878 në qytetin Toribrat (Xhuri Mustafa pasha afër Adrianopojës), lindi Riza Tefiku.

Riza Tefiku ishte i biri i Hoxhë Mehmet Tefikut nga Dibra e Epër. Për origjinën e kësaj familje, traditat gojore përmendin se ishte nga fshati Erebarë i Komunës së Maqellarës dhe prej këtej, duket se kjo familje u largua dh eu vendos me banim në qytetin e Dibrës Madhe e pastaj në qytetin e Stambollit në Turqi.

I ati i Rizait, Mehmet Tefiku, ishte i diplomuar në Universitetin e Stambollit, në degën e administratës pasi kishte kryer kolegjin fetar "Fatih". Pas studimeve universitare hoxha Mehmet Tefiku, studioi vetë filozofinë dhe si zotërues i mirë i kësaj lënde ai u jepte mësim privatisht dhe disa personaliteteve të mëdha të kohës në Turqi, si Riza Pashajt, Rushit Pashajt e të tjerëve. Mehmeti kishte kulturë të gjerë dhe zotëronte respekt të veçantë në radhët e intelektualëve të kohës në Stamboll. Përveç detyrës së mësuesit dhe të fetarit si hoxhë, babai i Rizait, Mehmeti, ka qenë edhe nëpunës me detyrë nënprefekt i krahinës së qytetit të Adrianopojës. Ai ishte i përmendur për dije në disa fusha të jetës, për urtësi, edukatë dhe kulturë në radhët e intelektualëve më të mirë të kohës në qytetin e Stambollit.

Në librin e profesor Hasan Kaleshit me origjinë nga Kosova, me titull "Kontributi i shqiptarëve në Diturinë Islame" shënohet se Riza Tefiku lindi në qytetin e Dibrës së Madhe më 1868 dhe në vitin 1876 shkoi në Stamboll së bashku me familjen e tij, ku u vendos me banim atje. Ndërsa në disa dokumente të tjera, siç e përmenda edhe më sipër, shënohet se ka lindur në qytetin Tariband, Shasri Mustafa Pasha afër Adrianopojës.1)

Ashtu siç e shënon edhe vetë Riza Tefiku në kujtimet e tij, nënën e ka pas çeçene, banues në Tariband, Xhasri Mustafa Pasha afër Adrianopojës, Edrenës. Ai vetë shënonte se origjinën e kam nga Dibra mbi të cilën do të shpjegojmë dhe më poshtë. Në disa vende në shkrimet e tij shkruante:

Kush nuk e di, tash le ta dijë
Babanë e kam shqiptar nënën cerkeze.2)

Siç duket kur Rizai ishte fëmijë i mitur, duhet të ketë jetuar tek gjyshja në Dibër të Madhe e cila ka shumë mundësi të ketë qenë shqiptare, ndoshta edhe dibrane e krahas gjuhës turqishte në familje të ketë mësuar nga ajo edhe gjuhën shqipe.

Riza Tefiku krenohej me origjinën e familjes së tij shqiptare dhe dibrane. Këtë fakt ai e shprehte në biseda në rrethet intelektuale dhe në shkrimet e tij disa herë kishte shënuar për origjinën e tij dhe të familjes.

Babai im është shqiptar dhe dibran, fliste ai me krenari. Nëse ka që nuk e dijnë ta mësojnë atë të gjithë njerëzit.

Nuk kemi të dhëna të hollësishme për vitet e para të shkollimit të tij, por dimë se në moshën dhjetë vjeçare, Rizai, mësoi gjuhën frëngjishte dhe ebreishten. Riza Tefiku që në moshë të re u fut në shkollën e Jodhyve.

Mbasi kreu këtë u regjistrua në liceun e qytetit Galata Saraj. Jetë shkruesit e tij shpjegojnë se ai kur ishte nxënës ishte shumë i lëvizshëm, nuk i duronte kërkesat e disiplinës e nuk i zbatonte rregullat në shkollë, prandaj ai ndërroi shumë shkolla. Në mësime, Riza Tefiku kishte rezultate të mira

> Riza Tefiku ishte një etatist, një politikan i shquar, një shtetas turk i vendosur dhe një shqiptar me ndjenja të larta kombëtare. Ai zotëronte aftësi të veçanta në disa fusha të jetës dhe këto veti të tij bënë që ai të merrte pjesë edhe në detyra të larta shtetërore në administratën turke.
>
> Riza Tefiku krenohej me origjinën e familjes së tij shqiptare dhe dibrane. Këtë fakt ai e shprehte në biseda në rrethet intelektuale dhe në shkrimet e tij disa herë kishte shënuar për origjinën e tij dhe të familjes.
> Babai im është shqiptar dhe dibran, fliste ai me krenari. Nëse ka që nuk e dijnë ta mësojnë atë të gjithë njerëzit.

në përvetësimin e programeve mësimore. Kjo bëri që ai mbasi kreu arsimin e mesëm të regjistrohej në shkollën e lartë administrative "Mulkiyye – i Sultaniyye" por pas një kohë i ndërpreu studimet, e la atë dhe iu kushtua shkrimeve e leximeve jashtë shkollore. Shumë herë filloi të shkruante vjersha. Këto veprime të tij ishin në kundërshtim me dëshirën e babait të tij, Mehmetit. Ai insistonte që i biri patjetër duhet të përfundonte shkollën e lartë dhe pikërisht fakultetin e administratës. Në vitin 1890, me ndihmën dhe ndërhyrjen e të atit, mbasi isthe larguar nga fakulteti i administratës më para, Rizai, u regjistrua në fakultetin e mjekësisë, në Universitetin e Stambollit. Në Universitet ai u dallua për përparim në mësime. Mbas përfundimit të mësimeve u diplomua mjek i përgjithshëm dhe për një kohë në fillim të karrierës së tij punoi si mjek dogane.

Riza Tefiku shënonte në dokumentet e tij personale dhe në kujtimet e tij: "Se jam i biri i hoxhë Mehmet Tefikut nga Dibra e Sipërme nga fisi i Bylykbashit. Riza Tefiku ishte politikan, patriot dhe atdhetar i madh. Ngjarjet që kishin ndodhur në perandorinë osmane pas reformave të Tanzimatit, kundërshtimet që bëheshin nga popuj të ndryshëm dhe sidomos ngjarjet e atyre viteve në Shqipëri, ku lëvizja për çlirim kombëtar e shoqëror kishte marrë hov të papërmbajtur. Ndërgjegja kombëtare ishte rritur shumë. Që vite më parë e mbarë Shqipëria ishte përfshirë në kryengritje merrnin pjesë të gjitha klasat e shtresat e popullit shqiptar me një shtrirje të gjerë nga Veriu, Lindja e deri në Jug të Shqipërisë.

Perandoria osmane në këtë kohë kishte hyrë në fazën e rënies dhe të dekompozimit të saj. Klasat sunduese duke parandjerë dobësimin dhe kalbëzimin e atij sistemi shoqëror në Turqi, ndërmorën një seri masash për t'i frenuar këto procese. Ata zbatuan disa reforma që u ndërmorën nga qeveria turke, në këtë periudhë, nuk mundën të zhduknin hendekun e madh që ekzistonte midis portës së lartë e popujve të nënshtruar. Në këtë periudhë janë të njohura luftërat e dibranëve për të flakur shfrytëzimin turk e për të ruajtur tërësinë tokësore të Shqipërisë nga copëtimi.

Këto ngjarje tek Riza Tefiku, megjithëse në moshë të re dhe disa nga këto kishin ndodhur, disa vite përpara se të lindte ky, ose kur ishte në moshë të vogël e të re, por kua ai i mësonte ata, në mjediset familjare e shoqërore linin mbresa tek ai. Gjatë kohës kur Riza Tefiku ndiqte studimet në fakultetin e mjekësisë, për një kohë të gjatë jetoi në Arnaut-Qej, lagjja e Stambollit, në shtëpinë e patriotit dhe të atdhetari të shquar Ismail Qemali. Ndonëse në moshë të re, ai i përjetëoi ngjarjet e Lidhjes Kombëtare Shqiptare të Prizrenit. Ai ishte i njohur dhe jetonte me përpjekjet e shqiptarëve për autonomi, pavarësi e arsim kulturë në gjuhën amtare. Rizai në këtë periudhë u njoh me tre vëllezërit Frashëri dhe ishte në kontakte të vazhdueshme me ata. Ai ishte në brendësi të gjithave diskutimeve që bëheshin në atë kohë për çështjet kombëtare shqiptare.

Riza Tefiku kishte njohje të plotë me Hasan Tahsimin e të tjerë të patriotë shqiptarë. Këtij të fundit, Rizai, i kushtoi një artikull të posaçëm tek gazeta "Shqiptari" që nxirrte në atë kohë Dervish Hima dh Ibrahim Tema.

Rizai me Dervish Himën dhe Ibrahim Temën ishin njohur kur vazhdonte studimet në fakultetin e mjekësisë, në universitetin e Stambollit, mbasi edhe ata ishin studentë në atë fakultet. Gjithashtu, ai, me Hamdi Ohrin (Qokun) Dervish Himën dhe Ibrahim Temën ishin shokë të ngushtë, ata kishin të njëjtat ide dhe pikëpamje për çështjen kombëtare. Riza Tefiku kishte njohje dhe ishte bashkëpunëtor i ngushtë me të gjithë rilindësit e brezit të vjetër që jetonin në atë periudhë e punonin për çështjet kombëtare pas viteve 80 të shekullit XIX.

Regata të ngushta dhe pikëpamje të njëjtë, Riza Tefiku, ka pasur përveç Ismail Qemalit, me Hasan Prishtinën dhe me të tjerë. Shqiptarët e kolonisë së Stambollit kanë qenë atdhetarë të flaktë, ata punonin natë e ditë për çështjen kombëtare. I tillë ishte edhe Riza Tefiku.

Riza Tefiku ishte një etatist, një politikan i shquar, një shtetas turk i vendosur dhe një shqiptar me ndjenja të larta kombëtare. Ai zotëronte aftësi të veçanta në disa fusha të jetës dhe këto veti të tij bënë që ai të merrte pjesë edhe në detyra të larta shtetërore në administratën turke. Me vendosjen e kushtetutës me datën 11 korrik 1908, për shkak të kryengritjes së Armatës së tretë të Rumelisë të drejtuar nga oficerë xhon-turq dhe të ndihmuar nga shqiptarët, Sulltan Hamiti, u detyrua të shpallë kushtetutën për herë të dytë. Kushtetutën e parë sulltan Hamiti, me tradhti e anulloi dhe hartuesin e përpiluesin e saj, Mitat Pashën e Madh e internoi dhe e burgosi në Tai afër Mekës, në Arabinë Saudite.

Më vonë, Mitat Pashën e eliminoi me anën e një personi mundës që e kishte dërguar për të kryer këtë detyrë, vetë Sulltani nga Stambolli.

Riza Tefiku ishte anëtar i Komitetit të Turqve të Rinj "Bashkim e Përparim". Ai mori pjesë aktivisht në jetën politike e shoqërore të vendit, Turqisë. Rizai u pranua anëtar i qeverisë së përkohshme gjysmë zyrtare të turqve të rinj. Fillimisht, Rizai, caktohet komisari i policisë i lagjes, evropiane "Pera", lagje kryesore e Stambollit. Ai në ato momente të vështira ishte i kudogjendur, emri dhe figura e tij kishte autoritet të madh, fjala e tij energjike i qetësonte masat e revoltuara nga pushteti i vjetër i sulltanëve.

Për disa vjet ai ishte deputet i Edrenës (Adrianopojës). Rizai nga ithtar i ideve Xhon Turke në fillim, shpejt u prish me ta dh ekaloi në opozitë. Në Turqi në atë kohë ekzistonin dy parti "Ihiha tre Tereki" (Bashkim dhe Përparim) e përbërë prej turqve të rinj (Jeun Ture) dhe tjetra parti ishte "Hyrjet ve Itilat" (Liri e Marrëveshjes), anëtarët e të cilës ishin prej të gjithë kombësive që përbënin Perandorinë Osmane. E para ishte parti nacionaliste e shoviniste, synonte turqizmin e kombësive e në radhë të parë të kombësisë shqiptare dhe aspironte një centralizëm administrativ, kurse tjetra në kundërshtim me të parën, ishte për një decentralizim administrativ dhe liri mësimi në gjuhën kombëtare të secilit komb. Të parët ishin pa eksperiencë me horizont të ngushtë, ndiqnin një politikë që nuk u përshtatej as kohës dhe as strukturës së Perandorisë Osmane, kurse të dytët të kryesuar nga princi Sabahudini, ishin me eksperiencë, me horizont më të gjerë. Këto shpëtimin e vendit e shikonin me ndjenjën e një politike toleruese, të përshtatshme për kushtet speciale të perandorisë.

Shqiptarët i pritën me entuziazëm e me brohoritje masat premtuese e shpalljen e kushtetutës, se mendonin se kishte ardhur koha që të gëzonin si komb të drejtat e liritë më elementare që u kishte mohuar sulltanati. Ata mendonin se me anën e shkollave në gjuhën kombëtare do të ngrinin lartë nivelin e kulturës së popullit, do të fitonin dije dhe do të përgatiteshin për të ardhmen që të fitonin kërkesat e tyre. kishin krijuar besim se Turqit e Rinj do të ndiqnin një politikë realiste dhe favorizuese për shqiptarët. Xhonturqit (ose turqit e rinj) në zbatim të politikës së tyre shoviniste më parë sulmuan shqiptarët që ishin për zhvillim të plotë të reformave. Ata filluan ndjekjen e shqiptarëve me pikëpamje përparimtare, mbylljen e shkollave shqipe dhe të klubeve të shoqërive shqiptare në mërgim.

Këto klube të "Bashkimit" ishin qendra intelektuale të lëvizjes kombëtare e të vendosur për të siguruar hapjen e funksionimin e shkollave shqiptare e të vendosur për të siguruar hapjen e funksionimin e shkollave në gjuhën amtare. Në këto klube merrnin pjesë intelektualët, nëpunësit civilë, ishoficer që shërbenin në aparatin shtetëror turk, studentë dhe persona politikë dhe fetarë përparimtare me ndjenja përparimtare e kombëtare shqiptare. Klube të tilla kishte në Stamboll, në Selanik, në Manastir, në Shkup e në vende të tjera.

Në klubin e Stambollit bënte pjesë e luante rol kryesor edhe filozofi, eruditi Riza Mehmet Tefiku, me origjinë shqiptare nga krahina e Dibrës i cili kishte mbajtur konferenca në favor të shkronjave shqipe, shkruante një bashkëkohës i tij. Xhonturqit dhe veglat e tyre anëtarët e këtyre klubeve të "Bashkimit" i quanin bashkimxhi, fjalë që për ata kishte kuptimin, tradhtar, të pa fe e të pa moral. Kur xhonturqit u bindën se nuk mund të përballonin vrullin e patriotizmin shqiptar me mjete legale, me intriga dhe me korrupsion, ata vendosën ta thyenin me forcën e armëve. Fshatarët e Kosovës të pakënaqur nga Oktova (një lloj takse) dhe nga politika e turqve të rinj bënë kryengritje, e cila filloi në Kaçanik e Ferizaj edhe u përhap edhe në viset e tjera të Shqipërisë 3).

(Vijon vijon numrin e ardhshem)

1. Hasan Kaleshi, "Kontributi i shqiptarëve në diturinë islame"
2. Baba Selim Kalicani, "Historia e Bektashizmit si sekt Mistik Islam"
3. Sejfi Vllamasi, "Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897-1942", faqe 36.

libër i ri

Libri **"Udhët e fisnikërisë"** i Mevlud Bucit, testament dashurie për vlerat njerëzore

FAIK XHANI,
studiues-shkrimtar

Kur rilexova tematikën e librit të 22-të të autorit Mevlud Buci të titulluar "Udhët e fisnikërisë" e them me dashamirësi sikur pushova në një bahçe luleshumë. Përse? Autori Buci, intelektual dhe fisnik në breza, i lidhur me popullin dhe diturinë e popullit, studiues dhe përshkrues real na ka dhuruar një testament dashurie për vlerat njerëzore. Personazhet e këtij libri publicistiko-letrar mbartin vlera të çmuara, rrezatojnë dritë fisnikërie. Autori krahas përshkrimeve të ngritura mbi fakte e dëshmi të vërteta herë-herë ngre edhe balada, jep sentenca filozofike, urtësi, argumenton dhe të bind për figurat e ndritura të librit të tij të 22-të.

Zoti Buci flet e shkruan me shpirt, me sinqeritet, me argumente ku secili lexues gjen faktikisht modelin e thjeshtësisë e të urtësisë, të drejtësisë e të përkushtimit. Libri ka një tematikë të pasur, figura të panjohura, të cilat ju ngjajnë mineraleve të mbuluara nga "dherat". Tek ky libër jo vetëm shkrimet e gdhendura thjeshtë, bukur, çiltër e me plot bukë si i thonë, por edhe sentencat e baladat origjinale reale e të frymëzuara, - e qoftë edhe një fotografi e komentuar ka vlerën e vet. Autori Buci ka bërë punë shumëvjeçare. Ashtu sikurse 44 vitet e punës së tij për mësimdhënien shembullore e drejtimin arsimor, në shkollat e disa zonave të vështira në Dibër dhe në Tiranë, me punë e shpirtit të fisnikëruar, punë hulumtuese e botuese kanë qenë e janë dhe plot figura që mbartin fisnikëri pavarësisht që këta nuk janë të dekretuar "heronj", pavarësisht se nuk kanë drejtuar qeveri, ministri apo parti, por janë më të ndriturat se kanë mbartur e mbartin urtësi, prova, mençuri, humanizëm e fisnikëri.

"Parajsën" e vërtetë publicisti, studiuesi e shkrimtari Mevlud Buci e kërkon në këtë jetë, midis nesh, në provat e djersës të drejtësisë a të fisnikërisë. Në librin "Udhët e fisnikërisë", shkruhet për kavalierin e paqes, genin e fisnikërisë tiranase Lulzim Brahja, për shkencëtarin e shkencëtarëve ish partizanin 14-vjeçar, patriotin e shquar, luftëtarin e lirisë, Kadri Demiri, njeriun e besimit e të fisnikërisë Vexhi Halit Hoxha, për mjeshtrin e sportit Rasim Shira, sizifin e qëndresës për liri e demokraci, Ramadan Perhati, shkruhet për mjeshtra, të drejtimit arsimor në bazë si Beqir Ajet Shehu i Vasijes, Kalasë së Dodës (ish shef i arsim-kulturës në Dibër) për ish shefin e nderuar të arsimit të Dibrës, Elmaz Lala i Reçit për drejtorin novator Ilir Bodini i Kalisit për mjeshtrat e pedagogjisë e drejtor shkollash, Mësuesin e merituar Baftjar Gazidede, për drejtorët çidhnakë të urtësisë si Xhavit e Zylfi Spata për njeriun e persekutuar nga të gjithë sistemet, korifeun e Barbullejt të Matit që mban medalje ari, Xhemal Ali Murati, për ish-shefin novator të arsimit të Matit Flamur Nazif Stafhasani, për intelektualët e shquar të Qafëmurrës, fisnikët të Dibrës e të kombit Isuf e Osman Miha, për bijtë e Lurës historike si drejtorin e talentuar të kullës së qëndresës, Bajram Mena, për mësuesin e paharruar të kullës së Sali Çupit e të Çup Alisë, të ndriturin Fatos Mehmet Çupi e Zenel Xhetan Prençi, për njeriun e palodhur të pleqësisë, birin e Zall-Dardhës Daut Çerpja e për inspektorët novatorët e gjurmëlënës si Fitim Dani e Haki Duka, për fisnikërinë e fisit Minxhozi të Shlliut të
Matit, për kullën e Selman Shimës në Cikallesh të Pezës së Madhe, për intelektualët e nderuar si Hysen Dervishi i Lukanit (krijues e drejtor dhe shef kulture në Bulqizë e Mat) për intelektualin Hasan Nurë Frangu të Lisit të Matit për Jaho Delinë (Selmani), të Kalasë së Dodës për njeriun e shenjtërisë e të fisnikërisë së Vinokashit të Dëshnicës së Përmetit, Kadri Riza Memishaj për Ylber Litën e fisin Lita, për Prof. Dr. Petrit Bara, për Muharrem Ahmetajn, fisnikun e Baldushkut, për aviatorin hero Sefedin Hasan Tomçini, drejtorin e shquar e metodistin Selim Tusha, mësuesin e talentuar, birin e Sines Xhelal Pashnjari, profesorin e madh të pedagogjisë Shefik Osmani e të tjerë. Një libër kronikal i hartuar me kujdes e realizëm, një libër bashkëkohorë për vlerat e çmuara të brezave bashkëkohorë, një libër testament dashurie për vlerat njerëzore, për fisnikërinë. Urime Mevlud Buci, sepse vetëm kjo fisnikëri do të ndriçojë brezat, kohërat e kombin tonë!



Hysen Dervishi i Lukanit - korifeu i kulturës

Nga **MEVLUD BUCI**

Njerëzit e kulturës dhe të artit ngjajnë me blerimin, me ujëvarat e kristalta, me puset e thella, sepse ata mbartin freskinë, gurgullimën e kristaltë të gurrave, ata rrojnë gjatë në muzën popullore në kujtesën e brezave. Kështu të ndodh me birin e Lukanit e të Runjës shekullore, artistin, drejtuesin, veprimtarin, krijuesin, korifeun e kulturës Hysen Dervishi. Është 67 vjeç. Ka bërë emër me punë e djersë, emër për lartësimin e kulturës së brezave. Është vërtet gjurmëlënëse udha e fisniëkrisë së Hysen Dervishit të Lukanit si krijues, si drejtues kulture në Katër Grykë, Dibër, Bulqizë, Mat e gjetkë. Njeri i talentuar, prind shekullor, korifeu i kulturës. Koha, brezat, faktet e përkushtimit, djersa dhe krijimtaria e Hysen Dervishit të Lukanit ngjajnë me Runjën (2047 m), me gurgullimin e zalleve...



FORMIMI

Hysen Dervishi ka mbaruar shkollën e mesme të kulturës në Tiranë. Është diplomuar mësues muzike e vizatimit për shkollat tetëvjeçare (1964-1969). Ka mbaruar ushtrinë (1967-1969). Ka mbaruar akademinë e arteve në Tiranë. Është diplomuar organizator dhe metodist i punës kulturore dhe artistike (1969-1973). Ka mbaruar studion e aktorëve pranë Teatrit Popullor. Është diplomuar me titullin "Aktor Teatri" (1972-1974). Ka mbaruar kursin e specializimit 2-vjeçar pasuniversitar për regjisor, 1974.

PËRVOJË PUNE

Mësues i muzikës, vizatimit dhe historisë në shkollën 8-vjeçare në Katër-Grykë për një periudhë 1-vjeçare. Pedagog i Jashtëm në Shkollën e Mesme të Kulturës, 1970-1973. Regjisor i Estradës profesioniste të Peshkopisë (mbrojtje diplome 1974-1975). Drejtor i Kulturës së rajonit Bulqizë 1975-1986. Drejtor i Kulturës në Burrel 1986-1988. Shef Seksioni i Kulturës së Rrethit Mat 1988-1993. Biznesmen 1993-2005

TEMA – STUDIME – SHKRIME

Kumtesa: Patriotizmi i Katër-Grykëve në luftërat për liri e pavarësi 1839-1920, Bashkëpunimi i kryengritjeve Mat e Dibër në luftë kundër fashizmit, Sheh Fejzë Bulqiza – patriot e atdhetar i madh, Temë shkencore kushtuar Baba Fajës (Arkivat e muzeve Bulqizë dhe arkivi personal)

Radio – drama: Në ato ditë në flakë e zjarr, kushtuar heroizmit partizan të Dibrës, Me pushkë dhe penë – kushtuar patriotit Haki Stërmilli

Krijimtari letrare dhe artistike: Bashkëautor i Almanakut, "Dibra dhe Dibranët", Almanaku – Bulqiza (arkiv i muzeut), Poema – Dibra, Vëllim poetik – Bulqiza ime. Ka bërë regjinë e të gjitha shfaqjeve në Bulqizë. Të gjitha tekstet dhe poezitë me tematikë të ndryshme për ansamblin Bulqiza dhe Estradat

Media: Korrespondent i Radio-Tiranës për Bulqizën 1977-1986, korrespondent i medias së shkruar, shkrime publicistike, intervista televizive për probleme analitike të artit dhe kulturës (arkivi i televizionit shqiptar)

Skenarë televizivë për liqenet e Lurës, për vendlindjen, Qyteti i mollëve, Minatorët duarartë, Dibra e bukur Emisione muziko – letrare

Hysen Dervishi ka organizuar dhe mjaft veprimtari kulturore në ndërmarrjet dhe shkollat e Bulqizës, si dhe njihet si një ndër organizatorët e festivaleve të këngës popullore, zërave të rinj, rapsodëve popullore, etj. Ai arriti të konsolidoj ansamblin "Bulqiza" me elementë profesionistë prej 80 vetësh, i cili filmohej dy herë në vit në Televizionin shqiptar (Arkiv i Televizionit), cirkun e Bulqizës, bandën muzikore, e cila jepte koncerte çdo javë si dhe organizimin e rrethit letrar krijimtaria artistike u rrit shumë dhe atë e paguanim

Kultura masive: Biblioteka kishte një fond prej 40.000 ekzemplarësh të sistemuar mbi baza shkencore, numri i lexuesve ishte i madh, filmi jepej dy herë në ditë për punëtorët. Mesatarisht çdo ditë të javës kishte aktivitete

Hysen Dervishi si drejtor i Kulturës së bashku me punonjësit Xhelil Imeri – shef muzike, Flora Disha – bibliotekare, Liman Okshtuni – operator, Sazan Bajrami – koreograf, Nadire Alla, Sanie Kadiu punuan dhjetëra vite në Bulqizë. I falën rininë, por ua dha mirësinë.

PJESËMARRJA E INTERPRETUESVE

Mesatarisht gjatë një viti në të gjitha aktivitetet aktivizoheshin mbi 800 amatorë burra, gra të martuara, djem dhe vajza. Shtëpia e Kulturës Bulqizë është dekoruar me Urdhrin "Naim Frashëri" të klasit të parë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Po kështu është dekoruar nga Presidiumi Popullor me urdhrin "Naim Frashëri". Falënderojnë me mall dhe i kujtojmë po aq me mall interpretuesit e talentuar: Jete Mazari, Defrim Mandri, Rruzhdi Çupi, Mentie Prençi, Lulzime Gjoka e dhjetëra të tjerë, zërat e të cilëve mund t'i krahasosh pa frikë me këngëtarët e sotëm të Ansamblit të Shtetit. Ndihmë të pakufishme ka pas nga drejtorët e ndërmarrjeve dhe ata të shkollave, veçanërisht Myfit Dervishi, Martin Cukalla, Gegë Prifti, Sefedin Shabani etj.

Më gjerësisht për talentet e Bulqizës flitet tek tregimi monografik "Krenaria".

BIOGRAFIA

Janë vrarë kundër shovinizmit serbo-malazez gjyshërit e tij: Avdi Dervishi, Selman Dervishi (të dekoruar). Janë pushkatuar nga sistemi komunist Lik Derishi, major, Ismail Dervishi toger, Mal Dervishi, Shaban Xhaferr Dervishi, Kapiten dhe Mehmet Avdi Dervishi – toger – babai i tij. Në vitin 1924 familja e Hysenit ka pritur dhe përcjellë mbretin Zog. Xhaxhai i tij Rrahman Dervishi ka qenë partizan 1941-1944 në çetën e Dibrës. Familja ka patur miqësi me shtëpi të mëdha e individë të veçantë, Ndreun, Kaloshët, Lleshët, Ketët e Bulqizës, Selmanët, Kazihanin, Perhatin etj., si dhe individë Dali Ndreun, Haxhi Lleshin, Halil Ketën, Hysen Selmanin, Ahmet Perhatin etj.

FAMILJA

Hysen Dervishi – bashkëpunëtor i Institucionit të Folklorit, akademik i folklorit dibran – mbaruar akademinë e arteve. Sekretar i përgjithshëm i Partisë të Drejtave të Mohuara Shqiptare. Hysnie Dervishi, ka mbaruar Gjuhë Letërsi, punonjëse në bibliotekën shkencore të Universitetit (bashkëshortja). Leonora Dervishi – vajza. Ka mbaruar universitetin në Tiranë për Financë. Banon në Austri bashkë me familjen. Silvana Dervishi – vajza. Ka mbaruar dy fakultete, Gjuhë Angleze dhe Juridik. Doktore e shkencave. Punon në Ministrinë e Brendshme dhe Pedagoge e Jashtme në Fakultetin Ekonomik. Sokol Dervishi – djali. Ka mbaruar për arkitekturë dhe ka titullin Asoc. Prof. Dr. Është pedagog në Vjenë, si dhe në Universitetin Epoka dhe këshilltar në Bashkinë e Tiranës. Ina Dervishi (Osmani), pedagoge në universitetin "Epoka". Arkitekturë.

VAZHDIMËSIA E KULLËS SË DERVISHIT

Sulë Dervishi – pjesëmarrës dhe kryetar në gardën e Ali Pashë Tepelenës. Avdi Sulë Dervishi, prijës popullor. Vdiq nga plagët e luftës kundër serbit. Rrahman Avdi Dervishi – lufëtar 1941-1944, patriot, anëtar i këshillit të përgjithshëm, frontit demokratik të Shqipërisë. Dekoruar me urdhrin "Naim Frashëri". Sokol Dervishi – Prof. Dr. i shkencave arkitekturore. Drejtor i departamentit të universitetit "Epoka". Pedagog në universitetin e Vjenës.

Më duket se për Hysen Dervishin edhe kullën e brezat e saj është bërë fare pak. Ky burrë i Runjës shekullore është intelektual i udhëve të fisnikërisë, me plot të drejtë e realizëm: korifeu i kulturës. Jetë të gjatë e nderime në brezni Hysen Dervishi i Lukanit të Katër-Grykëve të Dibrës!

Njëra nga të veçantat që Arbana me sa duket ia ka dalë mbanë të tërheqë vëmendjen e publikut me recetat e saj është familja dhe fshati. Më saktë fshati dibran, me gjithë dashurinë dhe ngrohtësinë që të jep familja dhe soba e druve.

Recetat e Arbanës, mbushur me aromë **DIBRE...**

Gjatë muajit nëntor u prezantua libri i Arbana Osmanit, vajzës së spektakleve të Top Channel. Librit iu bë shumë publicitet në media, jo vetëm për recetat e saj të thjeshta dhe të shijshme, por edhe për faktin se të ardhurat nga shitjet do të shkojnë për fëmijët e ngujuar.

Të shkruash për një libër me receta kuzhine nuk është e lehtë për mua, por po e provoj për librin e Arbanës së "Big Brother", jo vetëm se isha i ftuar në festën e prezantimit të librit, por edhe se brenda faqeve gjeta detaje që ia vlen të njihen.

Kam parë disa herë një film për fëmijë, një histori të bukur franceze, të realizuar po mjeshtërisht nga *Walt Disney* dhe *Pixar Animation*. Është një miush (Remy) që ndihmon djaloshin Linguini të gatuajë aq mirë në një restorant të njohur në Paris, sa lë të mahnitur të gjithë klientët. Por a do të arrijë Remy ta kënaqë Anton Egon, kritikun e rreptë të kuzhinës, dhe të shpëtojë kështu restorantin e famshëm të Antonio Gustosë nga falimentimi dhe mbyllja? Kur kritiku i rreptë dhe i pakorruptueshëm provon supën e mrekullueshme të përgatitur me erëzat e përzgjedhura nga Remy, ai mrekullohet dhe para syve i del nëna e tij që i gatuante gjellë të mrekullueshme në fshat, kur ishte vetëm një fëmijë...

Njëra nga të veçantat që Arbana me sa duket ia ka dalë mbanë të tërheqë vëmendjen e publikut me recetat e saj është familja dhe fshati. Më saktë fshati dibran, me gjithë dashurinë dhe ngrohtësinë që të jep familja dhe soba e druve.

Në recetat e Arbanës gjendet gjalpi, gjiza, qumështi, qepa, specat, domatet, hudhra. Por në kuzhinën e saj janë rreth e rrotull edhe gjyshja, gjyshi, halla, babai, nëna, vëllezërit...

"Vendi i hallës Dane ishte gjithmonë pranë sobës, duke shkrirë gjalpin e freskët e duke gatuar receta tradicionale dibrane, nga ato që të bëjnë të lëpish gishtat, njëra prej të cilave është pula me arra..."

"Petullat e Mijes (gjyshes), shkruan në shpjegimin mbi recetat Arbana, edhe sot kur i gatuan mamaja, me sjellin ndërmend gjithmonë atë, gjyshen time të dashur, me shami të bardhë, teksa zinte brumin ne një enë të madhe jeshile dhe skuqte petulla sa për të gjithë fshatin..."

"Fasulet në shtëpinë e gjyshit në Maqellarë kanë qenë një "traditë" e përditshme, pasi çfarëdo të kishte në sofër, një pjatë me groshë nuk mungonte kurrë..." Arbana e quan recetën "Fasulet e babit", pasi ai "i qan ato".

"Specat e pjekura... më kujtojnë gjithmonë fëmijërinë, babanë tim, që me nge i piqte mbi sobën e druve, duke i kthyer vazhdimisht dhe ne që i hanim gjithë shije duke ngjyer bukën me lëngun që ata lëshojnë..."

"Byrekët me petë të pjekura të kujtojnë sobën me dru dhe petët që i shtronte mamaja një e nga një në sipërfaqen e sobës..."

Nënë Sanija i gatuante *pulën me qull dhe me salcë hudhrash*, përgatitja e së cilës i kujton Bulqizën, ku vajza e spektakleve të Top Channel ka kaluar një pjesë të fëmijërisë. "...pas ngrënies, aroma e hudhrës në shtëpi shkaktonte ngacmime e të qeshura pa fund...". Nënë Sanija i kujton dhe ngrohjen e barkut me supën me mish e vezë fshati, një recetë aq e thjeshtë, por shumë e shijshme (Frikase).

Në librin me receta të Arbanës ka vend edhe për japrakët me gjethe rrushi, fërgesat me speca, sallatën me lakër, supën me qepë (megjithëse një recetë franceze). Aty ka edhe receta nga Korça, pite të fshira me djath, lakror me kulaçka, me qepë dhe domate, pulë me pilaf etj. Shumicën prej tyre ia ka mësuar Yllka...

"Pitet e mamit" janë jo vetëm të shijshme dhe të mira, por edhe ndjellëse: "Eja, se të kam bërë pite..." Por më shumë se kudo, aroma e Dibrës ndjehet në këtë libër me receta, sidomos te gatimi i jufkave.

Gatimi i jufkave nuk është vetëm një recetë e thjeshtë, por është një histori e bukur fshati, e cila nis që nga përgatitja, kur shtëpia mbulohej me çarçafë të bardhë, që nga oda e miqve, mbi divane kudo, deri te përgatitja e tyre për t'u ngrënë, me pulën përsipër dhe me jufkat krokante që të mrekullojnë. "Ky është specialiteti që përfaqëson më së miri kuzhinën dibrane... Megjithëse ka një origjinë të ngatërruar, birjani me jufka në Shqipëri mbetet një specialitet i dibranëve", - shkruan Arbana.

Arbana ka eksperimentuar shpesh me recetat tradicionale, duken zëvendësuar erëzat e malit me ato që gjenden te "Conadi", por edhe shpesh dhallën, lëngun e thanave dhe lëngun e hoshafëve të zier me verë të mirë franceze... Apo hudhrat e fshatit me salcën libaneze...

Mes recetave nga Spanja, Amerika, Franca, Italia, Tajlanda e shumë vende të tjera, ajo sjell edhe ëmbëlsirën tradicionale shqiptare, me të cilën nuk harron të kujtojë se recetën e saj e ka "marrë nga Lida, nusja e xhaxhait, e cila nuk përton kurrë të përgatisë tepsi gjigante me këtë ëmbëlsirë fantastike...".



ARBANA OSMANI
Receta për njerëzit që dua
Botimet "Dudaj"
ISBN 978-99943-0-336-6
Çmimi: 1000 lekë

* * *

Po të kthehemi te historia e filmit, duhet te themi se Arbana Osmani ia ka dalë të kënaqë blerësit (kritikun e rreptë të kuzhinës), jo vetëm se libri pati me daljen e tij në treg një rekord shitjesh, por se nëpërmjet recetave faqe pas faqeje është brenda gjithë familja dhe miqtë e saj që e rrethojnë në çdo hap dhe shijojnë të parët gatimet e saj.

Kështu, ajo përcjell me librin e recetave, mesazhin se nuk "është dashuria që kalon nga stomaku", por se "dashuria kalon nga kuzhina dhe familja", duke qenë jo vetëm "Receta për njerëzit që dua", por edhe një dhuratë e mirë për "njerëzit që duam".

Bujar Karoshi



Faleminderit!

Faleminderit të gjithë vizitorëve që na vizituan ditët e panairit të librit "Tirana 2013"! Një falënderim i veçantë është për autorët, shkrimtarët, poetët, historianët dhe studiuesit, që na zgjodhën ne për të botuar librat e tyre. Gjithashtu, edhe një falënderim për bashkëpunëtorët tanë nga ente të tjera botuese, që së bashku përgatitëm dhe botuam libra të rinj dhe me shumë vlera.

Një falënderim të veçantë për miqtë e grupit në Facebook <Peshkopi, Diber, Albania>, të cilët me shumë dashuri reklamuan stendën tonë në faqen e tyre, 45 prej të cilëve përfituan nga oferta e veçantë e vlefshme gjatë ditëve të panairit. Falënderimi i posaçëm është për Shtëpinë Botuese dhe Studion Letrare "Naimi", me të cilët jo vetëm ndamë stendën më simpatike në këtë panair, por se edhe ata iu bashkuan promocionit të përbashkët me miqtë e PDA.

Dhe falënderimi i fundit është për blerësit në stendën tonë, të cilët na bënë ne më të gëzuarit e këtij panairi !

Mirutakofshim vitin e ardhshëm!

BOTIMET M&B



cyan magenta yellow black